

Parandalimi i fruthit

Vaksinimi, i
domosdoshëm

Fq.5



MICHAEL ROTH

Maqedonia
duhet t'i përmbush
premtimet e saja

Fq.4



Napoli kërkon
"të burgosë"
Hysajn me
kontratë
të re

Fq.19



Koha

www.koha.mk



Ku u printuan
paratë e para
të Shqipërisë?

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3422 · e mërkurë, 25 korrik 2018

15°C | 20°C

15 DEN

EDITORIAL

Përbindëshi
i zhvillimit
asimetrik



Ata që kalojnë nëpër Maqedoni, para vetes u dalin dy peizazhe – kontrast: pjesa Perëndimore, e pyllëzuar, e gjelbëruar dhe e populluar, dhe pjesa Lindore, e zhveshur dhe gati e braktisur. Këto janë ndarjet që i ka bërë natyra dhe njeriu e ka të vështirë ta konkurrojë natyrën, mirëpo njeriu mund ta fisnikërojë atë. Në pikëpamje demografike e urbane vërehet një asimetri e skajshme, për shkak të migrimit të madh të popullsisë...

Fq.2

KRONIKË

Vëllai vret
vëllanë në
Lipjan

Fq.9

RAJON

Nderohet
ministri i
parë i luftës,
Mehmet Pashë
Dërralla

Fq.16



TAKIMI I LIDERËVE PA QËNDRIM TË UNIFIKUAR

REFERENDUMI EDHE PA VMRO-në



Nga LSDM thonë se lideri i opozitës Mickovski edhe njëherë dëshmoi se është tradhtar i interesave kombëtare i cili nuk është i vetëdijshëm se çfarë kërkon dhe pa turp kushtëzon partitë në pushtet dhe partitë tjera opozitare që janë për referendumin, se do të mbështes referendumin vetëm nëse amnistohen kriminelët e familjes së mentorit të tij Nikola Gruevski

Fq.3

Tragjedia në Greqi, zjarrëvënie e qëllimshme

Zjarrëvënie e qëllimshme nga grabitësit e shtëpi-ve dhe... Çfarë e shkaktoi zjarrin? Kjo është pyetja që po mundon autoritetet greke në këto orë dramatike që po kalon rajoni i Atikës në Athinë. Zyrtarët e cituar nga agjencia e lajmeve AFP kanë thënë se flakët e tanishme mund të kenë filluar nga zjarrëvëniesit që kërkojnë të plaçkisin shtëpitë e braktisura. Ndërkohë ka dyshime të tjera që sugjerojnë se zjarrëvënia është frymëzuar nga persona që synojnë shfrytëzimin e pronave publike. Sido që të ketë ndodhur, më pas, flakët janë

përhapur e shpejtësi, të ndihmuara edhe nga era e fortë, rreth 80 km në orë. Deri më tani raportohet mbi 60 viktima dhe më shumë se 160 persona të lënduar por numri i tyre mund të rritet me kalimin e orëve. Në vendin fqinj është shpallur gjendja e emergjencës ndërsa edhe shtetet si Gjermania, Polonia, etj., kanë dërguar avionë në ndihmë për të shuar flakët që po vijojnë të marrin jetë njerëzish. Spekullohet se në mesin e të vdekurve ka edhe shqiptarë, por kjo ende nuk është konfirmuar zyrtarisht.

Fq.17



EDITORIAL

PËR BINDËSHI
ZHVILLIMIT ASIMETRIK

Emin AZEMI

Ata që kalojnë nëpër Maqedoni, para vetes u dalin dy peizazhe – kontrast: pjesa Perëndimore, e pyllëzuar, e gjelbëruar dhe e populluar, dhe pjesa Lindore, e zhveshur dhe gati e braktisur.

Këto janë ndarjet që i ka bërë natyra dhe njeriu e ka të vështirë ta konkurrojë natyrën, mirëpo njeriu mund ta fisnikërojë atë. Në pikëpamje demografike e urbane vërehet një asimetri e skajshme, për shkak të migrimit të madh të popullsisë nga Maqedonia Lindore në Shkup. Prandaj, jo rastësisht për Shkupin thuhet se është gati e gjithë Maqedonia.

Politika demografike e urbane e Maqedonisë edhe në këtë drejtim ka qenë e padrejtë ndaj banorëve të saj. Në njërin anë ka nxitur migrimin (maqedonas) fshat – qytet, në anën tjetër ky migrim ka qenë më i orientuar drejt Perëndimit (shqiptarët). Mërgimtarët maqedonas të ardhur nga Maqedonia Lindore në Shkup u bënë “padronë” të mëdhenj, kurse mërgimtarët shqiptarë të Maqedonisë Perëndimore u bënë rrogëtarë të metropoleve evropiane. Por, Maqedonia Perëndimore edhe sot e kësaj dite është më e bukur, më e gjallë dhe me një urbanistikë rurale për çdo lakmi. Parazitizmi maqedonas me vite të tëra kishte prodhuar “njeriun e shtetit”, i cili punonte në stilin “tun e ha” dhe harxhoi ardhmërinë e vet duke ia kthyer shpinën fshatit për një trohë snobizëm industrial në kryeqytet. Atje la vetëm disa pleq, si thëngjij gjysmë të ndezur, që japin do shenja jete.

Dehumanizimi, i cili erdhi si pasojë e urbanizimit të paplanifikuar krijoi përshtypjen e rrejtshme, se ata që zotërojnë Shkupin, zotërojnë krejt Maqedoninë. Por, në fakt në Shkup u krijua vetëm një oligarki ekonomiko-politike, kurse pjesa tjetër u proletarizua deri në palcë. Proletarët e tillë sot i shohim tek protestojnë para ndërtesës së qeverisë, tek kërkojnë t’u shpërblehet statusi i të falimentuarve. Kjo sepse në Maqedoni me vite kishte falimentuar ideja e zhvillimit proporcional të rajoneve.

Shteti kishte investuar disa projekte kapitale ekonomike e industriale në Maqedoninë Lindore, ndërkohë që rrugët, kanalizimet, shkollat në fshatrat e Maqedonisë Perëndimore ua kishte lënë në duar private shqiptarëve. Konkurrimi i investimit shtetëror dhe ai privat një kohë ishte shumë disproporcional, sepse në njërin anë shteti hapte fabrika dhe vende pune për mijëra punëtorë maqedonas, kurse në anën tjetër, shqiptarët me paratë e kurbetit asfaltin rrugë, hapnin kanalizime dhe ndriçonin sheshet e fshatrave të tyre. Tani shteti nuk po hap fabrika, por shqiptarët janë ata që po e mbushin arkën e shtetit. Potencia fiskale e shqiptarëve, asnjëherë nuk është kalkuluar politikisht dhe pikërisht këtu kanë dështuar partitë politike shqiptare. Në fakt, shqiptarët në Maqedoni paraqiten investitorë të dyfishtë: në njërin anë duke investuar në ekonomitë e tyre private dhe në anën tjetër duke shtuar potencën fiskale të shtetit, përmes qarkullimeve pagesore në sektorin e gastronomisë, telefonisë mobile, auto-salloneve, derivateve të naftës, duhanit, materialeve ndërtimore etj.

Nëse një shtet si Maqedonia ka zhvillim joproporcional dhe nëse në atë shtet një pjesë e popullsisë jeton nga të ardhurat që i siguron vetë, atëherë medoemos duhet hartuar një politikë tjetër makroekonomike. Në kushte të tilla shteti duhet t’i orientojë investimet andej edhe nga vijën harxhuesit dhe paratë. Në rrethanat e këtushme do të ishte absurde të mos investohet në pjesët e banuara me shqiptarë dhe është e padrejtë që shqiptarët të trajtohen vetëm si kontingjente të freskëta fiskale dhe asgjë më tepër. Në të kundërtën, ka të ngjarë që parazitët e deridjeshëm pa asnjëfarëlloj munde të vazhdojnë të sillen si “padronë” me paratë e shqiptarëve.

Ky zhvillim joproporcional ekonomik, kulturor, social, urbanistik nxjerr në sipërfaqe një model gogol me përmasa të përbindëshit asimetrik.

UP nuk mërzhitet për vlerën e punimeve shkencore

“Kur e kishin pasë qortuar Lasgush Poradecin, pse kishte pranuar të shkruante disa poezi në frymën e realizmit socialist, ai u ishte përgjigjur: “Mut kërkuar, mut u dhashë!” Bizare vërtet, por duket se kërkesa e ka diktuar cilësinë e produktit. Më duket se e njëjta gjë mund të thuhet edhe sot, për punimet e shumta të disa profesorëve universitarë të UP-së. Ata kanë botuar numër të madh punimesh, pasi organet e UP-së kërkojnë punime të botuara në platforma të caktuara, me “standard” e frymë të caktuar. UP nuk mërzhitet për vlerën e atyre punimeve, nuk e ka dert se a mund të vihen në funksion të zhvillimit e emancipimit të shoqërisë, ekonomisë, kulturës e të shtetit të Kosovës ato rezultate. Jo. Meqë ato punime botohen në platforma të huaja, ato nuk i dedikohen fare shoqërisë e shtetit tonë, veçse u përshtaten, mendermethanë, “trendeve globale shkencore.” Nga ana tjetër, shkenca në vendin tonë është në kollaps, pra, në kohën kur punime, demokraci, shkencore, ka rrysh në revistat e huaja. Kështu rezultojnë që Universiteti ynë nuk është në shërbim të kësaj shoqërie e këtij shteti, i cili e financon, po në shërbim të strandarëve fiktive. Shumë nga ata “alamet studiuesish”, me një magar punimesh mbas b...e, në gjuhë të huaja, në vendin tonë nuk i njeh askush, thjesht janë askush. Puna e tyre, edhe nëse ka ndonjë vlerë, nuk vihet në shërbim të mendimit e të dijes në vendin tonë. Por, ata janë viktimat të dyfishta të një sistemi idiotik që ka instaluar Ministria e Arsimit dhe organet drejtuese të UP-së, që u kërkojnë punime jashtë, në gjuhë të huaja, në tema koti, me rezultate koti, veç të përmbushet një kriter fiktiv-formal. Botimin e tillë ata e paguajnë vetë, pasi buxheti i UP-ja për hulumtime shkencore është pothuajë inekzistent. Në këso rrethanash, pra, po lulëzojnë punimet, që i kënaqin organet, të cilat kërkojnë bash “mallin” që ua dha Lasgushi komesarëve të kuq”, ka shkruar në profilin e tij në Facebook, profesori universitar Milazim Krasniqi.

Si u përcaktua që Bilall Kasami të jetë përfaqësuesi i opozitës shqiptare?

“E kam thënë, ndoshta mund të përsëritem pasi ata që kam thënë dikur sot më vërtetohen. A shkojnë shqiptarët drejt asimilimit politik? Kush i përcakton përfaqësuesit e shqiptarëve në Maqedoni: vota shqiptare apo Zoran Zaev?”

Si u përcaktua që Bilall Kasami të jetë përfaqësuesi i opozitës shqiptare, me çfarë kriteri? Sipas Zoran Zaevit cila është Besa dhe si e quan ai partinë e Bilall Kasamit dhe si e quan partnerin e koalicionit qeveritar të Afrim Gashit?

Nëse do të merrej si barometër vota e zgjedhjeve parlamentare të 2016-s, në të cilat Lëvizja Besa doli partia e dytë në bllokun politik shqiptar, atëherë, sipas numrit të deputetëve, shumica e Lëvizjes Besa është pjesë e qeverisë, ndërsa, nëse do të merrej parasysh vota e zgjedhjeve lokale, Aleanca për Shqiptarët doli dukshëm fituese e zgjedhjeve.

Nga kjo që po bëhet, ne si shqiptarë, pa marrë parasysh se çfarë marrëdhënies kemi mes veti, punët tona dhe çështjet tona duhet t’i rregullojmë vetë, e jo që fatin tonë ta vendosin tjerët.

Fatkeqësisht, këtë situatë e sollën vetë partitë e vogla, që me pamaturinë dhe papjekurinë, për të rryzuar BDI-në ishin në gjendje të bashkëpunojnë edhe me djallin. Çfarë “mbollën”, tani po “korrin”, ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Artin Spahiu.

MEDIACitate

Jovanović: Do të ketë luftë nëse Serbia bën kompromis me Kosovën

Kryetari i Partisë Liberal-Demokratike (LDP), Çedomir Jovanović, ka paralajmëruar sot se pas rundit të ri të dialogut midis Beogradit e Prishtinës, në shtator, do të paraqesë plan të qartë për marrëveshje me shqiptarët dhe do të formojë Koalicionin për Paqe.

Kjo do të kontribuojë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, raporton agjencia serbe e lajmeve Beta.

Jovanović ka thënë se kompromisi me shqiptarët paraqet mbylljen e pikës së fundit në rajon që do të mund të shkaktoje luftë të dhe prandaj takimi i presidentëve të Serbisë e të Kosovës, Aleksandar Vuçiqit dhe Hashim Thaçit në shtator, në Bruksel, është me rëndësi dhe se prej tij varet rrjedha e zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

“LDP do të reagojë pas atyre bisedimeve me një plan të qartë në themelet e të cilit duhet të ngrihet forca politike që do të luftojë për marrëveshje dhe paqe me shqiptarët e Kosovës dhe prandaj në Koalicionin për Paqe, që planifikojmë ta organizojmë, duhet të mbledhim atë pjesë të opinionit që e kupton momentin në të cilin ndodhet Serbia dhe nuk dëshiron të lëshojë edhe një shans duke u zhytur në polarizime partiake dhe konflikte të brendshme”, ka thënë Jovanović.

Sipas tij, Vuçiq “me një këmbë qëndron në rrugën e zgjidhjes së problemit”, kurse me tjetrën në politiken e cila është e paqëndrueshme, dhe e ka këshilluar se nuk mundet në të njëjtën kohë të mbështesë qeverinë e Ramush Haradinjat në Prishtinë, ndërsa në Beograd të bëjë fushatë që shemb marrëdhëniet me shqiptarët.

Jovanović ka thënë se Serbia aktualisht ndodhet nën presion të fuqishëm dhe për këtë arsye po zvarrite zgjidhja e çështjes së Kosovës. Siç është shprehur ai, presionet vijnë nga opinioni nacionalist, organizatat që vijnë nga Rusia, kisha dhe pjesë të opozitës “e cila ofron rrëzimim e Vuçiqit me temën e Kosovës”.

(Koha.net, 24 korrik)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

PSE VLADIMIR PUTIN NUK BUZËQESH KURRË?

Pse Vladimir Putin nuk buzëqesh kurrë? Ai mund të ketë datëlindjen në Ditën Botërore të Buzëqeshjes, por janë të rralla momentet kur e shohim Vladimir Putin me buzëqeshje në fytyrën e tij Njerëzit nga Rusia, ashtu si ata nga vende si Irani dhe Franca, nuk qeshin shumë si të tjerët, dhe ka disa arsye për këtë. Psikologu Kuba Krys ka botuar një libër për këtë çështje.



“Kjo është një karakteristikë më e shpeshtë për shoqëritë e shtypura politikisht, ku respektohet shkollimi”, thotë ai.

“Përveç kësaj, në këto vende korrupsioni është më i përhapur dhe shërbimet civile janë më të paqëndrueshme”, shton ai.

Gjithashtu, në këto vende mendohet se buzëqeshja është më pak mikpritëse duke aluduar në dyfytërsi.

Nga LSDM thonë se lideri i opozitës Mickovski edhe njëherë dëshmoi se është tradhtar i interesave kombëtare i cili nuk është i vetëdijshëm se çfarë kërkon dhe pa turp kushtëzon partitë në pushtet dhe partitë tjera opozitare që janë për referendumin, se do të mbështes referendumin vetëm nëse amnistohen kriminelët e familjes së mentorit të tij Nikola Gruevski

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 24 korrik - Edhe pas takimit të tretë liderë e katër partive LSDM, BDI, VMRO dhe lëvizjes BESA e Bilall Kasamit nuk arritën t'i tejkalojnë dallimet rreth dy pikave të rëndësishme formimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe pyetjes së referendimit që parashihet mbahet në fund të muajit shtator të këtij viti. Për dallim nga dy takimet e mëparshme ku përfunduan pa arritur asnjë marrëveshje takimi i tretë i ditës së hënë që zgjati plotë 7 orë partia në pushtet udhëhequr nga kryeministri Zoran Zaev mbështetur nga lideri i koalicionit qeveritar të partisë BDI Ali Ahmeti dhe nga lideri i lëvizjes BESA ranë dakord që të pranojnë disa nga kërkesat të liderit të partisë opozitare VMRO-DPMNE Hristijan Mickovski.

TAKIMI I LIDERËVE PA QËNDRIM TË UNIFIKUAR REFERENDUMI DO TË MBAHET EDHE PA VMRO-DPMNE-në



Ndërsa në anën tjetër lideri i VMRO-së edhe njëherë ka kërkuar që si parti opozitare do të mbështes referendumin nëse do të kishte amnisti për të akuzuarit e rastit të 27 prillit. Qëndrimet e liderit të opozitës nga partia e LSDM-së pas përfundimit të takimit të tretë i vlerësojnë si sentiment të fundit të Mickovskit si person i vetëm në këtë takim që vihet në mbrojtje të kriminelëve duke mos lejuar që qytetarët e Maqedonisë lirshëm të shprehen se janë për Maqedoni në NATO dhe BE.

Nga LSDM thonë se lideri i opozitës Mickovski edhe njëherë

dëshmoi se është tradhtar i interesave kombëtare i cili nuk është i vetëdijshëm se çfarë kërkon dhe pa turp kushtëzon partitë në pushtet dhe partitë tjera opozitare që janë për referendumin, se do të mbështes referendumin vetëm nëse amnistohen kriminelët e familjes së mentorit të tij Nikola Gruevski.

"Nuk mundet një lider opozite për shkak të amnistisë të kriminelëve të mban peng qytetarët e Maqedonisë që lirshëm të dalin në referendum dhe të votojnë se janë apo nuk janë për Maqedoninë në BE- dhe NATO. Formimi i KSHZ-

së do të ndodh vetëm nëse liderët e katër partive bien dakord që të ndryshohet Kodi Zgjedhor dhe kjo është arsyeja e vetme se pse kryetari i Parlamentit në seancën e fundit e hoqi këtë pikë nga rendi i ditës. Me vetë faktin se është tarritur marrëveshja për formimin e KSHZ-së, qytetarët e Maqedonisë nga të gjitha etnitet tjera që jetojnë në Maqedoni shkojnë përpara atje dhe ku e kanë vendin Në Evropë dhe NATO. LSDM-ja dhe partitë tjera partnere që janë në integritet e vendit në BE dhe NATO do të mundësojnë referendumin ku qytetarët do të shprehin

vullnetit e tyre se janë për BE- dhe NATO", thotë Tomislav Tuntev, koordinatori i LSDM-së.

Megjithatë tre liderët e Zoran, Zaev, Ali Ahmeti dhe Bilall Kasami, pas përfundimit të takimit të djeshëm me deklaratat e tyre i bënë me dije liderit të opozitës Mickovski se vetëm për të ardhmen e qytetarëve ranë dakord të pranojnë kërkesat e partisë opozitare VMRO dhe se aspak nuk kanë dyshime se referendumi do të mbahet deshi apo nuk deshi partia opozitare ndërsa kryeministri Zaev deklaroi se pas këtij takimi ai nuk e sheh të arsyeshme të ketë edhe një takim të ri liderësh. "Mickovski nuk ka pranuar t'u bëjë thirrje përkrahësve të partisë së tij që të dalin në referendum dhe të votojnë sipas bindjeve të tyre. Mickovski gënjen kur thotë se dëshiron anëtarësimin e Maqedonisë në BE dhe NATO", deklaroi kryeministri Zoran Zaev pas takimit. Nëse edhe më tej lideri i VMRO DPMNE-së nuk e ndryshon qëndrimin e tij dhe nuk bie dakord të apelojë deri te qytetarët që dalin në referendum dhe të votojnë sipas bindjeve të tyre, atëherë burime nga Qeveria thonë se: "Qeveria dhe partitë tjera opozitare që përkrahin referendumin, të gjithë procesin në lidhje me pyetjen që do të shtrihet në referendum, për karakterin e tij dhe për datën kur duhet të mbahet referendum, do ta organizojnë pa partinë VMRO-DPMNE. Mickovski për momentin është i vetmuar dhe nuk do të lejojë që për interesa të ngushta partiake dhe nevojës për të mbrojtur kriminelët ta çon Maqedoninë në izolim të ri", thonë nga Qeveria e Maqedonisë.

Shkupi ndau një milion denarë për Athinën

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov sot ka pasur bisedë telefonike me kolegun e tij athinas Jorgos Kaminis dhe i ka shprehur ngushëllime të thella për qytetarët që humbën jetën në zjarrin e stuhishëm që e përfshiu rrethinën e Athinës. "Qyteti i Shkupit do t'i dërgojë një milion denarë ndihmë fillestare Athinës për të pësuarit në zjarre. Kjo është masa e parë urgjente e Qytetit të Shkupit dhe ai mbetet i hapur për çfarëdo lloj ndihme në qoftë se në mënyrë plotësuese kërkohet", njoftoi Qyteti i Shkupit. Përveç Shilegovit, edhe kryetari i Tiranës Erion Veliaj, ka kontaktuar me Kaminis duke i shprehur mbështetje dhe ofruar ndihmë. Kaminis, siç kumtoi Kabineti i tij, është falënderuar për solidaritetin që e demonstroi dhe dakorduan kontakt të ri për hapat e ardhshëm.



Ligjit i Mediave bllokohet nga opozita

Ministri i Shoqërisë informatike dhe Administratës Damjan Maçevski tha se miratimi i Ligjit të Mediave bllokohet nga opozita me kushtin e amnistisë së zyrtarëve të saj

Shkup, 24 korrik - Në vend se të debatohet për Ligjin e Mediave, i cili tanimë një kohë të gjatë ka ngecur në Komisionin Parlamentar për Transport dhe Lidhje të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja deputetët u përplasën për zhvillimet aktuale. Pushteti konsideron se opozita edhe Ligjin e Mediave po tenton ta mbajë peng të kërkesës së amnistisë për zyrtarët e saj, ndërsa VMRO-ja kundërshton ndryshimet ligjore duke i quajtur si formale.


Do të doja të theksoj se në të vërtetë se me sjelljen e këtij Ligji nuk bëhen asnjëfarë reformash në fushën e mediave në Maqedoni. Që të bëhen reforma duhet të vendosim theksin tek profesionalizimi i televizionit publik i Maqedonisë dhe profesionalizimi i Agjencisë së shërbimeve audio dhe audio vizuale. Me miratimin e këtij ligji, me ndryshimet e parapara aspak nuk theksohet profesionalizimi i tyre – deklaroi Zoran Ilioski, deputet i VMRO-DPMNE-së. Amendamenti i nëntë ka të bëjë me nenin 3 alineja 4 që të plotësohet me



aline të re, pesë e cila do të mundësojë reko-mandim për mbështetje përpos institucioneve të tjera dhe palët e tjera relevante të mund të japin edhe nga Asociacioni i mediave elektronike – tha Nikolla Mickovski, deputet i VMRO-DPMNE-së.

Ministri i Shoqërisë informatike dhe Administratës Damjan Maçevski tha se miratimi i Ligjit të Mediave bllokohet nga opozita me kushtin e amnistisë së zyrtarëve të saj. "Reformat në media, si dhe të gjithë reformat tjera janë peng i interesave personale dhe prapavijës politike si dhe shkak për kërkimin e amnistisë. Ju vetë e patë sot se Ligji ende po vazhdon të bllokohet, edhe sot flitet për gjithçka tjetër përpos ligjit të shërbimeve audio

dhe audio-vizuale, posaçërisht reforma në fushën e mediave, edhe përkaj gjithë rezultateve katastrofike nëpër media veçanërisht dhjetë viteve të fundit, dua të apeloj në ndërgjegjësimin e personave të cilët sot marrin pjesë në këshillin programor të RTVM-së dhe në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale. Apeloj që të kenë guxim dhe të dorëzojnë dorëheqjet e tyre" – pohoi Damjan Maçevski, ministër i Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Ligji për Shërbime Audio dhe Audio vizuale është dorëzuar në Kuvend që nga shkurti i këtij viti. Që atëherë Ligji është bllokuar në Komisionin amë. Për ligjin janë parashtruar 75 amendamente, ndër të cilat 12 janë të pushtetit.



PSP do të hetojë falimentimin e MPM-së

Rasti i Media Print Maqedoni (MPM) do të kalojë në duart e Prokurorisë Speciale Publike (PSP), pasi që Prokuroria Themelore Publike dërgoi dokumentacionin komplet pasi që kjo PSP-ja ka kërkuar të njëjtën. Do të hetohet për atë se si u mbyllën gazetatat e MPM-së, si dhe hetimi për hamendjet për keqpërdorim të pozitës zyrtare për udhëheqësit e atëhershëm të ndërmarrjes, Serxhan Kerim dhe Jana Stanisavljeva. Hetuesit e PSP-së vitin e kaluar hyrën në hapësirat e MPM-së, themeluese e së cilës deri para hetimit ishte Qendra Grafike Shkup që ishte në pronësi të Holdingt Orka të Orce Kamçev. MPM-ja tash është në procedurë falimentuese.

Përbërja e KSHZ-së, VMRO-ja pret ligjin për qeverinë

Ligji mbi Qeverinë dhe Ligji mbi Financimin e Partive Politike janë harmonizuar, por pa futjen e tyre në procedurë parlamentare, VMRO-DPMNE-ja nuk do të propozojë anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Mbrëmë dështoi zgjedhja e tyre. LSDM, BDI dhe Lëvizja Besa krahu i Kasamit i kanë dorëzuar tek kreu i Kuvendit emrat e përfaqësuesve të tyre në KSHZ. Socialdemokratët në KSHZ do të përfaqësohen nga Borçe Kondarko, Janakie Vitanovski dhe Radica Ristevski. BDI-në do ta përfaqësojë, Ditmire Shehu ndërsa Besën e Kasamit, Enver Salihu. VMRO-DPMNE-ja do ta propozojë Oliver Darkovskin për kryetar ndërsa për anëtarë Elizabeta Postolovskën. Emrat i konfirmoi, koordinatori i grupit parlamentar të VMRO-së, Dragan Danev por sipas tij të njëjtit do të dorëzohen tek kreu i Kuvendit pas plotësimit të dy parakushteve që i ka opozita. Partia e Hristijan Mickoskit kërkon akoma kohë. Sipas informacioneve të mia akoma ka bisedime. Të lëmë pak kohë deri nesër ose ditëve në vijim që të përparojë procesi dhe të votohet gjithçka nga ajo që u morën vesh liderët. LSDM-ja vazhdon të akuzojë opozitën se po bën obstrukcione ndaj KSHZ-së dhe referendumit me qëllim amnistinë – deklaroi Dimçe Arsovski, zëdhënës i VMRO-DPMNE-së.

ROTH: MAQEDONIA DUHET T'I PËRMBUSH PREMTIMET E SAJA

Bujar Osmani: "Jemi të vetëdijshëm për kompleksin e procesit, që përfshin një pjesë të madhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian, i cili duhet të transponohet në legjislacionin nacional, por këto janë përfitime që çojnë drejt transformimit themelor të vendit në shoqërinë demokratike evropiane, me një treg funksional ekonomik, institucione efektive dhe administratë profesionale"



Shkup, 24 korrik - Ne duhet t'i përmbushim të gjitha premtimet, por edhe Maqedonia duhet të përmbushë të sajat. Ky është mesazhi të cilin e dha sot ministri shtetëror për Evropë në Ministrin për Punë të Jashtme të Republikës Federative të Gjermanisë, Michael Roth. Ai tha se e ardhmja e Maqedonisë është në NATO dhe BE dhe se kjo nuk është vetë mendimi i tij, por edhe institucioneve evropiane, si dhe i të gjithë 28 vendeve anëtare.

"Unë do kisha dashur ta shikojë Maqedoninë, në anën time të Evropës, në një kohë sa më të sh-

pejtë, sepse, stabiliteti, paqja, prosperiteti dhe demokracia në Ballkanin Perëndimor janë të rëndësishme. Por, duhet të jetë e qartë se pa marrëveshjen për kontestin e emrit, nuk shikoj mundësi për ju që të hyni në NATO dhe BE".

"Ne duhet t'i përmbushim premtimet tona dhe Maqedonia duhet t'i përmbush të saj. Kjo nuk është vetëm obligim i Qeverisë, por i të gjithë aktorëve politik, ta marrin përgjegjësinë për të gjithë vendin. Politika nuk është lojë. Për këtë, ju jeni shumë të rëndësishme, sepse ju

do ta ndërtoni të ardhmen në vendin tuaj. Ju jeni të nevojshëm. Për këtë ju jap guxim që të ngriheni dhe të luftoni për të drejtat e tuaja, ta ngritni zërin tuaj", tha Michael Roth.

"Jemi afër anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe NATO, dhe nuk do të lejojmë që të shkatërohet procesi ose i njëjti të rrezikohet", kështu u porositi në takim ndërmjet kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev dhe ministrit gjerman, Mihael Rot.

Kryeministri Zaev ka deklaruar se mbetet i përkushtuar për reali-

zim të referendumit dhe se nuk do të ketë amnistim për krimet politike.

"Mbetemi të përkushtuar deri në fund që të arrijmë deri të zgjidhja e cila do të mundësojë referendum fer dhe në interes të qytetarëve të shtetit tonë. Ligji është i njëjtë për të gjithë, amnisti për krimet politike nuk do të ketë, veçanërisht nuk do të lejojmë trysnia të na largojë nga shteti i së drejtës", tha Zaev.

Edhe zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, u takua me ministrin Shtetëror Gjerman për Evropë, Mihael Roth. Zëvendëskryeministri Osmani fillimisht shprehu mirënjohje për mbështetjen dhe përkushtimin e vazhdueshëm të Gjermanisë në procesin e aderimit në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, reflektuar edhe përmes iniciativës "Procesi i Berlinit".

"Jemi të vetëdijshëm për kompleksin e procesit, që përfshin një pjesë të madhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian, i cili duhet të transponohet në legjislacionin nacional, por këto janë përfitime që çojnë drejt transformimit themelor të vendit në shoqërinë demokratike evropiane, me një treg funksional ekonomik, institucione efektive dhe administratë profesionale" – shtoi Osmani.

"Opozita reale në Maqedonia janë qytetarët e pa përfaqësuar në qeveri dhe që përfaqësohen nëpërmjet ASH-së", ka thënë Sela

Shkup, 24 korrik - Në një konferencë për shtyp, të martën, deputeti i Kuvendit një herit edhe Kryetar i Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela, ka përshëndetur Marrëveshjen me Greqinë, por për të është i papranueshëm fakti i anashkalimit të gjuhës shqipe dhe imponimi i shqiptarëve për t'u deklaruar si maqedonas në marrëveshje

"Maqedonia duhet të jetë anëtare e NATO-s dhe e BE-së, kjo është në platformën e Aleancës për Shqiptarët dhe dhe aspiratave të një kombi që ne përfaqësojmë. Ne kemi përshëndetur marrëveshjen me Greqinë por kemi shprehur shqetësimin për dy çështje, me tendencat t'ju imponuar shqiptarëve që në dokumentet e tyre të jenë maqedonas, qyte-

CILAT JANË SHQETËSIMET E SELËS RRETH MARRËVESHJES ME GREQINË?



tarë të Maqedonisë Veriore, dhe anashkalimi e futjes në marrëveshje gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare", tha Ziadin Sela në fjalimin e tij.

Ai shtoi se po e përkrah idenë që të ketë Qeveri teknike 100 ditë para zgjedhjeve që do të mbahen, duke shtuar se Ligji për financimin partive politike do t'i bëjë partitë politike më autonome dhe dhe jo të afërta me biznesin por më afër me qytetarin.

Aleanca për Shqiptarët vlerë-

son se anëtari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet t'i takoj kësaj partie. Kreu i ASH-së, Ziadin Sela bazë për këtë e merr rezultatin zgjedhor. Sela kërkoi nga Lëvizja Besa të cilën e quajti subjekt me dy këmbë në opozitë dhe tre në Qeveri, të zgjidh çështjen e grupit parlamentar.

"Opozita reale në Maqedonia janë qytetarët e pa përfaqësuar në qeveri dhe që përfaqësohen nëpërmjet ASH-së. Ky është rezul-

tat i zgjedhjeve të fundit por edhe i të gjitha anketave të cilët bëhen. Këto janë tendenca të ulta të qeverisë për të uzurpuar hapësirën e opozitës", ka thënë Sela.

Aleanca për Shqiptarët nuk është subjekt i cili ka tre këmbë në Qeveri dhe dy këmbë në opozitë, por është me dy këmbët në opozitë. Nëse njëri nga krahët e Besës thirret në opozitë, gjëja e parë që duhet bëjnë në Parlament është të zgjidhin çështjen e grupit parlamentar. Nuk mund të bësh garë dhe oponencë në opinion me njëri tjetrin, nuk mund që njëri grup të jetë në Qeveri e tjetri në opozitë por të ndajnë të njëjtin grup parlamentar. Një nga argumentet që anëtari i KSHZ-së i takon Aleancës për Shqiptarët është pikërisht edhe ky fakt. Lëvizja Besa është pjesë e Qeverisë dhe nuk është në opozitë – deklaroi Ziadin Sela, kryetar i ASH-së.

Organizata joqeveritar në vend çdo ditë e më tepër e risin niveli ne tyre organizativ. Me qëllim zbatimin e mirëfilltë të reformave në drejtësi dhe arritjes së vendimeve cilësore, sektori civil "Bluprint", nga 1 gushti nga afër do ta vëzhgoj punën e Qeverisë, gjegjësisht angazhimin e tyre për harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 24 korrik - Sektori civil i bashkuar në një emër "Grupi Bluprint" ka paralajmëruar se në periudhën e ardhshme do të realizon monitorim të reformave ne sistemin e drejtësisë. Puna e tyre siç njoftuan të martën pritet të filloj nga 1 gusht i këtij viti dhe qëllim primar është mbikëqyrja e procesit të reformave, gjegjësisht vallë këto reforma realizohen me dinamikën e paraparë dhe sa janë cilësore. Përcjellja e rrjedhës së reformave në vend pritet të realizohet përgjatë dhjetë muajve të ardhshëm. Përpos evoluimit që do të publikohet, Uranija Pirovska, nga Komiteti i Helsinkit, njoftoi se deri te Qeveria do të dorëzohet propozime për mbështetjet e procesit të skringut dhe fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian.

SEKTORI CIVIL I BASHKUAR PËR MONITORIMIN E REFORMAVE REFORMAT NË DREJTËSI NËN THJERRRËZËN E "BLUPRINTIT"



"Pritjet tona janë që të dalim me vlerësim relevante për çështje e kualiteti të reformave dhe zbatimi të tyre në praktikë. Nuk besojmë se Qeveria do të mbetet indiferente ndaj këtij angazhimi tonë, që pas përfundimi të procesit opinionin do t'ia ofrojmë ta shfletoj", tha Pirovska, si përfaqësuese e Komiteti të Helsinkit në Maqedoni.

Plani 18-të, i Qeverisë, sipas saj është krijuar pa konsultim me sektorin civil, gjegjësisht Pirovska, nënvizon se ky plan është tejte gabimisht i koncipuar. Numërimi taksativ i punës që pritet të bëhet në sferën e reformave në drejtësi, siç thonë nga "Bluprint", nuk është i mjaftueshëm. Ata theksojnë se

mungojnë shumë dilema dhe pyetje që ishin të parashtruara në Planin 369, e që nuk janë plotësuar.

Gjatë periudhës së kaluar deputet në Parlamentin e Maqedonisë, miratuan disa ndryshime ligjore që vlerësohen si pjesë e pakos së reformave në sistemin e drejtësisë. Plotësimi i Ligjit për gjykata, ishte njëri prej tyre. Megjithatë, edhe pse i njëjti u votua prill të këtij viti, përmbajtja e tij nuk u pranuar nga shumë gjykatës, në këtë rast Shoqatës së gjykatësve të Maqedonisë. Dispozita tjera që u ndryshuan së fundimi ishin edhe ato të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, respektivisht pjesa për vlerësimin e gjykatësve.

Sidoqoftë pjesa më serioze e miratimit të reformave në drejtësi tek pritet të pasojë. Fati i Prokurorisë Speciale Publike, apo thënë ndryshe përfshirja e tyre në Ligjin për prokurorinë publike, si një sektor i posaçëm që do ta luftojnë korrupsionin në nivel të lartë ende nuk dihet se si do të realizohet. Problemi kyç sipas njohësve të rrethanave mbetet siguria e 81 votave. Kësisoj pa përkrahjen e VMRO-DPMNE-së, miratimi i reformave në drejtësi vështirë se mund të realizohet. Ndryshe, përveç Komitetit të Helsinkit, nga 1 gushti procesin e monitorimit të reformave në vend do ta vëzhgojnë edhe Shoqata e juristëve të rinj të maqedonisë, Qendra për hulumtimi dhe analiza juridike, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Instituti për të drejtat e njeriut, përfshi edhe Institutin për politikë evropiane. Qasja deri te drejtësia e personave të varfër, kontesteve administrative, Prokuroria Publike, dhënia e provimit të jurisprudence, ekipi kadrovik dhe teknik i Akademisë për gjykatës, paraqesin vetëm një pjesë të sferës që sektori civil do të monitoroj nga fillimi i muajit të ardhshëm.



Gostivari iu bashkua fushatës "Ti je një luledielli"

Gostivar, 24 korrik - Vetëqeverisja Lokale e Gostivarit iu bashkua fushatës "Ti je një luledielli", me të cilën grumbullohen mjete për t'indihmur fëmijët e hospitalizuar në Klinikën për Radioterapi dhe Onkologji në Shkup. Kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Taravari bleu fanelle për administratorët komunalë, duke përkrahur kështu këtë nismë dhe duke inkurajuar qytetarët e Gostivarit që edhe ata të kontribuojnë në këtë drejtim., njofton Shërbimi për informim i kësaj Komune.

Prezantuesja e njohur shqiptare dhe kryetare e Fondacionit për grumbullimin e mjeteve, Albana Osmani, udhëheqëse e fushatës senzibilizuese e cila tha se është e kënaqur me rrjedhën e kësaj fushate në Maqedoni dhe se është shumë e lumtur që në stafin e saj ka edhe një person nga Gostivari. "Jam krenar që Gostivari bëhet pjesë e kësaj fushate senzibilizuese dhe ftoj qytetarët e Gostivarit në përgjithësi dhe biznesmenët në veçanti, që t'i bashkëngjiten kësaj nismë. Uroj që kjo iniciativë të ketë sukses dhe së shpejti ky mision të shtrihet edhe në Gostivar dhe në Maqedoni dhe t'u ndihmohet fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet e gjakut. I dimë kushtet shumë të dobëta në të cilat trajtohen fëmijët me sëmundje të këtij lloji, si në vendin tonë ashtu edhe në shtetet e rajonit, andaj mendoj se ky mision duhet të përkrahët dhe të zgjerohet që këtyre fëmijëve tu mundësohet një trajtim adekuat mjekësor", theksoi Osmani. Ajo shtoi se "do të përpiqemi të bëjmë gjithçka nga ana njerëzore, ndërsa pjesa tjetër le të mbetet në duart e Zotit". "Do të ftoja qytetarët e Gostivarit të porosisin nga një bluzë dhe të kontribuojnë për të ndihmuar këta fëmijë. Kontributi juaj do të shkojë qind për qind për këta fëmijë", theksoi Albana Osmani. Bluzat të fushatës senzibilizuese "Ti je një luledielli" mund të porositen në zyrën e Agram Construction në Gostivar.

PARANDALIMI I SËMUNDJES SË FRUTHIT

VAKSINIMI, I DOMOSDOSHËM

Nga ISHP informojnë se është ndarë material informativ-edukues punonjësve shëndetësorë në mbrojtjen shëndetësore primare (mjek amë, pediatër), në kopshtin për fëmijë, janë realizuar pjesëmarrje në mediat lokale me qëllim të informohet popullsia dhe edukimi për masat për mbrojtje nga infektimi

Koha Aida XHONI

Shkup, 24 korrik - Javën e kaluar në Institutin për shëndet publik (ISHP) janë regjistruar nëntë të sëmurë nga fruthi në rajonin e Dibrës, me çka numri i përgjithshëm i të sëmurëve në vend arrin 17 raste. Që të gjithë këtë sëmundje e kanë bartur nga njëri tek tjetri, që të gjithë janë në lidhje epidemiologjike dhe banor të Dibrës, vetëm një grua është nga Ohri e cila çdo ditë udhëton deri në Dibër.

Sa e rrezikshme është realisht epidemia duke pasur parasysh se kemi mjaftë fëmijë dhe të rritur të pa vaksinuar?

Epidemi të fruthit ka në më shumë vende të rajonit, ku janë regjistruar edhe raste vdekjesh. Përveç fëmijëve, ka edhe të rritur të pa vaksinuar, ose të vaksinuar vetëm me një dozë, të cilët mund të sëmurën. Puçrrat e vogla kanë

marrë jetë njerëzish në Serbi e Bosnje e Hercegovinë.

"Është e rrezikshme sepse kemi shumë raste kur i iket vaksinimit kundër fruthit, ose vaksinës MRP. Kjo sëmundje përhapet shumë shpejtë, për shembull, nëse janë të vaksinuar 90 deri 100 persona, virusi mund të përhapet edhe tek ndonjë i vaksinuar. Nëse kemi 30 të pa vaksinuar, prapë ai do të përhapet", thotë dr Gordana Kuzmanovska, epidemiologe në ISHP.

Që te kemi imunitet kolektiv, epidemiologët thonë se duhet vaksinuar madje 95 përqind të atyre që duhet marrin vakcina. Vitin e kaluar doza e parë vaksinës MRP që u jepet fëmijëve që kanë mbushur një vjet është marrë nga 82.6% prej tyre. Rivaksinim në moshën gjashtë vjeçare kanë pranuar 97%.

"Në Shkup këtë vaksinë vitin e

kaluar e kanë marrë 78.5% e fëmijëve. Të gjithë fëmijët që nuk e kanë pranuar këtë vaksinë mund të sëmurën. Ndodhë të sëmurën edhe të vaksinuarit por atëherë sëmundja kalon më lehtë dhe më shpejtë. Nuk duhet të harrohet se edhe të rriturit të pa imunizuar mund të sëmurën", thotë Kuzmanovska.

Vaksina kundër fruthit, sipas të dhënave të ISHP, ka filluar të jepet në vitin 1971, ndërsa në vitin 1972 është urdhëruar si e rregullt tek fëmijët 13 muajsh. Në vitin 1983 është sjellë vakcina e kombinuar MRP, gjithashtu për moshën 13 mujore. Në vitin 1987 janë rivaksinuar fëmijët shtatë vjeçar vetëm me vaksinë kundër fruthit, ndërsa në vitin 1997 është bërë rivaksinim me MRP.

Ndryshe, epidemi të fruthit ka në rajonin e NJR Dibër, ku janë regjistruar 17 raste, publikoi në ueb



faqen e vet Institutit i Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë.

Lidhur me moshën, 11 prej të infektuarve janë mbi 30 vjet, tre persona janë në moshën prej 20-29 vjet, ndërsa nga një person u përkasin grupmoshave: prej 15-19 vjet, prej 1-4 vjet dhe nën një vjet.

Nga ISHP informojnë se është ndarë material informativ-edukues punonjësve shëndetësorë në mbrojtjen shëndetësore primare (mjek amë, pediatër), në kopshtin për fëmijë, janë realizuar pjesëmarrje në mediat lokale me qëllim të informohet popullsia dhe edukimi për masat për mbrojtje nga infektimi.

Nga fillimi i vitit deri tani në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 28 raste të fruthit, prej të cilëve 20 janë klasifikuar si raste të konfirmuara të fruthit (të konfirmuar në laborator), shtatë janë klasifikuar si raste të mundshme (lidhje epidemiologjike) dhe një rast i mundur, i cili i përmbush vetëm kriteret klinike.

NË SLLATINË, MANIFESTIME TË SHUMTA VERORE

RINGJALLET JETA KULTURORE DHE SPORTIVE



Këshilli për organizimin e këtij manifestimi theksoi se qëllimi është që të ngjallet jeta kulturore në këtë fshat dhe njëkohësisht është një manifestim dedikuar edhe mërgimtarëve të cilët kthehen në vendlindje.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 24 korrik - Fshati Sllatinë i komunës së Tearcës, me shumë aktivitete, ka rikthyer traditën e dikurshme të organizimit të manifestimeve verore. Këshilli organizativ i këtij fshati, nuk e kishte vështirë të organizonte aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore duke patur parasyh se në këtë fshat kanë funksionuar ish klubi i futbollit "Vëllazërimi", ish klubi i futbollit të vogël "Elita" dhe Shoqëria Kulturore Artistike "Vëllazërimi". Krahas kësaj, tashmë nga ky fshat janë edhe disa piktorë, të cilët kanë hapur ekspozitat e tyre personale dhe kanë marrë pjesë në ekspozita kolektive. Pikërisht duke u nisur nga kjo infrastrukturë që ka ekzistuar më herët, kë-

saj radhe pas një kohe shumë të gjatë pikërisht gjatë verës, me rastin e kthimit të mërgimtarëve filluan manifestimet të cilët do të zgjasin tre ditë. Dhe pikërisht manifestimet filluan me homazhet tek varrezat e dëshmorëve Murtezan Etemi, Burim Huseini, Enver Ademi dhe martirës së vogël 11 vjeçaren, Adelina Arifi. Pas vendosjes së kurorave me lule pranë dëshmorëve dhe martirës të luftës së 2001-it, aktivitetet vijuan në shkollën fillore "Eqrem Qabej", ku edhe zyrtarisht u hap ekspozita e përbashkët e Shenasi Abdullaut, Selam Abdiut, Rejan Etemit, Halime Adilit, Enver Husmanit dhe fotografit profesional Dashmir Izairi. Publicisti Bardhyl Zaimi, është shprehur se theksoi se secili prej këtyre piktorëve është i veçantë në

krijimet e tij, secili ka të vulën e origjinalitetit krijues që tashmë është dëshmuar me ekspozitat personale dhe kolektive. Sipas tij, Sllatina këtyre ditëve është bashkë, duke përbashkuar vlerat e komunikimit dhe duke përbashkuar bukurinë e artit të pikturës dhe fotografisë artistike njëkohësisht. "Kjo ekspozitë e përbashkët në javën kulturore në fshatin tonë është një rast i mirë që ne të kënaqemi me punën e tyre, me pikturat dhe fotografitë sartistike, të cilët nuk durojnë shumë shpjegime, sepse gjithsecili do të gjejë brenda kornizave shtegtimin e shpirtit të tij, gjithë ato imazhe fëmijërie që ngjallin një mall të brendshëm për një kohë të harruar, por që vjen në kohën tonë përmes forcës krijuese

se të piktorëve tanë", tha Zaimi. Këshilli për organizimin e këtij manifestimi theksoi se qëllimi është që të ngjallet jeta kulturore në këtë fshat dhe njëkohësisht është një manifestim dedikuar edhe mërgimtarëve të cilët kthehen në vendlindje. "Në kuadër të manifestimit në fshatin Sllatinë janë paraparë shumë aktivitete të cilët kanë për qëllim që të ruajnë traditën e dikurshme, duke patur parasyh se në këtë fshat kanë ekzistuar dy klube të futbollit, respektivisht klubi i futbollit dhe klubi në futsal. Poashtu krahas kësaj, në këtë fshat ka funksionuar edhe Shoqëria Kulturore-Artistike e cila më herët ka qenë një ndër më të njohurat në rajonin e Pollogut dhe më gjërë. Prandaj ne si këshill orga-

nizativ vendosëm që të gërshe-tojmë këto aktivitete kulturore dhe sportive duke patur mbështetje edhe nga bashkëfshatarët, bashkësia lokale dhe shkolla fillore", tha Lirim Salihi. Në ndërkohë në kuadër të manifestimit "Java Kulturore-Sllatinë 2008", është mbajtur edhe turneu në Shah që poashtu është një traditë e krah-toshme në këtë fshat. Manifestimi vijoi me turneun në futboll nga grupmoshat e reja. Më pas aktivitetet vazhdojnë edhe ditëve në vijim ku janë paraparë gara në mottocros, ndërsa më pas në natën e tretë është paraparë darka solemne me ushqime tradicionale si dhe programi artistik me koncert me këngë, valle dhe interpretime dramatike" njoftuan nga këshilli organizativ.

REAGIM I BDI-DEGA NË GOSTIVAR

ME TENDERE TË KURDISURA, TARAVARI PUNËT UA BESON FIRMAVE MAQEDONASE

Është ky Kryetar komune i cili hap tender që me marrëveshje kornizë punët ndërtimore për një vit kalendarik ia beson një operatori të vetëm ekonomik. Kushtet dhe kriteret e parapara në tender përjashtojnë çdo firmë shqiptare jo vetëm nga Gostivari por në të gjithë Maqedoninë

Në çdo lajm të publikuar në rrjetet sociale apo edhe komente të qytetarëve, Taravari i mjafton koha të komenton dhe të tenton të arsyeton veprimet që dalin në opinion si veprime skandaloze dhe joligjore nga ai dhe komuna e Gostivarit. Duke zgjedhur këtë formë komunikimi me opinionin, Taravari shmang komunikimin zyrtar dhe me çdo kusht tenton që fajin ta dislokon diku tjetër, thuhet në

reagimin e Degës së Bashkimit Demokratik për Integrim në Gostivar.

Por, para fakteve heshtin edhe mbretërit. Gjatë qeverisjes së tij gati 9 muajore, Taravari do të mbahet mend si Kryetari më i dështuar dhe më antiligjor në ushtrimin e detyrës së tij.

Taravari flet për transparencë por veprimet e tij të deritanishme rezultojnë me të kundërtën dhe që nuk ngjasojnë aspak me transparencën e deklaruar. Kështu flasin dëshmitë dhe dokumentacioni i siguruar nga puna e Komunës së Gostivarit sa i përket tenderimeve për punët ndërtimore.

Është ky Kryetar komune i cili hap tender që me marrëveshje kornizë punët ndërtimore për një vit kalendarik ia beson një operatori të vetëm ekonomik. Kushtet dhe kriteret e parapara në tender përjashtojnë çdo firmë shqiptare jo vetëm nga Gostivari por në të gjithë Maqedoninë.

Kjo tendencë më së miri vërehet në shpalljen me numër ren-

dor: 02/2018, me të cilën shpallje u caktuan kriteret të pakapërcyeshme ndaj firmave shqiptare. Furnizimi publik me vlerë 40.000.000,00 denarë, me ankesë nga operatorë të tjerë pjesëmarrës është anuluar nga Komisioni Shtetëror për Ankesa për Furnizime Publike për parregullsi gjatë zgjedhjes së operatorit ekonomik për realizim të punëve.

Duke e ditur që si rezultat i kushteve të parapara në shpallje, asnjë firmë shqiptare nuk aplikoi në shpalljen e parë, Taravari përsërit shpalljen me po të njëjtat kriteret dhe kushte, gjë që flet se shpallja për relizimin e punëve ndërtimore ka qenë e kurdisur paprakisht.

Pas publikimit të shpalljes në Byronë për Furnizime Publike - BFP, tenderi i përsëritur me numër rendor: 08/2018 është fituar nga kompania e njëjtë si në shpalljen e parë të anuluar si rezultat i ankesës. Bëhet fjalë për SH.A "Pellagonija", e cili fiton tenderin për të realizuar gjitha punimet ndërtimore

në komunën e Gostivarit.

Manovrimet e tilla të Taravarit, flasin qartë për veprim të pararenduar dhe që përjashtojnë nga tenderimi operatorët ekonomik me pronarë shqiptarë. Por ky rast nuk është rasti i vetëm që Taravari manipulon me furnizimet publike dhe përjashton nga gara firmat lokale dhe me pronarë shqiptarë. Pos që punimet ndërtimore do t'i kryen SH.A "Pellagonija", edhe mbikqyrës profesional i punimeve është përzgjedhur një operator nga qyteti i Shkupit. Në shpalljen me numër rendor: 03/2018 si rezultati i kriterëve të paracaktuara, fituesi i tenderit shpalljet kompania "Eos Kosalting", me seli në Shkup.

Kur flasim për tenderimin rreth punëve ndërtimore, si rezultat i dy tenderëve të përmendura lartë, rezultojnë që punët do t'i kryen një kompani me pronarë maqedonas, dhe njëkohësisht punimet do të mbikqyren nga një kompani, po ashtu, me pronarë maqedonas.

Lind pyetja, nëse i gjithë Gostivari nuk posedon firma adekuate për të kryer punë ndërtimore, dhe po ashtu, a nuk posedon qyteti i Gostivarit inxhinierë me autorizim nga Komora e Inxhinierëve dhe arkitektëve dhe të licencuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - MTL, që Taravari t'i anashkalon dhe të zgjedh për të bashkëpunuar me operatorë të tjerë.

Kjo mënyrë e qasjes së Taravarit flet për anashkalim të bizneseve dhe kuadrove gostivarase, dhe ky fenomen për fat të keq tashmë nuk paraqet ndonjë dukuri të re. Tashmë, Taravari ka angazhuar avokat nga qyteti i Tetovës, duke anashkaluar dhjetëra avokatë të Gostivarit, dhe po ashtu, angazhon për marrëdhënie me publikun (PR), në NP "Komunalec", një kuadër nga Struga me profesion aktor që u dëshmuar se merr rrogë dhe nuk shkon në punë, thuhet në reagimin e Degës së Bashkimit Demokratik për Integrim në Gostivar.

SI BOTËRORI I RUSISË NDIKOI NEGATIVISHT NË EKONOMINË E SHQIPËRISË!



Pavarësisht sanksioneve, rritet vëllimi tregtar Rusi-BE

Vëllimi tregtar midis Rusisë dhe Bashkimit Evropian (BE) është rritur me 22.1 për qind, duke arritur shifrat në 119.7 miliardë dollarë në 5 muajt e parë të këtij viti krahasuar periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas shifrave të publikuara nga Shërbimi Federal i Doganave të Rusisë (FIS), vëllimi tregtar midis Rusisë dhe BE-së u rrit në 119.7 miliardë dollarë në periudhën janar-maj të këtij viti, duke arritur në 22.1 për qind në krahasim nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Eksportet e Rusisë në BE në të njëjtën periudhë u rritën me 24.5 për qind në 2017 në 83.4 miliardë dollarë, ndërsa importet e Rusisë nga ky rajon u rritën me 16.9 për qind në 36.3 miliardë dollarë. Edhe pjesa e Rusisë në vëllimin e përgjithshëm tregtar me BE-në në pesë muajt e parë të këtij viti me një rritje prej me 0.5 pikë është rritur në 44.6 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rusia ndaj të cilës BE-ja për shkak të aktiviteteve të saj në Ukrainë filloi zyrtarisht zbatimin e sanksioneve më 1 gusht 2014, ajo nuk lejoi hyrjen në vend të disa produkteve që vijnë nga këto vende duke zbatuar embargo për produktet e vendeve të BE-së./AA

Edhe pse numri i turistëve të huaj që vizituan vendin gjatë muajit Qershor u rrit me 58 mijë vizitorë më shumë, ra në sy një rënie drastike në të dhënat që vijnë nga disa vende të Europës.

Anglia, Polonia, Gjermania dhe Zvicra regjistruan një numër më të vogël se ecuria e deriatëhershme. Çfarë kanë këto shtete të përbashkët? Ato ishin kualifikuar në Kampionatin Botëror, i cili nisi më 14 Qershor, dhe grupet e mëdha të tifozerive udhëtuan drejt Rusisë për të mbështetur ekipin kombëtar.

Krahasuar me periudhën Janar-Maj, raporton SCAN, ecuria vjetore e hyrjeve nga Anglia ra me 15.3 pikë përqindje, për Gjermaninë ra me 22.8 pikë për-



qindje, ndjekur nga Polonia me një rënie prej 17.5% dhe Zvicra me 3.4%.

Rënia e individëve që prenotuan pushime gjatë Qershorit u vu re edhe nga tur operatorët e këtyre vendeve, me në veçanti

Britaninë e Madhe, ku mbërritja e Anglisë deri në gjysmëfinale të kompeticionit i shtyu më tej pushimet. Ndërsa në rastin e Gjermanisë, e cila u eliminua në fazën e grupeve, shtyrja e rezervimeve zgjati vetëm dy javë, megjithatë

dha efekt negativ në uljen me rreth 15% të prenotimeve për destinacione të ndryshme turistike.

Menjëherë pas përfundimit të Kupës së Botës, tur operatorët regjistruan një bum prenotimesh me mbi 250% rritje krahasuar me ditët e mëparshme, çka do të thotë se gjithsesi tifozët nuk do të heqin dorë nga bregdeti.

Të ndikuar nga Kupa e Botës mund të jenë edhe tifozët e Suedisë dhe Danimarkës, ku vendi ynë është një destinacion shumë në modë vitet e fundit.

Në rastin e Shqipërisë, kjo do të thotë se rreth 5 mijë turistë të munguar në datën e zhvillimit të kampionatit, mund të vizitojnë vendin tonë në fund të Korrikut apo gjatë muajit Gusht.

Rrjedha Turke, fillojnë ndërtimet

Kanë filluar punimet për ndërtimin e impiantit të kalimit të tubacionit nga deti në tokë të linjës gazsjellëse "Rrjedha Turke", e cila do të transportojë gazin natyror rus nëpërmjet Turqisë në Evropë.

Në kuadër të këtyre punimeve në fund të detit do të gërmohen kanalet për tubacion në gjatësi 2,4 km.

Bëhet e ditur se tubat e gazsjellësit do të vendosen në kanalet e gërmuara me qëllim që të mos ndikohet nga lëvizjet e valëve dhe nga aktivitetet e peshkimit, ndërsa punimet do të zgjasin 4-8 javë.



Anija "Pioneering Spirit", që është anija më e madhe e ndërtimit të tubacioneve në botë, po

vazhdon pa ndërprerë punimet e filluara më 26 qershor për shtrimin e linjës së dytë të tubacionit.

Ndërkaq njoftohet se ka filluar faza e fundit e ndërtimit të impiantit lidhës në bregdetin e qytetit Anapa të Rusisë.

Sipas kalendarit të projektit planifikohet që rrjedhja e gazit natyror të fillojë në fund të vitit 2019, ndërkaq edhe punimet vazhdojnë sipas këtij kalendarit.

Tubacioni gazsjellës i "Rrjedhës Turke" që do të transportojë gazin rus në Evropë nëpërmjet Turqisë, përbëhet prej dy linjave me kapacitet 15,75 miliardë metra kub në vit secila./TRT TURKEY

NË KOSOVË NUK MUND TË KETË SHUMË ZONA TË LIRA EKONOMIKE

Krijimi i zonave të lira ekonomike sipas profesor Muhamet Sadiku duhet të vihet në kontekst të madhësisë së Kosovës si shtet dhe si ekonomi e tregut. Ai thotë se të gjitha qytetet në Kosovë nuk mund të bëhen zona të lira ekonomike



Kosova do të mund të funksiononte edhe vetëm si një zonë e lirë ekonomike.

Zonë e lirë ekonomike është një territor që ka një status të veçantë ekonomik. Ligji për zonat ekonomike në Kosovë parashihet katër lloje të zonave të lira ekonomike: zonat ekonomike apo parqet industriale, parqet teknologjike si dhe qendrat inovative. Eksperti i çështjeve ekonomike,

Muhamet Sadiku, thotë për Radion Evropa e Lirë se shumica nga këto zona ekonomike janë themeluar pa ndonjë analizë ekonomike në raport me tregun ndërkombëtar, në raport me investimet e jashtme dhe në raport me liberalizimin tregtar në përgjithësi.

Zonat ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë janë: parku i biznesit në Drenas pastaj në Mitrovicë, parku teknologjik në

Skenderaj, zona industriale në Suharekë, parku industriale holandez në Prizren, parku i biznesit në Vushtrri, parku teknologjik në Shkëmbin, zona ekonomike në Gjiçan si dhe zona ekonomike në Ferizaj.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi thotë për Radion Evropa e Lirë se në rastin e Kosovës, vendimet për zonat e lira ekonomike më shumë janë politike.

"Kushtet që po shkojmë tash ku secili kryetar komune ose secili ministër po dëshiron të ketë një zonë ekonomike unë mendoj që jo vetëm që nuk do të jenë funksionale, por do ta degradojnë tërë konceptin e zonës ekonomike".

Krijimi i zonave të lira ekonomike sipas profesor Muhamet Sadiku duhet të vihet në kontekst të madhësisë së Kosovës si shtet dhe si ekonomi e tregut. Ai thotë se të gjitha qytetet në Kosovë nuk mund të bëhen zona të lira ekonomike.

"Më mirë është të shpallet Kosova e tëra zonë e lirë ekonomike sesa 30 qytete në Kosovë të shpallin vetën zona të lira ekonomike me qasje të ndryshme ndaj investitorëve të jashtëm. Prandaj, do të ishte mirë që Qeveria e Kosovës të ndalet të bënë një analizë serioze në lidhje me efektin mundshëm të këtyre zonave të ekonomisë së lirë", thotë Sadiku.

Krijimi i zonave të lira ekonomike në Kosovë nga përfaqësues të institucioneve të vendit në vazhdimësi ishte theksuar si një përparësi për tërheqjen e investimeve ndërkombëtare.

Por, pavarësisht krijimit të këtyre zonave të lira ekonomike, ekspertët e fushës thonë se Kosova vazhdon të mbetet një nga ekonomitë më të pazhvilluara në rajon me një rritje ekonomike jo më shumë se 4 për qind dhe më shkallë të lartë të papunësisë mbi 30 për qind. /RADIO EVROPA E LIRË

Sipas nenit 21 paragrafi 1 nga Ligji për Akademinë Ushtarake („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 83/2009), Akademia Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostolli“ - Shkup shpall

KONKURS

për regjistrimin e studentëve/kadetëve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në ciklin e parë të studimeve në Akademinë Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostolli“ - Shkup për vitin akademik 2018/2019

Akademia Ushtarake “Gjeneral Mihailo Apostolli” – Shkup shpall Konkurs për regjistrimin e studentëve/kadetëve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në ciklin e parë të studimeve në Akademinë Ushtarake për 25 kandidatë edhe atë:

Studimet e ciklit të parë të studimeve organizohen sipas programeve studimore të akredituara me ligj, normativa, standarde dhe metodologji të pranuar nga hapësira e vetme Evropiane për arsim të lartë, të vlerësuara me kredi sipas EKTS-së. Programet studimore të ciklit të parë të studimeve në Akademi përbëjnë 240 kredi dhe zgjasin katër vite. Çdo vit në programin studimor përmban 60 kredi.

TË DREJTË PJESËMARRJEJE NË KONKURS

Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
 - të kenë kryer maturën shtetërore, maturë ndërkombëtare, maturë shkollore në arsimin gjimnazial apo të kenë dhënë provimin e arsimimit profesional të mesëm në kohëzgjatje katër vjeçare;
 - mos të jenë më të moshuar se 21 vjeç në ditën e aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve dhe
 - të jenë të aftë psiko-fizikisht (vërtetohet përmes komisionit ushtarako-mjekësor).
- Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e veçanta:
- të mos të kenë marrë masë ndaluese për kryerje të profesionit, aktivitetit apo detyrës;
 - të plotësojnë kriteret e sigurisë sipas Ligjit për Informata të Klasifikuara, që i vërteton shërbimi përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe
 - me sukses të kenë kaluar testin për aftësi fizike me Test - program për kontrollimin e aftësive motorike të studentëve/kadetëve dhe të studentëve të programeve të akredituara studimore në ciklin e parë të studimeve në Akademi

Kandidatët shtetas të Republikës së Maqedonisë që kanë kryer arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë apo një pjesë të arsimit të mesëm jashtë shtetit, si dhe kandidatët të cilët kanë mbaruar maturën ndërkombëtare, regjistrohen në kushte të barabarta dhe kriteret e ciklit të parë të studimeve.

Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për shkolim në Akademi mbahet llogari për përfaqësim përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive etnike dhe zhvillim të perspektivës gjinore, duke respektuar parimet e profesionalizimit dhe kompetencave.

Në pajtim me Ligjin për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, fëmijët e pjesëtarit të vrarë apo të ndjerë të forcave të sigurimit dhe fëmijët e invalidit të luftës nga grupi I deri VII invaliditet të luftës do të kenë përparësi gjatë regjistrimit në Akademinë, me kusht që ti plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe të plotësojnë minimum pikë të vërtetuara në Konkurs.

KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR REGJISTRIMIT

Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për regjistrim të ciklit të parë në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolli" - Shkup, vitin akademik 2018/2019 krahas kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- suksesi përgjithshëm i kandidatëve në të gjitha lëndët të arritur në arsimin e mesëm;
- suksesi i maturës shtetërore;
- suksesi nga provimi i realizuar pranues nga matematika;
- suksesi i provimit të realizuar me shkrim nga gjuha angleze dhe
- suksesi i arritur nga testi i aftësive fizike.

VLERËSIMI I SUKSESIT

Vlerësimi i kriterëve shprehet me pikë. Numri maksimal i pikëve që kandidati mund ta fitojë sipas të gjitha kriterëve është 100 pikë. Suksesi i përgjithshëm i kandidatëve në të gjitha lëndët, i arritur në arsimin e mesëm merr pjesë me më së shumti 35 pikë.

Në suksesin e përgjithshëm të arritur në arsimin e mesëm, si kriter për regjistrim, shtohet:

- suksesi i maturës shtetërore ose maturës ndërkombëtare, me më së shumti 25 pikë;
- suksesi i provimit pranues nga lënda e matematikës, me më së shumti 15 pikë;
- suksesi i provimit pranues nga gjuha angleze, me më së shumti 15 pikë;
- suksesi nga kontrollimi i përgatitjes fizike vlerësohet me më së shumti 10 pikë.

Vlerësimi i suksesit në arsim të mesëm bëhet si vijon: mbledhen të gjitha notat e dëftesave nga të gjitha vitet, shuma e fituar ndahet nga numri i notave dhe kështu mesatarja e fituar shumëzohet me 7. Në këtë mënyrë mund të merren maksimum 35 pikë.

Për kandidatët të cilët kanë kaluar maturën shtetërore në vitin shkollor 2015/2016, 2016/2017 dhe 2017/2018 vlerësimi i suksesit të maturës shtetërore bëhet si vijon: për të gjithë kandidatët lëndë e detyrueshme ekstere nga matura shtetërore është gjuha amtare (E1), lëndët tjera (ekstere dhe interene) të cilët kandidatët i zgjedhin në dhënien e provimit shtetëror, të cilat janë të rëndësishme për t'u regjistruar në Akademinë Ushtarake janë:

Lëndë zgjedhore ekstere (E2): matematika (niveli elementar), matematika (niveli i avancuar) ose gjuhë e huaj.

Lëndë interne:

- për gjimnaz: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), informatikë, fizikë, kimi, histori, sociologji dhe gjeografi (dy lëndë II dhe l2);
- për arsimin e mesëm profesional: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), biznes, informatikë, fizikë, kimi, histori dhe një lëndë profesionale (dy lëndë II dhe l2).

Për dy lëndët ekstere:

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin në lëndën ekstere, notës së lëndës ekstere i shtohet koeficienti 0,6 dha asaj i shtohet rangi perceptim i kandidatit (i shprehur në përqindje) për lëndën përkatëse i ndarë me 25;
- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore si lëndë ekstere kanë dhënë lëndën e matematikës (niveli i avancuar), pikët e përlogaritura për këtë lëndë në pajtim me qëndrimin e mëhershëm, ndalen.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më shumë 14 pikë për dy lëndët ekstere, gjegjësisht 21 pikë për kandidatët të cilët kanë dhënë lëndën e matematikës (niveli i avancuar).

Për dy lëndët interne:

- Notat nga secila prej lëndëve interne që jepen nga matura shtetërore ndërsa janë të rëndësishme për Akademinë shumëzohen me koeficientin 0,8;
- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore si lëndë interne kanë dhënë matematikën (niveli i avancuar), pikët e përlogaritura për këtë lëndë ndahen;
- Notat nga secila prej lëndëve interne që testohen në maturën shtetërore, dhe të cilat janë jo të rëndësishme për programin studimor ku kandidati konkurron, shumëzohet me koeficientin 0.

Në bazë të kësaj fitohen më shumë 8 pikë, gjegjësisht 12 pikë për kandidatët të cilët kanë dhënë provimin nga matematika (niveli i avancuar).

Për detyrën projektuese:

- Nota e fituar nga detyra projektuese shumëzohet me koeficientin 0,6. Në bazë të kësaj mund të fitohen më shumë 3 pikë.
- Për kandidatët të cilët kanë kaluar maturën shtetërore në vitin akademik 2013/2014, 2014/2015 dhe 2015/2016** vlerësimi nga matura shtetërore bëhet në mënyrën si vijon: për të gjithë kandidatët lëndë e domosdoshme ekstere nga matura shtetërore është lënda gjuhë amtare (E1), lëndët e tjera (ekstere dhe interene) që kandidatët i zgjedhin gjatë testimit të maturës shtetërore, dhe të cilat janë të rëndësishme për regjistrim në Akademi janë si vijon:

Lënda zgjedhore ekstere (E2): matematika (niveli elementar), matematika (niveli i avancuar) ose gjuhë e huaj.

Lënda zgjedhore ekstere (E3):

- për gjimnaz: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si E2), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si E2), informatikë, fizikë, kimi, histori, sociologji dhe gjeografi.
- për arsimin e mesëm profesional: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si E2), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si E2), biznes, informatikë, fizikë, kimi, histori dhe lëndë profesionale.

Lëndë interne (I1):

- për gjimnaz: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), informatikë, fizikë, kimi, histori, sociologji dhe gjeografi;
- për arsimin e mesëm profesional: matematikë (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), gjuhë e huaj (nëse nuk është zgjedhë si lëndë ekstere), biznes, informatikë, fizikë, kimi, histori dhe një lëndë e profesionale.

Për tri lëndët ekstere:

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin në lëndën ekstere që është e rëndësishme për programin studimor në të cilin konkurrojnë, nota e secilës lëndë ekstere shumëzohet me koeficient 0,4 dhe asaj i shtohet koeficienti në përqindje kandidatit (i shprehur në përqindje) për lëndën përkatëse i ndarë me 25;
- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore si lëndë ekstere kanë dhënë lëndën e matematikës (niveli i avancuar), pikët e përlogaritura dyfishohen;
- Për kandidatët që në maturën shtetërore kanë kaluar lëndën ekstere, që është jo i rëndësishëm për programin studimor ku kandidati konkurron, pikët nga kjo lëndë, të fituara sipas metodës së lartpërmendur, shumëzohen me faktorin 0.

Në bazë të kësaj fitohen më shumë 18 pikë nga të gjithë tri lëndët ekstere, gjegjësisht 24 për kandidatët që kanë dhënë provimin e matematikës (niveli i avancuar).

Për lëndën interne:

- Nota nga secila lëndë interne që testohet nga matura shtetërore, dhe e cila është e rëndësishme për programin studimor ku ka aplikuar kandidati, shumëzohet me koeficientin 0,8;
- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore si lëndë ekstere kanë dhënë lëndën e matematikës (niveli i avancuar), pikët e përlogaritura për këtë lëndë dyfishohen;
- Nota nga secila lëndë interne që testohet nga matura shtetërore, dhe e cila nuk është e rëndësishme për programin studimor ku ka aplikuar studentit, shumëzohet me koeficientin 0.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më shumë 4 pikë, gjegjësisht 8 për kandidatët që kanë dhënë provimin e matematikës (niveli i avancuar).

Për detyrën projektuese:

- Nota e fituar nga detyra projektuese shumëzohet me koeficientin 0,6. Në bazë të kësaj mund të fitohen më shumë 3 pikë.
- Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën ndërkombëtare vlerësimi bëhet në mënyrën në vijim: për katër lëndët mbledhen notat, shuma e fituar ndahet me katër, ndërsa pastaj ajo që fitohet shumëzohet me 4 (me çka fitohen më së shumti 20 pikë) dhe shtohet nota e temës së maturës (5 pikë).

Në këtë mënyrë mund të fitohen 25 pikë.

PROCEDURA PËR ZBATIMIN E KONKURSIT

Për realizimin e Konkursit për regjistrim në ciklin e parë të studimeve të Akademisë formohet komisioni i konkursit, komisioni për realizimin e provimit pranues nga lënda e matematikës dhe gjuhës angleze, komisioni për realizim të kontrollimit të përgatitjes fizike dhe komisioni për pranim të dokumenteve dhe për përpunimin e të dhënave.

Gjatë realizimit të provimit pranues, kandidatët duhet të kenë dokumente për përcaktim të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë).

Para se të fillojë testimi i përgatitjes fizike bëhet vërtetimi i gjendjes psikofizike të kandidatëve. Ky testim ka karakter eliminues.

Aftësia psikofizike e kandidatëve përcaktohet me pasqyrë specialiste dhe notë nga komisioni mjekësor ushtarak. Komisioni mjekësor ushtarak kryen kontrollim të aftësisë psikofizike në pajtim me Rregulloren për matjet për vlerësim të aftësisë së posaçme dhe shëndetësore dhe fizike për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë.

Procedura për realizimin e testimit për përgatitje fizike përbëhet nga kontrolli i përgatitjes fizike në disiplinën e mëposhtme:

	Kërcim në largësi nga vendi		Qëndrim në traversë		Ushtrime barku		Vrapim	
	M	F	M	F	M	F	M 1600 m	F 800 m
Pikë minimale	Centimetra		Përsëritje	Qëndrime në traversë /sek.	Ngritje		minuta	
	180	120	3	3	25	25	8,00	6,00

Testimi i përgatitjes fizike ka karakter eliminues dhe në procedurat e mëtejshme nuk renditen kandidatët të cilët nuk plotësojnë normat e parashikuara, apo ata të cilët nuk fitojnë së paku 50% të pikëve të parapara për secilën disiplinë veç e veç, gjegjësisht gjithsej 5 pikë nga 10 pikët e mundshme për të gjitha disiplinat.

Gjatë testimit të aftësive kandidatët duhet të kenë me vete dokumente për identifikim (letërnjoftim ose pasaportë).

Renditjen e kandidatëve e bën Komisioni i Konkursit. Kushti për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim në Akademi është të fitohen së paku 60 pikë, të marra nga të gjitha kriteret nga 100 pikë të mundshme.

Në afat prej 24 orëve pas realizimit të kontroleve të përgatitjes fizike, Komisioni i konkursit përpilon dhe publikon në tabelën për shpallje të Akademisë rang-listën preliminare të rezultateve të fituara për kandidatët për regjistrim në ciklin e parë të studimeve në Akademi.

Në rang-listën preliminare theksohet numri i pikëve nga arsimit i mesëm (suksesi mesatar), numri i pikëve nga matura shtetërore (suksesi mesatar), numri i pikëve nga provimet e realizuara pranues nga lënda e matematikës dhe gjuhës angleze, numri i pikëve nga kontrollimi i përgatitjes fizike dhe numri i përgjithshëm i pikëve për secilin kandidat.

Në rang-listën preliminare, kandidati ka të drejtë të ankoher deri te Drejtoria e dekanatit të Akademisë pranë Komisionit të Konkursit brenda 24 orëve nga koha e publikimit të saj.

Ankesa dorëzohet personalisht në lokale të Akademisë ushtarake në Shkup në rr. “Vasko Karangeleski” pn.

Vendimet në lidhje me ankesat publikohen në tabelën për shpallje dhe në ueb faqen e Akademisë në afat prej 24 orëve nga kalimi i afatit për parashtrim të ankesave.

Vendimi i Drejtorisë së Akademisë në lidhje me ankesat është përfundimtare, pas së cilës Komisioni i konkursit e publikon rang-listën përfundimtare në tabelën për shpallje dhe ueb faqen e Akademisë.

Në rast se nuk ka të dorëzuara ankesa, rang-lista preliminare bëhet përfundimtare pas kalimit të afatit për dorëzim të ankesave.

Në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë pikë të barabarta dhe nuk mund të bëhet përzgjedhja e numrit të paraparë të kandidatëve për pranim na Akademi, përparësi në zgjedhje do të kenë kandidatët – fitues të çmimeve në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha të rëndësishme për programin përkatës studimor. Llojin dhe përshatshmërinë çmimesve dhe mirënjohjeve e përcakton Komisioni i konkursit.

Pas publikimit të rang-listës, këshilli mësimor-shkencor i Akademisë Ushtarake miraton propozim mendim mbi të dhe të njëjtin ia dorëzon ministrit të mbrojtjes, i cili merr vendimin përfundimtar për pranimin e kandidatëve nga lista.

AFATET

Kandidatët e interesuar për pranim në Akademinë Ushtarake për vitin akademik 2018/2019 mund të aplikojnë në afatin e parë regjistruar më datë **15 dhe 16.08.2018**, prej orës **8,30** deri në ora **16,30** Nëse në afatin e parë pranues nuk plotësohet numri i planifikuar i kandidatëve, Akademia Ushtarake do të organizojë një afat të dytë regjistrimi më datën **11.09.2018**.

Pas përcaktimit të listave për paraqitje, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për të testuar aftësitë psikofizike dhe gjendjen fizike dhe për dhënien e provimeve pranuese për matematikë dhe gjuhë angleze..

DOKUMENTET PËR APLIKIM NË KONKURS

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Lutje, që merret në Akademinë Ushtarake;
- aplikacionin që merret në Akademinë Ushtarake;
- dëftesa për të gjitha katër vitet e shkollës së mesme në origjinal;
- diplomë për provimin e maturës shtetërore në origjinal;
- certifikatë shtetësie në origjinal;
- certifikatë të lindjes në origjinal;
- vërtetim nga gjyqi përkatës se nuk është marrë masë sigurie si ndalesë për kryerje profesioni, veprimtarie ose detyre.
- vërtetim nga mjeku amë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kandidatit.

Kandidatët të cilët provimin e maturës e kanë dhënë në vitin shkollor 2017/2018, diplomën për provimin e dhënë të maturës mund të dorëzojnë në mënyrë plotësuere, a më së voni deri me datën 31.08.2018.

Kandidatët shtetas të Republikës së Maqedonisë që arsimin e mesëm apo një pjesë të arsimit të mesëm e kanë përfunduar jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokument të lëshuar nga Ministria kompetente për nostrifikim të dëftesave për të gjitha vitet, për pjesën e viteve të mbaruara jashtë shtetit ose për diplomën e arsimit të mesëm të marrë jashtë vendit.

Dokumente për aplikim në konkurs kandidatët duhet t'i dorëzojnë personalisht në Akademinë Ushtarake në Shkup, rr.Vasko Karangeleski "p.n.

SHKOLLIMI, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E STUDENTËVE

Kandidatët të cilët janë paraqitur në ciklin e parë të studimeve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes, gjegjësisht të Armatës së Republikës së Maqedonisë pas përfundimit të studimeve marrin statusin studentë/kadetë.

Gjatë kohës së shkollimit studentëve/kadetëve u sigurohen: akomodim në internate, ushqim, uniforma, veshje të brendshme dhe mbathje, tekste shkollore dhe mjete të tjera si dhe pajisje ndihmëse të nevojshme për studime, pa kompensim, sigurim shëndetësor dhe invalidor, pagesa mujore për të mbuluar nevojat personale më elementare, shpenzime të rrugës për ardhje në Akademi dhe kthim në fillim dhe mbarim të çdo viti shkollor dhe gjatë pushimit shkollor, si dhe shpenzime rrugore për tu dërguar në praktikë nga Akademia ushtarake.

Të drejtat dhe obligimet e posaçme mes studentëve/kadetëve dhe Akademisë ushtarake rregullohen me marrëveshje në pajtim me Ligjin për Akademi ushtarake dhe Statutin e Akademisë ushtarake.

Pas përfundimit të shkollimit studentët/kadetët dalin me rangun nëntoger nga gjinia përkatëse dhe pranohen në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në punë në Ministrinë e mbrojtjes.

PASOJAT E ZJARREVE NË GREQI

DEL FOTO E ÇIFTIT SHQIPTAR QË PËRFUNDOI NË SPITAL

Situata në zonën e Atikës në Greqi është ende shumë e rrezikshme, ndërsa deri më tani raportohet për të paktën 60 viktima dhe më shumë se 160 të lënduar.

Raportohet se fatkeqësisht ka tre viktima shqiptarë, ndërsa disa prej shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë atje kanë përfunduar në spital nga asfiksia. Një çift shqiptarësh, të cilët shkuan për ndihmë mjekësore në spital, folën për Top Channel:

“Përfunduar në spital nga tymi i tepërt. Bashkëshortja nuk merrte dot frymë. Pësoi akth. Nuk merrnim dot frymë”.

Kjo zonë është shumë e populluar nga shqiptarët, dhe gjatë këtyre orëve reporterja e News24 ka pasur kontakt me disa prej tyre.

Cazetarja tha se brenda makinës së një shqiptari është gjetur një viktimitë, por ende nuk dihet nëse është trup i një të riu nga Tepelena.

Ndërkohë, ajo është shprehur se nga dëshmitë që ka pasur nga shqiptarët që kanë mundur t'u shpëtojnë flakëve, i është pohuar se favori që ata kanë pasur, ka qenë njohja e mirë e zonës, pasi jetojnë aty edhe gjatë dimrit, dhe kjo i ka ndihmuar që të largohen përmes rrugicave dhe të dalin më shpejt në det.

Pjesa më e madhe e viktimave janë gjetur të shkrumbuar në makina, duke



mos pasur mundësi të largohen.

“Në fakt në zonën e zjarreve ka pasur shumë shqiptarë të cilët punojnë nëpër shtëpitë e grekëve. Kemi informacion se 13 shqiptarë janë lënduar nga flakët. Kam folur me shumë prej tyre. Flitet edhe për një djalë nga Tepelena që dyshohet se është djegur në makinën e tij, por nuk e dimë 100% të saktë, u shprej një emigrant shqiptar.

Një tjetër emigrante shqiptare nga Athina, Drita Bushi në një lidhje telefonike për Report Tv thotë se janë djegur 10 banesa të shqiptarëve, ndërsa situata është mjaft e rëndë.

“700 banesa janë djegur, shumë njerëz humbën jetën, pashë një fëmijë dy muajsh, që humbi jetën nga zjarri.

10 banesa të shqiptarëve janë djegur nga zjarri. Një familje shqiptare erdhi më kërkoi ndihmë dhe më tha u dogji cdo gjë. Ajo tha u futëm në det dhe erdhën anijet na morën. Një burrë më tha po rrija në ballkon, u hodha në det për të shpëtuar. Në një party u dogjën 25 persona. Shqiptarë nuk e dimë akoma a ka të vdekur, nuk e kemi marrë vesh akoma. Skenat janë si në filma. Situata nuk është aspak e mirë, po gjenden shumë njerëz të vdekur. Thonë që janë 50 të vdekur, por numri është më i lartë. Nuk kemi kontakte me ambasaden shqiptare, nuk e di numrin e telefonit, po ndihmojmë njerëzit me ushqime dhe strehim ketu”, është shprehur ajo.

Vëllai vret vëllanë në Lipjan



Zëdhënësja e Policisë rajonale të Prishtinës, Flora Ahmeti, ka konfirmuar për Express se të martën rreth orës 13:00, policia është njoftuar për vrasjen e një personi në Lipjan. “Sot

rreth orës 13:00 kemi pranuar informata për një rast vrasje në fshatin Tërbovc të Lipjanit. Menjëherë pas marrjes së këtij informacioni në vendin e ngjarjes kanë dalë të gjitha një-

sitet e nevojshme policore, të mbështetura edhe nga njësi rajonal për hetimin e krimeve si dhe njësitë e tjera për ekzaminim të vendngjarjes”, ka thënë ajo.

Me të dalë në vendin e ngjarjes policia ka konstatuar se ka të bëjë me vrasje, ku viktima: M.G. mashkull, 54 vjeç, duke mos mundur tu përballoj plagëve të marra nga arma e zjarrit ka ndërruar jetë. Vdekjen e viktimes e ka konstatuar ekipi mjekësor në vendin e ngjarjes. Aktualisht policia me një intensitet të shtuar ka ndërmarrë një varg veprimesh operative e hetimore, në përpjekje për të ndriçuar dhe sqaruar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me rastin. Personi i dyshuar është identifikuar dhe po kërkohet nga ana e policies.

Në Pejë gruaja shtrihet në mes të rrugës, u kërkon veturave që ta shkelin

Një grua është shtrirë në mes të rrugës duke kërkuar nga veturat që ta shkelin.

Arsyet e këtij veprimi duket se janë për shkak të kushteve të rënda ekonomike. Indeksonline ka siguruar pamje nga kjo ngjarje e cila ka ndodhur në Pejë, afër stacionit të autobusëve.



KRONIKË E POLLOGUT

Aksidentohet për vdekje këmbësori 79 vjeçar

Tetovë, 24 korrik- Të hënën në rrugën “JNA” në Tetovë, një veturë e tipit “Porsche Kaen” me targa të Gjermanisë, e vozitur nga 21-vjeçari A.Sh. nga fshati Jazhincë i Tetovës, e ka goditur një plak 79-vjeçar me iniciale V.P nga Bërvenica

Nga aksidenti, plaku ka marrë lëndime të rënda (gjakderje në tru) dhe menjëherë është dërguar në Spitalin e Tetovës dhe pas ndihmës mjekësore të ofruar është dërguar në klinikat e Shkupit për mjekim të mëtutjeshëm. Është kryer ekspertizë në vendngjarje dhe po konfirmohet për shkaqet e aksidentit.

7 vjeçarit i gjendet pistoletë dhe mariuhanë

Gostivar, 24 korrik- Pjestarët e policisë nga Zyra e jashtme për punë kriminalistike të Gostivarit, të hënën mbrëma prej ora 19 e 30 minuta deri ora 21.00, kanë kryer bastisje në shtëpinë e 17 vjeçarit nga fshati Çegan i Gostivarit. Gjatë bastisjes së kryer me urdhër të gjykatës, në dhomën e tij në shtëpi janë gjetur, pistoletë “Zoraki” me kalibër 9 milimetër dhe dy plumba të të njëjtit kalibër, një qese najlloni, me mariuhanë, një shkop bejzbolli, dy boksa metalik, një thikë, një sprej dhe një cigare e mëshjtjellur. Gjësendet e gjetura janë fotodokumentuar dhe me vërtetim janë marur për ekspertizë, ndërsa personi minoren në prezencë të prindit të tij, është arrestuar në Stacionin policorë në Gostivar, dhe është mbajtur për procedurë të mëtutjeshme.

Arrestohen dy femra në një lokal nate

Tetovë, 24 korrik- Të martën mbrëma duke filluar nga ora 23.00 e deri pas mesnate, pjestarët të policisë nga Sektori për Punë të Brendëshme në Tetovë, kanë realizuar kontroll në objekt hotelierik, përgjatë rrugës regjionale, Zhelinë-Siriçinë, pronë e 26 vjeçarit Q.B. nga fshati Zhelinë e Tetovës. Në objekt gjatë kontrollit janë ndaluar 6 femra, nga të cilat 2 shtetase të Shqipërisë dhe një shtetase e Kosovës, si dhe 3 shtetase të Maqedonisë. Dy nga tre shtetaset e huaja, si dhe pronari i objektit, janë arrestuar në Stacionin policorë të Tetovës për procedurë të mëtutjeshme.

Ofendon policët, arrestohet 49 vjeçari

Gostivar, 24 korrik- Pjestarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendëshme Tetovë- Stacioni policorë Gostivar të martën duke regulluar trafikun në rrugët “Vëllezërit Gjinovski” dhe “Major Çede Filipovski” në Gostivar, ndërsa 49 vjeçari C.C. nga fshati Debresht, i cili ka drejtuar veturën e tipit “Mercedes” fillimisht nuk e ka respektuar urdhërin e tyre, me të cilën është sjellur në mënyrë agresive, pastaj edhe rëndë i ka ofenduar dhe fyer pjestarët e policisë. Personi C.C. menjëherë është arrestuar në Stacionin e policisë- Gostivardhe pasë zbardhjes së plotë të rastit, do të ballafaqohet me padi adekuate

Lëndohet një puntorë në guroren në Gostivar

Gostivar, 24 korrik- Në guroren e një kompanie private, me lokacion në rrugë magjistrale Gostivar-Kërçovë, në vendin e quajtur “Guri i Reçanit” 55 vjeçari B.B. nga fshati Reçan, i punësuar në kompani, duke punuar është lënduar duke prerë dhe thyer gishtin e dorës së djathtë. I lënduari B.B. me veturë është dërguar në Spitalin e përgjithshëm “Ferid Murad” në Gostivar dhe pas dhënies së ndihmës mjekësore është lëshuar në mjekim shtëpiak. Pasë kryerjes së hetimeve janë duke u zbardhur të gjitha detajet në veçanti lidhur me rastin.

Fundi i shekullit të 20-të dhe fillimi i shekullit 21 u karakterizuan me luftëra të përgjakshme, me një seri tërmetesh të fuqishme, me tajfune dhe me zjarre shkatërruese në disa rajone të botës që kanë rezultuar me shumë viktime në njerëz dhe dëme të mëdha materiale.

Zhvillimi i hovshëm ekonomik dhe industrial pa norma të kontrolluara ekologjike kanë ndikuar në shtimin e gropave të ozonit në atmosferë, gjë që ka shkaktuar rritjen e temperaturave të ajrit duke shkaktuar shkrijen e shpejtuar të akullnajave të Politi të Veriut dhe ka bërë ndryshime të mëdha klimatike të manifestuara diku me rreshje të mëdha atmosferike, me tajfune e diku me thatësira enorme.

E tërë kjo ka bërë që disa vende të botës të zhvillohen dhe forcohen ekonomikisht ndërsa pjesa më e madhe e botës vuan edhe për gjërat elementare jetike dhe për bukën e gojës.

Shembuj bindës për këto padrejtësi kemi edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ku SHBA-të në mbrojtje të cionizmit të Izraelit që ka okupuar tokat e Palestinës dhe që ushtron terror të paparë ndaj popullit palestinez duke bombarduar dhe shkaktuar shumë viktime, e dëme materiale, vendosën veto ndaj rezolutave që janë në favor të popullit palestinez. Ndërkaq Rusia është vënë në mbrojtje të Sirisë dhe të pushtetit diktatorial të Bashar el Asadit i cili ka shkaktuar shumë viktime në popullin e tij, kështu që Rusia përveçse me armatime dhe bombardime të aviacionit të saj, me veto nuk lejon që të miratohen rezolutat e Këshillit të Sigurimit me të cilat rregjimi i Asadit akuzohet për krime kundër njerëzimit. Kina gjithashtu është vënë në mbrojtje të rregjimit të shtetit Mianmar dhe me veton e saj nuk lejon që ky rregjim gjakatar i cili vritin që shkoi bëri gjenocidin dhe spastrimin etnik të mijëra muslimanëve Rahinjë nga trojet e tyre, gjë që logjikisht duhet ta kishte marrë dënimin e merituar.

SHTETET E ZHVILLUARA NXISIN TRAZIRA

Statistikat flasin se pjesa më e madhe e pasurisë është në duart e një numri të vogël të personave. Pasuritë e mëdha asesi nuk mund të arrihen në mënyrë të ndershme dhe të ligjshme, por shekujt dhe jeta kanë treguar se këto pasuri kolosale arrihen vetëm me rrugë dhe sjellje të pista.

Fajtorë kryesorë për trazirat, konfliktet dhe luftërat e përgjakshme në shumë vende janë shtetet e mëdha e të zhvilluara ekonomiki-sht, të cilat nëpërmjet këtyre luftë-

rave krijojnë mundësitë e prosperitetit të tyre ekonomik, fillimisht duke i shkaktuar këto vatra të luftës, duke u shitur armatim, e më pas duke ndërmjetësuar gjoja për armëpushim dhe paqe, që më pastaj të marrin pjesë aktive në ndërtimin e të gjithë asaj që e kanë shkaktuar.

E tërë kjo përveç vrasjeve, djegieve dhe shkatërimeve materiale ka shkaktuar edhe eksodin masovik të njerëzve nga këto vatra të pasigurta të përfshira nga luftërat për në teritoret më të sigurt për jetën.

Të gjitha mjetet informative të shkruara dhe elektronike në botë kanë raportuar dhe informuar për dyndjen e këtyre refugjatëve nga vendlindja e tyre të përfshira me luftëra dhe skamje drejt shteteve më të zhvilluara ku mendojnë dhe shpresojnë për një jetë të sigurtë.

Lidhur me këtë çështje është e udhës ta imagjinojmë situatën sikur ne të jemi në vendin e tyre. Shpresoj se shumë nga ne e kanë përjetuar situatën kur kanë udhëtuar nga vendlindja, qyteti ose fshati i tyre për në ndonjë vend tjetër, edhe pse udhëtimi ka qenë komod dhe në vendin ku kemi arrihur i kemi të gjitha kushtet dhe hotelin e siguruar, megjithatë zemrën

na e kaplon një zbrazëti dhe ftohje e shpirtit sepse vendi ku kemi arrihur nuk i ngjan vendlindjes tonë dhe se e kemi vështirë të përshtatemi. Kjo na shtyn të mendojmë dhe të perceptojmë një situatë të cilën mund ta parafytyrojmë përafërsisht kur këta refugjatë pas luftërave shkatërrimtare kanë humbur çdo gjë, kanë humbur shtëpitë dhe pasuritë, kanë humbur ardhmërinë dhe sigurinë për jetë dhe në këto vështirësi kanë vendosur dhe kanë marrë guximin të kalojnë mijëra kilometra duke përjetuar vështirësi të paimagjinueshme vetëm e vetëm për ta shpëtuar jetën e tyre, të familjes së tyre dhe të fëmijëve të tyre me një fije shprese se ndoshta do tu shpëtojnë kthetrave të vdekjes. Këtyre viteve kemi parë skena nga më trishtueset të këtij rrugëtimi të refugjatëve të mjerë në mesin e të cilëve kemi persona të të gjitha moshave. Të parët shaktarë të këtij eksodi janë nxitësit e luftërave, pastaj vijnë palët e nxitura për të luftuar mes vedit, pastaj vijnë kontrabandistët e llojllojshëm të cilët si ushujëza vërsulen me premtime e mashtrime vetëm për të fituar para nga këta refugjatë të mjerë.

Mjerimi i refugjatëve

Nga
Rexhep Torte



PERIPETITË E REFUGJATËVE


Refugjatët e raskapitur nga udhëtimet nga vështirësitë dhe lodhja nuk është vështirë ti mashtrosh e ti manipulosh, sepse ata në mendjen e tyre e kanë shpresën për të shpëtuar jetën. Këmbët e këtyre refugjatëve kalojnë nëpër fusha, malë e detëra duke u ngjarë miliongonave mijëra prej tyre e humbin jetën në udhëtim në tokë apo në det dhe vetëm një pjesë e tyre arrijnë në destinacionin e shpresuar.

Sipas njoftimeve në media më shumë se 1 milion refugjatë kanë kaluar edhe nëpër Maqedoni. Kemi parë në emisionet televizive se të shumtën e herëve si trase e udhëtimit dhe e orientimit u shërbejnë binarët hekurudhorë dhe ka patur raste kur me dhjetëra refugjatë të raskapitur nga lodhja kanë gjetur vdekjen me këto shina hekurudhore. Kemi patur rastin të shikojmë në emisionet televizive edhe rrëfimin e dhimbshëm të këtyre refugjatëve duke deklaruar se kanë qenë pre e bandave grabitëse në teritorin e Maqedonisë me ç'rast u janë marrë paratë dhe stolitë e arit që i kanë patur me vete dhe disa prej tyre edhe janë torturuar fizikisht. Kemi patur rastin të shikojmë

Zgjidhja më e mirë do të ishte që shtetet e zhvilluara ekonomikisht të angazhohen në evitim të luftërave dhe në rimëkëmbjen ekonomike të shteteve të varfëra në botë, në mënyrë që banorëve të atyre vendeve tu sigurojnë vende pune dhe kushte elementare për jetë në mënyrë që banorët e këtyre vendeve të mos e kenë si alternativë braktisjen e vendlindjes marrjen e rrugës së emigrimit, kjo do të ishte zgjidhja më humane e këtij problemi.



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaška lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 24 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

edhe skena televizive në kufirin Greqi-Maqedoni kur ndaj refugjatëve të lodhur, të lagur nga shiu dhe të mërdhirë nga të ftohtit duke i mbajtur edhe fëmijët përdore të lagur deri në lëkurë janë goditur me shkopinje gome nga policia maqedonase, edhe pse këta refugjatë deklarorin se dëshironin ta kalojnë në mënyrë transite nëpër Maqedoni drejt shteteve të Evropës. Mendojmë se organet e sigurisë në Maqedoni kanë patur mundësi që ti pengojnë këto banda grabitqare për të mos i dëmtuar refugjatët dhe të demonstrojnë sjellje më njerëzore ndaj refugjatëve. Nuk duhet harruar se në Maqedoni kanë funksionuar edhe shumë organizata bëmirëse dhe aktiviste vullnetare të cilët maksimalisht u kanë ndihmuar nëpërmjet donatorëve të ndryshëm refugjatëve me ushqime e veshmbathje. Në këtë frymë të bamirësisë janë sjellë edhe shumë familje në Maqedoni në rrugën në të cilën kanë lëvizur refugjatët. Mbetet enigmatike fakti se mijëra refugjatë kanë ndërruar jetë edhe gjatë këtij rrugëtimi të vështirë dhe varret e tyre janë të vendosura si shenjë e këtij rrugëtimi.

Pranvera arabe që u quajt përmbysja e pushteteve diktatoriale në Tunizi, Libi e sidomos në Siri ku tashmë shënohet 7 vjetori i Luftimeve të ashpra ndërmjet opozitës së Sirisë të ndihmuar nga Shtetet e Perëndimit për ta rrëzuar pushtetin diktatorial nga Bashar el Asad nga njëra anë dhe forcave qeveritare të ndihmuara nga Rusia dhe Irani domosdo që u shkaktuan nga luftënxitja dhe që u shoqëruan edhe nga terrorizmi, kjo natyrisht shkaktoi më shumë se 300 mijë viktima, dhe një valë të madhe të dyndjes së refugjatëve, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite.

POLITIKAT GLOBALE NDAJ MIGRACIONIT

Nuk duhet anashkaluar as cionizmi izraelit ndaj popullit palestinez, cionizëm që manifestohet me okupimin e paligjshëm të trojeve palestineze, me ndërtimin e qendrave të reja të banimit, me ndërtimin e murit ndarës, me pengimin e lëvizjes së lirë të palestinezëve, me pengimin e ndihmave humanitare të dërguara për popullin palestinez dhe me bombardimet e njëpasnjëshme duke shkaktuar edhe një numër të madh të viktimave në rradhët e popullit palestinez. Këtu vlen të theksohet edhe lufta qytetare në Jemen. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe Afganistanin dhe Pakistanin. Shembull tronditës që shqetësoi forcat demokratike në botë është gjenocidi që ndodhi në vitin 2017 në shtetin Mianmar të Azisë kundër popullatës muslimane Rahinje, ku forcat ushtarake qeveritare ushtruan një dhunë dhe terror të përgjakshëm duke vrarë e djegur këtë popull të pafajshëm kështu që u detyruan afër 700 mijë refugjatë të shpërngulen me forcë në shtetin e Bangladeshit ku ndodhen edhe sot e kësaj dite në kushte shumë të vështira për jetë. E tërë kjo ndodhi para syve të botës demokratike e cila nuk ndërmori asgjë për ta ndërprerë këtë gjenocid të paparë. Numri i refugjatëve është shtuar dukshëm edhe nga shtetet afrikane të përfshira nga konfliktet, luftërat dhe thatësitë. Vendimi i disa shteteve evropiane për të mos i pranuar refugjatët është jo human dhe tejet i pa drejtë. Askush nuk e len dhe braktis vendlindjen e tij me dëshirë por vetëm të detyruar për të shpëtuar kokën nga luftërat ose nga papunësia e vobegësia. SHBA-të me politikën e pamaturë të presidentit Donald Trump u treguan me qëndrim të ashpra ndaj refugjatëve, qoftë nga vendet Islamike apo të Amerikës Latine. Ndër-

timi i murit në kufirin SHBA-Meksikë dhe ndarja e fëmijëve të refugjatëve nga prindërit e tyre është arroganca e rradhës që SHBA-të e bënë ndaj refugjatëve.

Agresioni i Serbisë ndaj Bosnjes dhe Hercegovinës në vitin 1995 shkaktoi dëme të mëdha materiale dhe gjenocidin në Srebrenicë dhe Potoçare ku u vranë mizorisht 8320 boshnjakë të të gjitha moshave.

Vuajtjet që i përjetojnë sot refugjatët nga vendet e ndryshme i ka përjetuar edhe populli shqiptar gjatë historisë së tij. Dihet se shqiptarët kanë jetuar në trojet e tyre gjer në Qupërli, përtej Nishit dhe janë detyruar nga ofansivat e përgjakshme serbe që të tërhiqen nga ato vende. Këto ofansiva kanë vazhduar edhe në fillim të shekullit të 20. Pastaj shqiptarët janë detyruar të shpërngulen nga torturat e rregjimit monist në Kosovë dhe Maqedoni duke gjetur shpëtim në shpërnguljen masive për në Turqi. Lufta e fundit në Kosovë në vitin 1999 e shkaktuar nga ofansiva e përgjakshme serbe e shkrumoi dhe e shkatëroi sërish Kosovën dhe detyroi të shpërngulen afër 1 milion shqiptarë për të shpëtuar nga vdekja. Kjo rezultoi me ndërhyrjen e NATO-s dhe me çlirimin e Kosovës, me ç'rast një pjesë e shqiptarëve të Kosovës u kthyen në vendlindje, ndërsa pjesa tjetër u detyrua të gjen ekzistencën në shtetet e ndryshme duke e shitur me çmime shumë të ulëta pasurinë e tyre të patundshme në vendlindje. Ndërkaq lufta e UÇK-së në Maqedoni u bë përshkak të mosekzistimit të të drejtave legjitime të Shqiptarëve, të cilët jetojnë në trojet e veta shekullore. Kjo luftë përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit, e cila sot e kësaj dite nuk është zbatuar në tërësi, përkundër garancive ndërkombëtare. Shqiptarët në Shqipëri eksodin e përjetuan pas rënies të sistemit të ashpër monist të Enver Hoxhës, në vitin 1997 duke kërkuar shpëtim jashtë kufijve të Shqipërisë në rrugë tokësore, detare dhe ajrore. Në këtë eksod jetën e humbën qindra shqiptarë duke u munduar që të emigrojnë me gomone nëpër rrugën detare drejt Italisë. Duke rënë pre e kontrabandistëve të shumtë. Ka shumë familje që edhe sot e kësaj dite janë në pritje të ndonjë lajmi të mirë se ndokush nga këto viktima ka mbetur i gjallë sepse humbja e tyre ka mbetur enigmë. Nga emisionet televizive mësojmë se një numër i konsiderueshëm i refugjatëve nga vendet e Azisë dhe të Afrikës kanë përjetuar një udhëtim të gjatë prej disa vitesh të shoqëruar me vuajtje të papërshkrueshme dhe tashmë kanë mbetur nëpër qendrat e emigracionit në Serbi, Bosnje, Kroaci, Itali dhe Maltë me shpresën se një ditë do të arrijnë në destinacionet Evropiane ku dëshirojnë.

Për tua ëmbëlsuar vuajtjet këtyre refugjatëve janë angazhuar shumë shoqata humanitare dhe aktiviste vullnetare në këto qendra pritëse të refugjatëve. Kohëve të fundit mësojmë për disa takime të krerëve qeveritarë të shteteve të Evropës për ta ndarë bashkarisht numrin e refugjatëve që synojnë në drejtim të shteteve të tyre, por që me keqardhje konstatojmë se edhe në këtë drejtim ka obstrukcione dhe mospajttime. Zgjidhja më e mirë do të ishte që shtetet e zhvilluara ekonomikisht të angazhohen në evitimin e luftërave dhe në rimëkëmbjen ekonomike të shteteve të varfëra në botë, në mënyrë që banorëve të atyre vendeve tu sigurojnë vende pune dhe kushte elementare për jetë në mënyrë që banorët e këtyre vendeve të mos kenë si alternativë braktisjen e vendlindjes marrjen e rrugës së emigrimit, kjo do të ishte zgjidhja më humane e këtij problemi.

Çfarë nuk shkon me tolerancën fetare?

Simon Rabinovitch

Qëllimi i tolerancës fetare, ka qenë gjithmonë dhe mbetet, ruajtja e fuqisë dhe pastërtisë së fesë dominante në një shtet të caktuar. Shumica e feve mbizotëruese në shumicën e shteteve, deklarohen sot tolerante, por gjithashtu duket se ndihen veçanërisht të kërcënuara. Lëvizjet nacionaliste fetare në Shtetet e Bashkuara, Europë, Indi, Turqi dhe Izraeli, duan të forcojnë marrëdhëniet midis identitetit shtetëror dhe fesë dominante. Në secilin rast, zgjedhjet demokratike kanë forcuar rëndësinë e fesë së shumicës në kuptimin e shtetit dhe kombit, duke rritur fuqinë e asaj feje. Ne mund të shohim një shovinizëm në rritje, në përzjerjen e katolicizmit dhe politikës në Europën Lindore, që i portretizon si armiq liberalët dhe komunistët. Edhe pse nacionalizmi fetar po fiton forcë, pretendimet për përkatësi në "Perëndim", shtrihen pjesërisht tek një përdorim politik i tolerancës fetare.

Toleranca ka qenë historikisht një korizë për njerëzit, që janë thellësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri, për të jetuar në paqe së bashku. Çka është pikërisht arsyeja, pse është koha që toleranca të pushojë njëherë e mirë, së qeni një model për marrëdhëniet midis grupeve. Skepticizmi mbi tolerancën ka një histori të gjatë, që nga shkrimtari gjerman Johan Wolfgang Gëte, i cili tha se "të tolerosh, do të thotë të fyesh". Ajo u përball me një kritikë të qëndrueshme pas Luftës së Dytë Botërore, nga filozofë dhe teoricienë politikë si Karl Popper, Herbert Markyze dhe shumë të tjerë, që e panë tolerancën liberale si fajtoreshë për miratimin pasiv të rritjes së fashizmit në gjysmën e parë të shekullit XX-të.

Aty ku Popper pa një shoqëri liberale, që kërkonte shtypjen e disa pikëpamjeve jo tolerante për vetë-ruajtje, Markyze e pa tolerancën e liberalizmit ndaj padrejtësisë, si vetë problemin. Pas Markyze, në vitet 1960, e Majta e Re shtroi pyetjen nëse ideja e tolerancës – veçanërisht e fjalës dhe diversitetit politik – shërbente vetëm për të mbrojtur qeveritë, korporatat dhe elitën, në politikën e vazhdueshme të shtypjes ekonomike dhe racore.

Kohët e fundit, një rrymë mendimi në marrëdhëniet ndërkombëtare, po thekson se si politika e jashtme që drejton qeveritë perëndimore, po ndan tani botën midis tolerancës dhe jo tolerances, në të njëjtën mënyrë siç ka dalluar dikur qytetërimi (të bardhët) nga barbarët (të gjithë të tjerët).

Toleranca është thellësisht e rrënjësor në morinë e idealeve të dukshme moderne: si një e mirë e natyrisht, një etikë e nevojshme individuale, një shtyllë e civilizimit perëndimor dhe dëshmi e superioritetit të saj. Megjithatë, toleranca, si një ide dhe një etikë, anashkalon ndërveprimin midis individëve dhe grupeve, në përditshmëri dhe gjatë një periudhe afatgjatë; shkëmbimin e ndërsjellë kulturor dhe

ideor ndërmjet grupeve në një shoqëri. Grupet nuk bashkëveprojnë në izolim, ato ndajnë reciprocisht, nganjëherë qëllimisht, dhe ndonjëherë pa dashje.

Nëse është e vërtetë që ekziston një shoqëri globale, ajo që mishëron sot pjesën më të mirë nuk është toleranca, por reciprociteti, marrëdhënia jetike dhe dinamike e shkëmbimit të ndërsjellë. që ndodh çdo ditë ndërmjet individëve dhe grupeve brenda një shoqërie.

Islami, Budizmi, Konfucianizmi, Sikhizmi dhe shumë qytetërime të tjera kanë ruajtur historikisht traditat e tyre të tolerancës fetare. Nga ana tjetër, Reformacioni në Europë, e zgjeroi intolerancën. Reformacioni i bëri gjyqet kundër herezisë, një simbol të përkushtimit fetar. Para se të arriheshin kompromiset që të krishterët e ndryshëm të jetonin me njëri-tjetrin, luftërat e dhunshme fetare e rrënuan Europën për 100 vjet e ca vjet.

Një refuzim i krishterë për të toleruar devijime të rëndësishme nga ortodoksia doktrinale – hebre apo mysliman, "paganë" dhe "egërsirat" me të cilët evropianët po ndesheshin më së pari në Epokën e Zbulimit të tyre – ishte shenjë e shenjtërisë dhe pastërtisë, gatishmërinë për të vënë çështjet shpirtërore, mbi shqetësimet tokësore.

U deshën shumë vite, me ulje-ngritje dramatike, që ideja e tolerancës të shndërrohej në një vlerë pozitive të vlerësuar në shoqërinë evropiane. Për teoricienët e parë të tolerancës angleze si Xhon Lok, toleranca ishte e nevojshme para së gjithash për të mbrojtur krishterimin dhe shpirtin e të krishterëve. Vetëm në shekullin XVII-të, ideja e tolerancës filloi të hedhë rrënjë në Evropë si një parim në përputhje me qeverisjen e mirë dhe efektive. Iluminizmi, rritja e shteteve kombëtare, dy luftërat botërore dhe dekolonizimi evropian i pasluftës, e transformuan tolerancën nga një koncept ligjor që rregullonte privilegjet dhe aftësitë e kufizuara të feve që janë pakicë, në një ideal filozofik dhe etik.

Me ngritjen e korpusit ligjor ndërkombëtar të të drejtave të njeriut pas Luftës së Dytë Botërore, shtetet ndaluan artikullimin e mbrojtjes së pakicave në dekrete të tolerances, apo garanci të të drejtave të pakicave. Në fakt, tolerance, nuk i ka shpëtuar kurrë origjinës së saj si një mjet i shumicës për të zgjidhur problemet e pakicës. Si e tillë, toleranca mbetet një marrëdhënie e vetme ndërmjet tolerimit dhe tolerances, që me qëllim ose jo, e mban të toleruarit jashtë anëtarësimi të plotë në grupin dominues. Në dallim nga toleranca, reciprociteti njeh që shoqëritë e forta dhe dinamike, janë të bazuara në shkëmbimin social dhe kulturor.

SHËNIM: Simon Rabinovitch, është profesor historie në Universitetin e Bostonit në SHBA.

Ai është autor i librit "Rite hebraike, rite Kombëtare: Nacionalizmi dhe autonomia në Rusinë e vjetër perandorake dhe revolucionare" (2014). ("Aeon.co")

Eklipsi i ri hënor pritet të zgjasë 1 orë e 43 minuta dhe gjithsej 4 orë, duke u bërë kështu eklipsi më i gjatë për këtë shekull. Eklipsi i plotë hënor ndodh kur hëna dhe dielli ndodhen në anët e kundërta të Tokës, sipas NASA-s.



“HËNA E GJAKUT” MË 27 KORRIK, DO JETË EKLIPSI MË I GJATË HËNOR I SHEKULLIT

“Hëna e gjakut” e kësaj jave do të jetë eklipsi më i gjatë hënor i shekullit. Eklipsi do të zgjasë një orë e 43 minuta, ndërsa faza e plotë e eklipsimit do të zgjasë pothuajse katër orë, sipas Space.com. Ajo do të nisë natën e 27 korrikut deri në mëngjesit e hershëm të 28 korrikut.

Eklipsi hënor do të shihet në pjesën më të madhe të Europës, Azisë, Australisë, Afrikës dhe një pjesë të Amerikës Jugore.

Amerika Veriore dhe ajo Qendrore nuk do të mund ta shohin këtë eklips, megjithatë astronomët janë përgatitur për ta

shijuar këtë moment dhe pritet që ta transmetojnë LIVE në internet.

Kjo ngjarje e rrallë qiellore është rezultat i disa ngjarjeve astronomike, që do ta zgjasin fenomenin. Gjatë eklipsit, Hëna do të kalojë përmes hijes më të errët të Tokës, e njohur si Umbra, duke shkaktuar një shkëlqim të kuq, e cila i jep emrin “Hëna e përgjakur”.

Nuk ka nevojë për të pasur një pajisje specifike për të parë eklipsin më mbresëlënës të shekullit. Na duhet vetëm të shpresojmë që qielli të jetë i kthjellët.

Eklipsi total fillon në orën 19.30 dhe do të përfundojë në 21.13. Kul-

mi i eklipsit do të jetë në orën 20:22.

Ky do të jetë eklipsi i dytë hënor për 2018-ën. I pari ndodhi më 31 Janar dhe zgjati në total 3 orë dhe 23 minuta. Megjithatë koha që eklipsi ishte i plotë, ishte 1 orë e 16 minuta. Por eklipsi i ri hënor pritet të zgjasë 1 orë e 43 minuta dhe gjithsej 4 orë, duke u bërë kështu eklipsi më i gjatë për këtë shekull.

Eklipsi i plotë hënor ndodh kur hëna dhe dielli ndodhen në anët e kundërta të Tokës, sipas NASA-s. Në këtë kohë, toka zë shumicën e dritës së diellit, duke bërë që pjesa më e madhe e hënës të jetë nën

hijes e saj.

“Dhe rrezet e diellit që arrijnë të kalojnë nëpër atmosferën e Tokës dhe të arrijnë në hënë e bëjnë hënë të duket e kuqe—sepse pjesa më e madhe e dritës blu është filtruar nga atmosfera e Tokës. Ky eklipsi i veçantë do të jetë më i gjatë, sepse po ndodh në të njëjtën kohë kur hëna godet apogjen e saj, e cila është pika më e largët nga Toka në orbitën e hënës, sipas EarthSky. Meqenëse hëna do të jetë në pikën më të largët, do ti duhet më shumë kohë për të kaluar hijen e Tokës”, tha NASA.

Kujtohet 50-vjetori i vizitës së parë në Hënë

Në Qendrën e Hapësirës Kennedy, në Florida u mbajt një ceremoni që shënoi fillimin e festimeve me rastin e 50 vjetorit të zbritjes së njeriut të parë në Hënë. Në ceremoni folën një numër astronautësh dhe më pas ajo vijoi me dhënien e medaljeve për punonjës të NASA-s dhe njerëzit më të shquar të fushës së hapësirës. Pjesë e festimeve këtë 50-vjetor të vizitës së parë në Hënë, është edhe një ankand për artikuj të hapësirës, që i përkasin astronautëve amerikanë në këta 50 vjet histori të industrisë së hapësirës. Në mesin e qindra pjesëmarrësve në ceremoni ndodheshin emra të njohur të hapësirës dhe të shkencave që e studjojnë atë, si fizikani i njohur britanik Brian Cox. Ish drejtori i qendrës së hapësirës Kennedy Gerry Griffin, i cili pati drejtuar të gjitha ekipet e misioneve Apollo, U nderua me medaljen e pinonierit në fushën e hapësirës. Ai tha se hapi i ardhshëm për NASA-n ka për të qenë kthimi i amerikanëve në Hënë dhe vizita në planetin Mars. (VOA)



Izraelitët bëhen gati të zbresin në hënë

Kompania shtetërore “Industrië Aerohapësirë Izraelite” dhe jofitimprurësja SpaceIL kanë shpallur planet e tyre për të nisur një mision hënor gjatë muajit Dhjetor, i cili do ta bënte Izraelin shtetin e katërt që ka zbritur në hënë.

Anija izraelite pa ekuipazh me një vlerë prej 88 milionë dollarësh do të nisët nga Florida duke përdorur raketat e Falcon 9 të prodhuara nga SpaceX e Elon Musk. Me një peshë prej vetëm 600 kilogram, ajo do të jetë anija kozmike më e vogël që bën një zbatim në hënë. Udhëtimi do të zgjasë dy muaj.

“Jam i mbushur me krenari që anija e parë izraelite, e cila është në



fazën finale të ndërtimit dhe testimit, do të arrijë deri në Hënë”, u shpreh presidenti dhe themeluesi i SpaceIL, Morris Kahn.

Asnjë qeveri nuk ka zbritur në

hënë që prej viteve '70, por interesi është ringjallur kohët e fundit. Presidenti i SHBA Donald Trump ka kërkuar 900 milionë dollarë financime për misionet hënore të

NASA. Ndërsa Kina këtë vit planifikon të zbarkojë një sondë në pjesën e errët të paeksploruar të hënës, ku nuk arrijnë sinjalet radio nga Toka. Nëse misioni i Izrael-

lit rezulton me sukses, ai do t'i japë shpresë shkencëtarëve për misione me kosto relativisht të ulëta. Megjithatë ka ende sfida për t'u tejkaluar, si kapaciteti më i vogël i karburantit i anijes. Anijeve të tjera kozmike u janë dashur katër ditë për të arritur në hënë, sepse mund të mbanin më tepër karburant.

Anija e SpaceIL është 1.5 metra e lartë dhe dy metra në diametër me një shpejtësi maksimale prej 10 kilometrash në sekondë. Karburanti do të përbëjë 75% të peshës së saj.

Pasi të zbarkojë, anija do të bëjë foto dhe video të pikës së zbritjes, duke regjistruar edhe fushën magnetike të hënës.

Në procesin e printimit të kartëmonedhave e monedhave shqiptare do të angazhoheshin disa prej kompanive më të njohura në botë për këtë shërbim. Për kartëmonedhat me prerje 5, 20 e 100 franga do të përzgjidhej kompania "Bradbury Wilkinson & Co. Ltd." në Londër



KU U PRINTUAN PARATË E PARA TË SHQIPËRISË?

Deri në vitin 1926, Shqipëria nuk kishte monedhë kombëtare e si rrjedhojë përdorte ligjërisht monedha të huaja, që krijojnë jo pak probleme në shkëmbimet ekonomike të vendit apo të llogaritë publike, për shkak edhe të mungesës së kursit të këmbimit.

Krijimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë parashikonte edhe printimin dhe futjen në treg të monedhës shqiptare, frangut ar me nënfishat e tij lekë e qindarka. 1 frang ar ishte i barabartë me 5 lekë. Në procesin e printimit të kartëmonedhave e monedhave shqiptare do të angazhoheshin disa prej kompanive më të njohura në botë për këtë shërbim.

Për kartëmonedhat me prerje 5, 20 e 100 franga do të përzgjidhej kompania "Bradbury Wilkinson & Co. Ltd." në Londër ndërsa për kartëmonedhën 1 frangë (5 lekë)



do të përzgjidhej "Richter & Co" në Napoli.

"Bradbury Wilkinson & Co" ishte një kompani që merrej me projektimin dhe printimin e kartëmonedhave, pullave postare dhe certifikatave të aksioneve. Kompania Bradbury u themelua në vitin 1850 nga Henry Bradbury dhe filloi printimin e kartëmonedhave në vitin 1856, transmeton Portali ekonomik SCAN.

Ajo ishte një nga kompanitë

më të njohura në botë në fushën e prodhimit të letrave me vlerë. Në vitin 1903 kompania u ble nga "American Bank Note Company" dhe vijoi të operojë në Londër.

Ndërsa "Richter & Co" u themelua në vitin 1842 nga një tipograf zviceran për prodhimin e posteraeve e imazheve me ngjyra. Më pas, Richter u bë furnitor i shtëpisë mbretërore italiane dhe kompania u specializua në sektorë të ndryshëm, mes të cilëve edhe të



printimi i kartëmonedhave.

Studiuesi Haxhi Shkoza shkruan se kartëmonedhat 1 frangëshe (5 lekë) të printuara nga "Richter & Co" u hoqën nga qarkullimi shpejt pasi qeveria shqiptare nuk i pranoi ato. Shkak u bë fakti se kartëmonedhat 1 frang (5 lekë) kishin si element identifikues shqiponjën romake me 1 kokë dhe jo atë shqiptare dykrenare.

Sa i përket kartëmonedhave të tjera, nga kompania me qendër në Londër, fillimisht do të printohej një sasi prej 5 mijë frangash ari, të ndara në prerje 20 frangëshe të cilat do të futeshin në qarkullim në tregun shqiptar në vitin 1926.


Prerja 20 franga do të ishte prerja më e përdorur në Shqipëri deri në vitet '30 e duke zënë 62% të nivelit të qarkullimit të parave. Më pas raporti do të ndryshonte, ku prerja 100 franga do të zinte më shumë "vend" në qarkullimin e parash në vend.

Sa i përket monedhave metalike shqiptare, ato do të bazoheshin në modelet e profesorit Giuseppe Romagnoli i cili do të



drejtonte shkollën e medaljes dhe ofiçinën shtetërore italiane të letrave në vlerë për 45 vite.

E monedhat shqiptare do të gdhendeshin nga "Motti.inc" në ofiçinën e monedhave në Romë.



Në bazë të nenit 157 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gaz. zyrtare e RM numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) dhe pëlqimit për mjete të siguruar financiare për punësim nga Ministria e financave nr. 18-7489 të datës 29.06.2018, IPSH Klinika universitare për psikiatri – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin e 1 (një) psikologu dhe 2 (dy) motra medicinale për kohë të pacaktuar

- IPSH Klinika universitare për psikiatri – Shkup ka nevojë për të punësuar:
 - 1 (një) psikologu për kohë të pacaktuar dhe
 - 2 (dy) motra medicinale për kohë të pacaktuar
- Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore,
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - të mos jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet të plotësojnë edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

Për kandidatët nën pikën 1.1

 - Arsim të mbaruar sipëror me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VIII/1 të mbaruar
 - Licencë për kryerje të veprimtarisë psikiatrike
 - Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë
 - Certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian, apo certifikatë nga institucion ndërkombëtar për njohjen e një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, gjermane ose frënge) të A1 nivelit të CEFR, gjegjësisht BULATS, ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat.
 - Me dhe pa përvojë pune

Për kandidatët nën pikën 1.2

 - Arsim të mesëm të mbaruar medicinal
 - Provim të dhënë profesional
 - Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë dhe
 - Me ose pa përvojë pune
- Orari i punës 40 orë në javë dhe neto pagesa bazë:
 - për kandidatët nën pikën 1.1 është 25.500,00 denarë
 - për kandidatët nën pikën 1.2 është 18.500,00 denarë
- Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:

Për kandidatët nën pikën 1.1

 - Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;
 - Biografi të shkurtë (CV);
 - Certifikatë për kryerjen e arsimit të lartë (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë
 - Njohja e gjuhës së huaj dëshkohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Goethe-Zertifikat, TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim të gjuhëve mësim dhe vlerësim (CEFR).
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - licencë të përgjithshme për kryerjen e veprimtarisë psikiatrike të dhënë nga Oda e psikiatërve të RM, original ose kopje të vërtetuar në noter;

Për kandidatët nën pikën 1.2

 - Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;
 - Biografi të shkurtë (CV);
 - Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) - motër medicinale edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Dëshmi për provim të dhënë profesional (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë
 - Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se gjashtë muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Afati për paraqitje në shpalljen publike është **5 (pesë)** ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishtëm dhe telefonin për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Klinika universitare për psikiatri – Shkup rr. "Beligradska" pn, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për psikiatri – Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për psikiatri – Shkup



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrëshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 118/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Shuto Orizare “për vendet e punës në vijim:

- UPR0101V01000 Këshilltar për planifikim hapësor dhe urbanistik, Njësia për I realizues(ë) urbanizim dhe mbrojtje të ambientit jetësor
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- nivele i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Arkitekturë, urbanizim dhe planifikim
 - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Rroga neto: 27.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Rom(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË KOMUNA E KISELLA VODËS

rr. “Petar Deljan” nr. 17, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, tel. ++389 2 2785-400; faks: ++389 2 2785 471 www.kiselavoda.gov.mk / contact@kiselavoda.gov.mk

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune - tekst i pastruar (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 167/2015), nenit 57 paragrafi 1 alineja 20 të Statutit të Komunës së Kisella Vodës (Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 8/05 dhe Lajmëtari zyrtar të Komunës së Kisella Vodës numër 13/2006) dhe Vendimit numër 04-6482/1 nga 20.07.2018, Komuna e Kisella Vodës publikon

SHPALLJE

Për pranimin e 1 (një) punëtorit për kohë të pacaktuar

- Për vendin e punës - punëtor KU për mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave të gjelbërta në departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për furnizime publike dhe punë të përgjithshme të Komunës së Kisella Vodës.
- Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e përcaktuara në vijim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në administratën komunale të Komunës së Kisella Vodës:
- Kushtet e posaçme**
- Lloji i arsimit: arsim i mesëm – gjimnaz apo teknik kimie (180/240 ECVET/MKSOO);
 - Pa ose me përvojë pune;
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;
 - Të jetë i moshës së rritur;
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Orari i punës është me kohëzgjatje prej 40 orësh në javë nga e hëna deri të premten gjegjësisht 8 orë pune në ditë me fillim prej 8.30 deri 16.30. Neto pagesa bazë e punëtorit do të jetë 13.300 denarë.

Kandidatët e paraqitur dokumentet e nevojshme (biografi e shkurtër, fotokopje e diplomës për arsimin e përfunduar, fotokopje të nënshtetësisë, kontakt telefoni dhe dokumentet e tjera) ti dorëzojnë në arkivin e Komunës Kisella Voda me seli në rr. “Petar Deljan” nr. 17, Shkup.

Me kandidatët që kanë dokumentacion të rregullt dhe përmbushin kushtet e lartpërmendura do të realizohet intervistë për çka do të njoftohen.

Vërtetimi mjekësor dhe dëshmia se nuk është shqiptuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor për kryerjen e veprimtarisë, do të dorëzojë kandidati i cili do të lajmërohet se është zgjedhur.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Punëdhënësi do të kryejë zgjedhjen në një afat prej 45 ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitje. Dokumentet jo të kompletuara dhe që nuk dorëzohen me kohë nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komunës Kisella Voda
Filip Temellkovski

Në bazë të nenit 110-e nga Ligji për mbrojtje sociale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 189/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16, 163/17 dhe 51/18) dhe nenit 20-g dhe 21, pika 1 dhe 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 109/14, 199/14 dhe 27/16 dhe 35/18) Drejtori i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 5 (pesë) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish publikon shpallje për punësim të 5 (pesë) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës për pozitën në vijim

- CO3030A06001 Punëtor i diplomuar social Referent i pavarur profesional nga shkalla e gjashtë 2 (dy) realizues;
 - CO3030A06004 Pedagog Referent i pavarur profesional nga shkalla e gjashtë 1 (një) realizues
 - CO3030A06003 Psikolog Referent i pavarur profesional nga shkalla e gjashtë 1 (një) realizues
 - CO3030A06002 Jurist i diplomuar Referent i pavarur profesional nga shkalla e gjashtë 1 (një) realizues
- Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish (për të gjithë kandidatët):
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
 - Të jetë i moshës së rritur;
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish
- Për vendin e punës me numër rendor 1 (një), për vendin e punës me numër rendor 2 (dy), për vendin e punës me numër rendor 3 (tre) dhe për vendin e punës me numër rendor 4 (katër)

1. Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje sociale për dhënësit e shërbimeve në sferën e mbrojtjes sociale nga kategoria A – profesionale janë:

- Kualifikimet profesionale dhe përvoja e punës edhe atë:
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,

Kompetencat e përgjithshme të punës nivelit mesëm

- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/punë ekip,
- Orientim kah palët/palët e prekura dhe
- Udheheqje financiare

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitën e punës, duhet të parashtojnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Biografi të shkurtë;
- Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.181,00 denarë.

Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Punësimi është në kohëzgjatje të pacaktuar.

Afati për parashtimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike do të informohen për kohën dhe vendin e kontrollit të dokumenteve dhe realizimin e intervistës.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Radovish, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. 22 Oktomvri nr. pn, Radovish

Departamenti për resurse njerëzore

(me shenjë “për shpallje”)

Personi për kontakt Dragi Dimitriev

Kontakt telefoni 032 635-601 ose 077 980-338

Fletëparaqitjet dhe dokumentacioni i parashtuar pas afatit, jo të plotë dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale

për punë sociale Radovish

Drejtor

Nina Ivanova

USHTARËT AMERIKANË DO TË PËRDORIN VESHJE ELEKTRIKE



Ushtarët nuk mund të arrijnë performancën maksimale kur ata janë të ftohur dhe do të përballen me temperature shumë të ultë, sidomos në kohën e dimrit ku disa prej tyre mund të posedojnë deri në shtatë shtesa veshjesh, ato veshje mund t'i ngarkojë, përcjell "Zeri.info".

Më vonë, ushtarët mund të gjejnë veten të mbingarkuar, duke

u djersitur ndërsa kjo djersë nga ana tjetër mund të kthehet në akull, nëse moti është shumë i ftohtë.

Studiuesit sapo kanë dalë me një mënyrë për të lehtësuar ngarkesën e një luftëtari në kohë dimërore dhe për të luftuar kërcënimin e djersës së ngrirë, duke bërë disa veshje tipike për ushtarët e Amerikës.

Kimistja Elizabeth Hirst së bashku me bioinxhinjeren Paola D'Angelo po punojnë rreth këtyre veshjeve për t'i pajisur ushtarët amerikanë.

Këto veshje kanë përberje elektrike që mund të ofrojnë ngrohje në rast të motit me temperatura shumë të ulta, metali i argjendit mund t'a reflektojë nxehtesinë e trupit, ku bateritë

janë ato që japin nxehtësi shtesë.

Këto veshje të veçanta përfshijnë poliestër, najloni dhe fibra të tjera sintetike. Fibrat e tyre janë inxhinierizuar nga njerëz, që vijjnë nga materiale natyrore, të tilla si fibrat bimore ose flokët e kafshëve, me këto veshje ende nuk janë pajisur ushtarët amerikanë, mirëpo me punën e pa lodhshme besohet se së shpejti do të jenë gati.

Vjen epoka bioartificiale

Organe njerëzore të rritura me kompjuter, transplante të lëkurës dhe cepa të syrit të projektuar, proteza robotike që komandohen me anë të mendimit, tashmë ka filluar epoka bioartificiale, ku trupi i njeriut shkrihet gjithnjë e më shumë me teknologjinë për t'i hapur rrugën mjekësisë rigjeneruese të personalizuar. "Në këto çaste mjekësia dhe teknologjitë e aplikuar për shëndetin po jetojnë një tranzicion nga artificialja drejt biologjikës", shpjegon Manuela Raimondi, profesore e bioinxhinierisë në Politeknikun e Milanos, transmeton ATSH.

"Kufiri mes këtyre dy botëve është gjithnjë e më i paqëndrueshëm. Këtë e tregon zhvillimi i terapive të reja inovuese, sikurse është implantimi i lëkurës që krijohet në baza artificiale të biodegradueshme dhe jo të dëmshme për organizmin, që tashmë janë një realitet për viktimat e djegieve", thotë ekspertja.

Sipas Roberto Cingolani, drejtori i Institutit Italian të Teknologjisë, "kontribut të rëndësishëm në ndryshimin e botës së mjekësisë do të japin edhe Big Data, që do të ndihmojnë në zhvillimin e teknikave të reja për parandalimin e sëmundjeve dhe më pas të implantimit të organeve artificiale, për robotikën dhe kirurgjinë në distancë, reabilitimin dhe protezat dhe në fund sensorët për diagnostikim që do të mund të vishen madje edhe të gëlltiten". "Në të ardhmen teknologjia do të jetë brenda nesh", shton Maria Chiara Carrozza, presidente e Grupit Kombëtar të Bioinxhinierisë.

Robotika premtion vende të reja të punës

Kombinimi i inteligjencës artificiale dhe robotikës mendohet se do të zhvillojë deri në 7 milionë vende pune mes 2018 dhe 2037. Megjithatë, kjo do të çojë në uljen e kostove dhe rritjes së shpenzimeve, të cilat mund të gjenerojnë 7.2 milionë vende punë një fitim neto prej 200,000 vendeve të punës, sipas firmës së kontabilitetit PwC,

Punë në shërbime shëndetësore, shkencore, teknike parashikohet të rriten, ndërsa ato në prodhim, transport dhe magazinim, dhe administrata publike do të ulen.

Zhvillimi i inteligjencës artificiale duket të jetë më pak shqetësues se sa kishim frikë, transmeton "Zeri.info"



Në vitin 2013, një studim i Universitetit të Oksfordit sugjeroi se rreth gjysma e vendeve të punës në SHBA dhe një e treta në Britani të Madhe ishin në "rrezik të lartë" të zhvillimit në vitet

në vijim. Por kjo që atëherë është rishikuar. Në prill, organizata ekonomike OECD tha se shifrat kanë më shumë gjasa të jenë 10 përqind në SHBA dhe 12 përqind në Britani të Madhe.



Risi nga Google Maps, do të raportohen aksidentet

Google Maps sjell veçori të reja. Së fundmi do të raportojë aksidentet, në sajë të navigacionit.

Prej fillimit të aplikacionit, një numër i madh njerëzish filluan të raportonin në mënyrë aktive incidente (529 persona deri më sot).

Kjo tregon se njerëzit mund të jenë të gatshëm të raportojnë problemet e trafikut në çdo aplikacion.

Një hundë artificiale që nuhat atmosferën në punë

Më shumë siguri në vendin e punës falë hundës elektronike që monitoron cilësinë e ajrit në ambientet e punës. Kjo pajisje që mund të mbahet me vete, e krijuar nga Politekniku i Milanos, dërgon sinjale alarmi kur ndotja kalon nivelin e lejuar, duke i mundësuar përdoruesit të veshë sistemet e duhura të mbrojtjes ose të largohet në rast rreziku për shëndetin.

Falë teknologjisë "Bluetooth" të integruar, pajisja transmeton në një aplikacion që ndodhet në smartfonë të dhënat e mbledhura, duke treguar me një grafikë se si përqëndrimi i ndotësve varion gjatë ditës. Kjo hundë elektronike

bazohet në një sensor që detekton përbërësit organikë dhe oksidet e karbonit, në veçanti dioksidin e karbonit. Të dhënat e kapura transformohen në kohë reale në një sinjal që aktivizojnë një sensor LED dhe jeq dridhje, sipas një shkalle me tre nivele. Kur ndizet drita LED jeshile do të thotë që pajisja është funksionale, drita LED e verdhë dhe një dridhje e lehtë tregojnë se niveli i ndotjes është rritur dhe sinjalizon përdoruesin të vendosë maska mbrojtëse.

Ndërsa drita LED e kuqe e shoqëruar me një dridhje të fortë informon përdoruesin se ndotja në ajër ka arritur nivele të rrezikshme.



NDEROHET MINISTRI I PARË I LUFTËS, MEHMET PASHË DËRRALLA

Në Muzeun Historik Kombëtar është bërë edhe prezantimi i një studimi voluminoz ku përfshihen kumtesa, fjalime dhe dokumente arkivore për jetën e Mehmet Pashë Derallës

Tiranë, 24 korrik - "Rrugëtimi i kujtesës historike" nis mbarë duke vendosur në vend një nga figurat më të rëndësishme të kombit tonë. Behet fjalë për një ekspozitë që u çel dje në Muzeun Historik Kombëtar me rastin e 175 vjetorit të lindjes së heroit të heshtur kombëtar, Mehmet Pashë Deralla. Edhe pse ai ka qenë ministri i parë i Luftës si dhe krijuesi i Ushtrisë së parë Shqiptare, duket sikur historia dhe sistemet nuk i kanë dhënë vendin e merituar.

Ashtu siç shprehet dhe Dorian Koçi, drejtori i Muzeut, "në këtë qasje shqiptare ka vend për korrigjim, pasi një histori e përgjithshme e kombit shqiptar nuk mund të shtrihet vetëm brenda kufijve administrativë të Shqipërisë". E thekson gjithashtu edhe Arsim Sinani, kuratori ekspozitës në prologun e tij dedikuar familjes



Deralla se fillimi i rivlerësimit të historisë shqiptare, pa shqiptarët e të gjitha vendeve është vlerësim i pjesshëm, një padrejtësi sistematike historike. "Është e paprueshme, nuk e njohim historinë që shkruhet pa ne". Sinani rrëfen se kjo ekspozitë mbart pas një punë 7vjeçare dhe sjell me vete një copëz pavarësie.

Dokumente të paeksponuara më parë, nga arkivi turk, dokumente austriake, sllavo-maqedonase dhe shumë të tjera interesante që ia dorëzoi ditën e djeshme Muzeut Historik Kombëtar. "Nëpërmjet kësaj ekspozite ne sjellim vuajtjen e popullit shqiptar në Maqedoni dhe sakrificën e

familjes Deralla që humbi gjithçka që Shqipëria të jetë shtet", u shpreh Sinani entuziast për faktin se pas një pune të gjatë kërkimore mundën të kthejnë këtë figurë historike në piedestalin ku e ka vendin. Të ftuar gjatë ceremonisë së djeshme ishin figura nga Maqedonia, Kosova, Shqipëria si dhe familjarë të Mehmet Derallës si mbesa e tij Valdetja, nipë Berati, dhe stërnipi Genci.

Ishte një nga ushtarakët më të dalluar në shërbimet osmane, por në kushtet kur trojeve shqiptare u duhej një ministër mbrojtjeje ai ishte personi i duhur. Mehmet Pashë Deralla krijoi ushtrinë shqiptare si ministër i parë i luftës në Qe-



verinë e Përkohshme të Vlorës dhe doli kundër politikës osmane. Megjithatë, në Shqipëri njihet pak. Kjo është ekspozita e parë që çelët për të në Tiranë.

Në Muzeun Historik Kombëtar është bërë edhe prezantimi i një studimi voluminoz ku përfshihen kumtesa, fjalime dhe dokumente arkivore për jetën e Mehmet Pashë Derallës.

Bashkë me dokumentet që pritet të transkripton nga osmanishtja, studiuesit nga Maqedonia kanë nisur kërkimet edhe në arkivat shqiptare që do të mund të ndihmojnë në botimin e një studimi të dytë për Mehmet Pashë Derallën. (Shekulli, VizionPlus)

KUSH ISHTE MEHMET DERALLA?

U lind më 1843, në Gradec të Tetovës, në familjen e dëgjuar të Hasan Pashë Dërrallës, ku patriotizmi ishte i gatuar që në rrinjë. Mehmeti kreu arsimin fillor në Tetovë (vendlindje), kurse shkollën e mesme e kreu në Shkup. Pas shkollimit në vendlindje, ndoqi studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Stambollit, të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera, çfarë ndikoi që për disa vite të shërbente në Anadoll, i emëruar në një regjiment këmbësorie. Këtu u vlerësua "i zellshëm, me perspektivë". Më pas iu dha e drejta për të ndjekur shkollën e lartë, Akademinë e Shtatmadhorisë në Stamboll, që ishte niveli më i lartë i arsimit ushtarak në Turqi. Përfundimi i akademisë së Shtatmadhorisë i hapi dyert për karrierë të mëtejshme dhe fitimin gradualisht edhe të gradave madhore. Fillimisht do të niste nga detyrat madhore duke iu besuar detyra e komandantit të xhandarmërisë në Bagdad, Irak, dhe më vonë në Halep, Siri. Pas përmbushjes me sukses të këtyre detyrave të larta, ushtaraku i përkushtuar do të transferohet në Selanik, i cili në atë periudhë përfaqësonte një nga portet më të rëndësishme të Perandorisë Osmane në Ballkan. Si më herët, edhe këtu, ai u shqua në kryerjen e detyrave me përgjegjësi të lartë e u vlerësua nga perandoria osmane "ushtarak karriere i suksesshëm". Fillimisht shërbeu në Shkup për të vijuar më pas në funksionin e komandantit të qarkut të Prizrenit, ku bënin pjesë edhe Tetova, Gjakova e Luma. Suksesi në karrierë falë aftësive dhe shkallës së lartë të përkushtimit në të gjitha detyrat e ngarkuara, do ta bënin Mehmetin që në moshën 35vjeçare të përligjte kualitetet e titullit të "Pashait".

Revitalizohet pika kufitare në Morinë



Të martën në Morinë u hap pikë kalimi kufitar i revitalizuar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Përfaqësuesja e BE-së në Shqipëri Romana Vlahutin me këtë rast tha se kjo infrastrukturë moderne do të ndihmojë në kalimin më të lehtë të kufirit.

Edhe shefja e BE-së në Kosovë Natalya Apostolova tha se ngjarja e sotme ka rëndësi të madhe pasi kjo pikë kufitare shtrihet në një zonë të rëndësishme rajonale.

"Jam shumë e lumtur që jemi mbledhur këtu sot në kufirin mi-

dis Kosovës dhe Shqipërisë për të shënuar renovimin e pikës kufitare që Bashkimi Evropian ka mbështetur. Në një periudhë të shkurtër kohore prej vetëm disa muaj, kjo është ngjarja e tretë që po marr pjesë për promovimin e aktivitetëve të BE-së, të cilat i ndihmojnë autoritetet e Kosovës që të kontrollojnë dhe menaxhojnë kufijtë më mire", tha Apostolova.

Në përfundim të kësaj pike të financuar nga BE-ja morën pjesë edhe zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj dhe zëvendë-

skryeministria e Shqipërisë Senida Mesi. Zëvendëskryeministria e Shqipërisë tha se ky projekt nuk u mundësua vetëm nga kontributi i vlerës financiare nga BE, por edhe nga dëshira e menaxhimi i delegacioneve të të dyja vendeve.

Edhe zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj tha se kjo është një ditë e veçantë për Kosovën e Shqipërinë. Ai gjithashtu falënderoi policinë kufitare e doganierët e të dyja vendeve për punën profesionale që e kanë bërë.

Projekti prej 1 milion e 450 mijë euro ofron infrastrukturë për kontrollë efikase të kufirit, në përputhje me kërkesat e BE-së duke pasur parasysh standardet e Schengenit. Revitalizimi i pikës kalimit përfshin kabina të reja kontrolluese, sistem elektronik dhe ndërtesën administrative, të cilat do të mundësojnë zbatimin e menaxhimit të integruar të kufirit. Pikë kalimi kufitar në Morinë, e mbulon pjesën më të madhe të qarkullimit të mallrave përmes Kosovës, si dhe pothuajse të gjithë trafikun turistik që hyn në Shqipëri nga verilindja.

A do të ketë shkëmbim të territoreve me Serbinë, flet presidenti Thaçi

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është deklaruar edhe njëherë për çështjen e dialogut me Serbinë, me ç'rast iu ka bërë thirrje partive politike që të angazhohen në fazën finale të këtij procesi, raporton "Zeri.info".

"Edhe sot kërkoj nga partitë parlamentare, nga kuvendi, që t'i marrë përgjegjësitë e veta. Më vjen keq që partitë janë duke u vonuar, pasi që koha po ecë. Roli përfundimtar pas arritjes së secilës marrëveshjeje i takon kuvendit. Secili duhet ta luajë rolin e vet", ka shtuar ai.

Ndërkohë, i pyetur rreth mundësisë së shkëmbimit të territoreve me Serbinë, respektivisht mundësisë së këmbimit të terriut me Luginën e Preshevës (ide të cilën e ka përmendur shpeshherë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri), Thaçi duke mos saktësuar, ka thënë se do të respektohet mendimi i shqiptarëve të Luginës.

"Për një ide të tillë ka kohë që



po flasin njerëz të akademisë, të shoqërisë civile, të politikës. Unë i dëgjoj me vëmendje deklaratimet e secilit lider politik. Do ta shikoj me vëmendje, e kuptoj shqetësimin e secilit lider për shqiptarët në Preshevë-Medvegjë dhe Bujanovc. Natyrisht rrëfimet e tyre janë prekëse, rrëqethëse. E drejta për të ardhmen e tyre iu takon atyre dhe opinionit të tyre është i respektuar. E di që Haziri ka kontakt me ta...", ka nënvizuar kreu i shtetit.

Është kohë e vështirë për Atikën, një natë e vështirë për Greqinë, por më shumë se 600 zjarrfikës dhe 300 automjete po punojnë në tre frontet, deklaroi kryeministri grek, Alexis Cipras, pas takimit informues në Qendrën e Koordinimit të Brigadave Zjarrfikëse në Halandri.

Kryeministri i bëri thirrje të gjithë qytetarëve "të bashkojnë forcat për të bërë më të mirën".

Cipras vuri në dukje se "të gjithë duhet të jemi vazhdimisht vigjilentë, të bashkuar dhe të bëjmë përpjekje për të përballuar një situatë shumë të vështirë për Atikën dhe të gjithë vendin".


Ai falenderoi "të gjithë njerëzit të cilët kanë ndihmuar. Vullnetarët dhe veçanërisht zjarrfikësit kanë shpëtuar shumë jetë me vetësakrificën e tyre", transmeton ATSH.

Cipras ndërpreu një vizitë në Bosnjë-Hercegovinë ku do të merrte një çmim për kontributin për paqen në Ballkan.

Të paktën 60 persona humbën jetën pas zjarreve që shpërthyen në Atikën Lindore, ndërkohë që autoritetet i frikësohen faktit për më shumë viktime, pasi shumë persona kanë telefonuar shërbimin zjarrfikës për persona të humbur. Ndërmjet viktimave ka shumë fëmijë. Të gjitha viktimat janë gjetur në zonën mes Rafinas dhe Nea Makri, sidomos në Mati dhe Kokkino Limanaki. Deri tani ka edhe mbi 170 të plagosur.

Mediat atje raportojnë se turistët janë duke u larguar nga plazhet dhe janë duke iku zjarreve me anije nga vendpushimet e rajonit të Athinës. Autoritetet regionale njoftojnë se vendi është në gjendje emergjente, ndërsa qeverisa greke u ka bërë thirrje edhe vendeve të Europës të ofrojnë ndihmë për t'i ndalë zjarret që kanë lënë edhe 150 persona të lënduar. Shumica e trupave të vdekur

CIPRAS: I GJITHË SHTETI NË KËMBË KUNDËR ZJARREVE



Ambasada shqiptare njofton se deri më tani nuk ka pasur humbje jete nga komuniteti shqiptar. Ambasada bën të ditur se në spitalin Evangelismos ndodhet i shtruar një shqiptar

janë gjetur në shtëpitë e tyre apo në makina përgjatë vendpushimeve në Mati, 25 kilometra në veri të kryeqytetit, ka treguar zyrtari i qeverisë atje, Dimitris Tzanakopoulos. Në një situatë të tillë, vendet europiane janë mobilizuar për të ndihmuar shtetin grek.

Qeveria e tij i ka kërkuar vendeve të tjera evropiane për helikopterë dhe zjarrfikës shtesë për të ndihmuar në përballimin e zjarreve. Italia, Gjermania, Polonia dhe Franca kanë dërguar avionëve për vënien nën kontroll të flakëve.

Zjarrët e fundit në Athinën janë më vdekjeprurës të paktën që prej vitit 2007, kur dhjetëra njerëz vdiqën në gadishullin jugor të Peloponezitet.

Por si nisi zjarri në Athinë? Zjarret janë një problem i përsëritur në kryeqytetin grek dhe këtë herë

TOSKAS: ZJARRET JANË TË QËLLIMSHME

Qeveria dhe të gjitha forcat e shtetit janë në gatishmëri të plotë dhe do të kufizojmë sa më shumë të jetë e mundur dëmet nga zjarret në Kineta, deklaroi ministri grek i Mbrojtjes Civile, Nikos Toskas. "Zjarret në zonën malore të Jeranias mund të jenë rezultat i zjarrvënies së qëllimshme

dhe autoritetet po hetojnë", theksoi ai. "Këto zjarre janë të qëllimshme. Natën e kaluar ne patëm dy vatra, po në Jerania, që i vumë shumë shpejt nën kontroll. Sapo zjarri në Kineta u përhap, një tjetër zjarr shpërtheu pranë rafinerisë në Aspropirgos", shtoi Toskas.

flakët janë ndihmuar edhe nga erërat e forta. Por zyrtarët vendas janë shprehur për AFP se mund të kenë qenë zjarrvënës të kërkojnë të plaçkitin shtëpitë e braktisura ata që kanë nisur tragjedinë. Turqia ka ofruar mbështetjen e saj për Greqinë për të përballuar zjarret që përfshirë zonën e Atikës në kryeqytetin grek duke shkaktuar vdekjen e rreth 50 personave.

"Ne jemi gati t'u ndihmojmë," është shprehur ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu gjatë një

telefonate me homologun grek, Nikos Kotzias.

Megjithatë, nuk është e qartë nëse Athina do ta pranojë ofertën. Të dyja dy vendet ndahen nga një histori rivaliteti. Në të kaluarën, të dy shtetet kanë bashkëpunuar në raste fatëkeqësish natyrore si ato të vitit 1999, të quajtura ndryshe "diplomacia e tërmeteve".

Në vijim të tragjedisë në Athinë, ambasada shqiptare atje njofton se deri më tani nuk ka pasur humbje jete nga komuniteti

shqiptar. Ambasada bën të ditur se në spitalin Evangelismos ndodhet i shtruar një shqiptar.

"Ambasada e RSH-së në Athinë njofton se pas komunikimeve me autoritetet greke, deri më tani nuk janë identifikuar viktime nga komuniteti shqiptar. Ndërkohë, në spitalin Evangelismos ndodhet i shtruar një shtetas shqiptar. Ambasada është në ndjekje të situatës duke komunikuar në vijimësi me autoritetet kompetente", thotë ambasada jonë në Athinë.

"Bild": Ekstremi i djathtë i gatshëm për dhunë

Lëvizja e ekstremit të djathtë gjerman "Qytetarët e Mbretërisë" është në rritje dhe gati për aksione të dhunshme, ky është parashikimi i publikuar nga e përditshmja më e shitur gjermane "Bild", pas raportit nga ministri i Brendshëm, Horst Seehofer së bashku me presidentin e Zyrës Federale për Sigurinë (BFV). Janë rreth 16 500 persona të përfshirë në këtë lëvizje në 2017, e cila në vitin 2016 numëronte 10 000 të tillë. Kjo lëvizje nuk njez legjitimitetin e republikës federale, e lindur pas Luftës së Dytë Botërore. "Përveç agresivitetit verbal, ky grup ka pasion armët", sipas raportit të agjencisë federale, që shton se "grupi do të ishte gati për t'i përdorur ato për situatë të dhunshme". (ATSH)

Veriut ka filuar të çmontojë instalimet bërthamore

Një grup i hulmuesve amerikan kanë pohuar se Korea e Veriut ka filuar të çmontojë vendin e testimit të raketave bërthamore, shkruan Fox News, përcjell "Zeri.info".

Kjo është një shenjë e mirë, pasi Kim Jong-un ka filluar t'i përmbush premtimet e tij.

Sipas një analize satelitore të vendndodhjes nga faqja e Koresë Veriore të fokusuar në datën 20-22 korrik, dukej se qeveria ka filluar çmontimin e motorëve të



ndërtimit të raketave balistike.

Disa objekte në atë zonë u rrafshuan, kurse disa të tjera u

tërhoqën, pamjet kanë treguar se Pyongyang ka marrë një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes

së angazhimeve, pasi ato mjete kanë qenë shumë të rëndësishme në zhvillimin e teknologjive bërthamore. Pasi irritimi të Trump i cili ditë më parë në rrjetin e tij social "Twitter" ka fajësuar homologin tij për mos respektimin e marrëveshjes mes dy palëve, ai të hënë ka publikuar një status se është shumë i lumtur që më në fund Kim Jong-un ka filluar ta zbatojë marrëveshjen dhe që po respekton parimet e angazhimeve mes dy palëve.

BE: Të gatshëm për çdo skenar pas Brexit

Të 27 vendet e Bashkimit Evropian nuk janë ende mjaft të gatshëm për të përballuar të gjitha skenaret e mundshme që do të konkretizohen pas daljes së Britanisë nga BE, theksoi zëdhënësi i Komisionit Evropian. "Sidom, qoftë, ne duhet të jemi të

gatshëm për çdo eventualitet, qoftë edhe për mosarritje të një marrëveshjeje", theksoi ai. "Britania e Madhe nuk do të jetë më një shtet anëtar dhe po merren të gjitha masat për të siguruar që institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të jenë gjithnjë të

gatshme", thuhet në deklaratën e Komisionit Evropian. KE u kërkoi qeverive të përgatisin "të gjithë skenarët" duke konsideruar gjithashtu "masa shtesë" për problemet specifike që do të shfaqen në dogana në rast të mosmarrëveshjeve. (ATSH)



KINEMAJA UDHËTUESE E "MAKEDOKS" PËRFUNDON NË STRUGË

Kinemaja udhëtuese "MakeDoks" e përfundon udhëtimin e nëntë, këtë vit në rajonin e Strugës, me "MakeDoks" eko-doku maratonën filmike të festivalit të gjashtë "DrimON" nesër mbrëma nga ora 22 në Shtëpinë e Kulturës "Vëllezërit Milladinovci" në Strugë.

Ditët paraprake Kinemaja udhëtuese kishte projeksione të filmave dokumentar në fshatrat strugan Tashmarunishte, Radozhdë dhe Mali Vllaj.

"Në ndërkohë arriti edhe gjenerata e dytë e "Dokunikulci", me çka filloi edhe punëtorja për film dokumentar kreativ. Të rinjtë menjëherë e kapën ritmin e Kinemasë udhëtuese, morën pjesë në projeksinin në Radozhdë, kishin udhëtim tërëditor në fshatin e shkëlqyer malor Mali Vllaj, ndërsa vetëm për një ditë arritën të pastrojnë një pjesë të madhe të bregdetit të Liqenit të Ohrit në kampin e dikurshëm, "Treska" në Radozhdë, kumtoi "MakeDoks". Eko-aksioni për pastrimin e plazheve do të vazhdojë edhe në



ditët e ardhshme, paralelisht me sesionet e punëtorisë filmike, të cilat i ka udhëhequr Petra Selishkar, selektuese e programit të festivalit "MakeDoks".

Projeksionet e kinemasë udhëtuese përbëjnë tre segmente - program të shkurtër me filma të

animuar për fëmijë, reportazh të "MakeDoks" për kinematë udhëtuese paraprake në rajone të tjera në mbarë shtetin dhe në fund shfaqet filmi dokumentar me metrazh të gjatë. Kinemaja udhëtuese është pjesë e Festivalit të filmave dokumentar kreativ "MakeDoks". Punë-

torja për film dokumentar kreativ "Dokunikulci 2018" realizohet nga data 21 deri më 28 korrik në partneritet me "Festivalin DrimON" dhe me përkrahje të NED (National Endowment for Democracy) dhe Agjencisë për Film të Republikës së Maqedonisë.



Le Figaro 1929: Nisja e Aleksandër Moisiut për në Hollywood

ARGENTINE

Le célèbre acteur allemand Alexandre Moissi, qui a donné l'année dernière des représentations à Paris, vient d'effectuer avec un vif succès une tournée en République Argentine, avec Johanna Terwin comme partenaire principale. Il a été surtout applaudi dans Hamlet, qui est un de ses meilleurs rôles.

Moissi se rend à Hollywood en passant par Valparaiso et New-York.

Prestigjiozia franceze, "Le Figaro", ka botuar, të mërkurën e 8 majit 1929, në faqen n°5, një shkrim në lidhje me suksesin e aktorit të famshëm me origjinë shqiptare, Aleksandër Moisiun, të cilin Aurenc Bebja, nëpërmjet blogut të tij "Dars (Klos), Mat-Albania", e ka sjellë në vijim për publikun shqiptar:

Aktori i famshëm gjerman, Aleksandër Moisiu, i cili dha vitin e kaluar disa shfaqje në Paris, sapo ka bërë një turne të suksesshëm në Republikën e Argjentinës, me Johanna Terwin, gruaja e tij në jetën private, si partnere kryesore.

Ai u duartrokit veçanërisht për rolin në pjesën e "Hamletit", i cili është një nga rolet e tij më të mira. Moisiu do të kalojë nga Valparaiso dhe Nju Jorku për të shkuar në Hollywood."/Blogo © Dars (Klos), Mat-Albania).

"Dance ballet" bashkoi fëmijët e çerdheve të Gostivarit



Në kuadër të Verës kulturore në Gostivar e cila mbahet nën moton Mirë se vini mërgimtarë, dje u realizua Dance ballet për fëmijët, ku performuan fëmijët që frekuentojnë çerdhet publike në komunën e Gostivarit, si dhe çerdhen private "STAR", të të gjitha nacionaliteteve.

Mysafir special në këtë event ishte Lina Demiri - fituese e disa çmimeve në Festivale të këngës për fëmijë, ndërsa performoi edhe grupi i baletit Dance stu-

dioiudhëhequr nga Sarita Selmani.

Për argëtim më të mirë të fatosave gostivaras, në event u paraqitën edhe disa maskota: Elsa, Kluoni dhe Pirati Xhimi.

Në kuadër të Ditëve të Mërgimtarëve, do të mbahet edhe një event tjetër për fëmijë, ndërsa sonte në program është Koncerti me ilahi, që do të realizohet në amfiteatrin e hapur në Gostivar me fillim në ora 20:30. /Shërbimi për informim

MUZIKË SAPNJOLLE NË "VERËN E SHKUPIT"

Mbrëmë (e martë) në kuadër të "Verës e Shkupit" u paraqit me një koncert sopranoja Maria Euhenia Bosh, ndërsa në piano do ta shoqëroj bashkëkombasja e saj, Ana Fere në Muzeun e Qytetit të Shkupit. Koncerti titullohej "Erëra nga Spanja: këngë dhe sarsuela". Drejtorja për kulturë dhe art-Shkup e organizon këtë concert në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Spanjës.

Sopranoja Maria Euhenia Bosh ka diplomuar në Konservatoriumin për muzikë të Sallamankës, ndërsa studimet e magjistraturës në Konservatoriumin mbretëror në Bruksel. Gjatë karrierës ka interpretuar në disa shtëpi të operës, ndërkaq krahas operave, në reper-



toarin e saj shpesh ka edhe oratoriume. Interpreton edhe si muzikante kamertale me numër të

madh të interpretuesve të njohur dhe ansambleve në Francë, Itali, Zvicër, Austri, Gjermani, Rusi, Polo-

ni dhe Amerikë.

Pianistja Ana Fere, ndërkaq, rrjedh nga një familje e njohur

muzikantësh. Pianon dhe muzikën kamertale i ka mësuar në Konservatoriumin në vendin e lindjes, Zhirona dhe në Barcelonë. Ka diplomuar me nota më të larta dhe ka marrë diploma të rangut më të lartë për piano dhe muzikë kamertale. Rregullisht ka interpretuar si muzikante kamertale në përbërje me artistë të njohur të muzikës, por nuk e ka lënë anash as veprimtarinë solistike, duke bashkëpunuar me orkestra të ndryshme në disa vende të botës.

Muzikantet spanjolle në koncertin e "Verës së Shkupit" interpretuan vepra nga Enrike Granados, Federiko Mompou, Hoakin Turina, Manuel de Falla, Pablo Luna.

Liga e parë shtyhet për 12 gusht

Shkup, 24 korrik - Për shkak të kompletimit të dokumentacionit në procesin e licencimit të klubeve, Federata Futbollistike e Maqedonisë vendosi që ta prolongojë fillimin e sezonit të ri. Në vend se më

5 gusht, Liga e parë do të startojë një javë më vonë, pra më 12 gusht, ndërsa hedhja e shortit për sezonin e ri garues 2018/19 në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë, do të bëhet më 1 gusht (e mërkurë)

në ora 12 në hapësirat e FFM-së. Nga "shtëpia e futbollit" i ftojnë të gjitha klubet që të dërgojnë nga një përfaqësues të saj për të parë shortin e dysheve për sezonin e ri garues në elitën e futbollit vendor.



NAPOLI KËRKON "TË BURGOSË" HYSAJN ME KONTRATË TË RE

Kush mendonte se Napoli dëshiron të largojë Elseid Hysajn, është gabuar rëndë. Klubi italian jo vetëm që nuk ka ndër mend të heqë dorë nga mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare, por është gati t'i rinovojë atij kontratën që ka me këtë klub, thuajse duke i dyfishuar rrogën që të arrijë në nivelet e futbollistëve më të mirë të Serisë A

Ashtu sikurse paralajmëroi menaxheri tij, Mario Giuffredi, për Elseid Hysajn po projektohet rinovimi i kontratës me Napolin deri në vitin 2023. Në fakt, një lëvizje e tillë është e pashmangshme pas vendimit të presidentit De Laurentiis për të mos e shitur te Çellsit. Futbollisti i Kombëtares Shqiptare konsiderohet një element shumë i rëndësishëm për organikën e Karlo Ançelottit, por për ta bindur që të mos kërkojë largimin në një ta ardhme të afërt drejtuesit e Napolit do t'i ofrojnë rinovimin e kontratës me rritje të ndjeshme të pagës. Nga marrëveshja e re shkodrani do të përfitojë 2.4 milionë euro neto në sezon deri në vitin 2023. Gjithashtu parashikohet që të hiqet edhe klauzola e largimit, në mënyrë që futbollisti të mos tundohet nga klubet e mëdha evropia-

ne, pasi më parë duhet bindur klubi napolitan për ta shitur. De Laurentiis kërkon t'i bëjë dhuratë trajnerit Ançelotti një mbrojtës të djathtë, pikërisht kolumbianin Arias të PSV Aindhovenit. Kjo nuk do të thotë që stafi teknik nuk ka besim të shqiptari, që luan në këtë pozicion, përkundrazi, Ançelotti mendon se 24-vjeçari mund të ofrojë siguri edhe në krahun e majtë. Me trajnerin e famshëm italian shkodrani do të mund të përmirësohet edhe në fazën sulmuese, teksa më Sarrin kishte më shumë detyra mbrojtëse.



Berisha synon të bëhet lider edhe te Lacio

Mesfushori i përfaqësueses së Kosovës, Valon Berisha, la gjurmë në ndeshjen e parë me fanellën e Lacios. Ai të dielën shënoi një gol dhe asistoi një tjetër në fitoren e Lacios përballë "Top 11 Radio Club 103", ekip të cilin e mposhti me rezultatin 14:0. Gjurmë me Lacion, 25-vjeçari pret të lërë edhe në kampionatin italian, Serie A. Ai të hënën në një intervistë dhënë gazetës ka thënë se është i gatshëm të marrë përgjegjësi për t'u bërë lider edhe te Lacio, ashtu siç ishte te skuadra austriake, Red Bull Salzburgu. "Dua të jem lider i ri i Lazios, jam lojtar që marr përgjegjësi në fushë dhe jam i gatshëm që edhe këtu të jem një prej më të mirëve në ekip. Kam ardhur për të bërë një hap të madh në karrierë. Dua të bëhem një prej më të mirëve për ta dërguar Lacion përpara drejt arritjes së synimeve", ka thënë Berisha. Synimet e tij me Lacion janë titulli i kampionit dhe paraqitja në Ligën e Kampionëve. "Lacio do të jetë në 'top 5' ekipet më të mira. Do të provojmë ta arrijmë një prej katër vendeve që siguron kualifikimin në Ligën e Kampionëve. Në çdo ekip që luaj dua ta fitoj titullin. Në Serie A ka shumë lojtarë që luftojnë për vendin e parë. Kemi përpara skuadra të mëdha si Juventus, Roma, Interi, Napoli, Milani dhe të tjera, por ne jemi të gatshëm t'u bëjmë ballë", deklaroi Berisha.

LATIFI SFIDON KAMPIONIN DANIEL KORMIER

Boll u fshehe, më jep shansin që meritoj

Daniel Kormier ka deklaruar se i kanë mbetur edhe dy ndeshje përpara se të varë dorezat në gozhdë, por kohët e fundit shumë luftëtarë e kanë sfiduar kampionin e dy peshave të ndryshme. I fundit është suedezi me origjinë shqiptare Ilir Latifi. Latifi ka fituar pesë nga gjashtë ndeshjet e fundit në UFC dhe aktualisht është një nga luftëtarët më në formë të peshës "light-heavyweight". "Kampion, përse vazhdon të

fshihesh. Unë jam kundërshtari i duhur ndaj të cilit duhet të mbrosh titullin. Nëse nuk do të ndeshesh me Aleksin, atëherë ndeshu me mua boll u fshehe kampion, më jep mundësinë time. Respekt", ishin fjalët e Latifit në "Instagram". Cekim, Daniel Kormier sapo ka mposhtur Stipe Miocic në peshën e rëndë dhe kërkon një ndeshje multi-milionë dollarë ndaj yllit të "WWE", Brok Lesnar.



NJË DËMTIM I BOATENGUT NDRYSHON GJITHÇKA

Sadiku mund të mbetet te Levante



Armando Sadiku është në merkato dhe deri më tani është folur vetëm për interesimin e turqve të Rizespor. Gjithsesi prej kur ka dalë lajmi ka kaluar pak kohë, ndërkohë që sulmuesi i kombëtares ka nisur fazën përgatitore me Levanten. Ende nuk dihet e ardhmja, por sulmuesi mund të qëndrojë në La Liga, të paktën deri në janar. Së fundmi klubi spanjoll është përballur me një problem. Emanuel Boateng, një nga lojtarët kryesorë të sulmit, është dëmtuar në ndeshjen miqësore kundër

Bornmaut. Boateng ka kryer testet e para mjekësore dhe është vënë re se ka probleme me meniskun. Të martën ai do të vizitohet nga kirurgu Ernesto Fernandez, i cili do të përcaktojë edhe shkallën e dëmtimit dhe mënyrën e rikuperimit të sulmuesit. Në rastin më të keq ai mund të qëndrojë rreth tre muaj larg fushave të blerta, ndaj edhe shitja e Armando Sadikut mund të rivlerësohet nga ana e klubit, pasi veç tij në ekip ka mbetur edhe Roxher Marti, pasi sikurse dihet italiani Pacini është larguar.



DE ROSSI SFIDON JUVENTUSIN DHE RONALDON

Të gjithë e fillojmë nga zero pikë

Është një ditë e rëndësishme për Daniele De Rossin, i cili mbush 35 vjeç dhe ky përvjetor festohet nga Roma në profilet sociale të klubit. Kapiteni verdhekuq, i intervistuar nga "NBC", thotë se tashmë po mendon për sezonin e ri. "Kam besim të mjaftueshëm tek ekipi dhe trajneri. Është viti i tij i dytë dhe gjithçka do të jetë ndoshta më e lehtë, sepse ai nuk duhet të fillojë nga fillimi. Trajneri mund të lloga-

risë një grup bazë lojtarësh, tashmë të testuar, të cilët e dinë se çfarë dëshiron Roma prej tyre. Herën e parë që takova Di Francesco unë isha 18 vjeç. Edhe tashmë është po ashtu. Si trajner, ai dëshiron të synojë më të mirën, ashtu si kur ishte futbollist. Ai ka një mentalitet fituesi dhe po përpiket ta transferojë këtë në ekip", – thekson De Rossi. Ndryshe, kapiteni i Romës shpreson të fitojë diçka në

sezonin e ri, edhe për të sfiduar Juventusin e Kristiano Ronaldos. "Shpresoj që të sjellim diçka te Roma, ndonjë trofe. Kjo është diçka shumë e lehtë për t'u thënë, por shumë e vështirë për t'u bërë. Do të përpiqemi të bëjmë diçka të pabesueshme, sepse ekipet që arrijnë në vendin e parë dhe të dytë sezonin e kaluar janë përmirësuar. Juventus ka marrë një nga lojtarët më të mirë në histori Kristiano Ro-



naldon. Sidoqoftë, asgjë nuk është e shkruar në futboll, ne e kemi parë këtë edhe në Botërorin e Rusisë. Ne nuk jemi duke filluar nga gjy-

smëfinalët e Çampionsit, apo vendi i tretë në Seria A. Të gjithë e fillojnë nga zero pikë, si Kaljari, edhe Juventus", deklaroi De Rossi.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune tekst i pastruar – (Gazeta zyrtare e RM" numër 167/15, 27/16 dhe 120/18) v.v. me nenin 14, 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, 8, 13 dhe 14 nga Ligji për të punësuar në sektorin publik (Gazeta zyrtare e RM" numër 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), Rregullorja për organizim dhe punën e drejtorisë doganore numër 02-14736/1 nga data 06.10.2015 dhe me numër 04-065421/15-0012 të datës 21.06.2016 dhe rregullores për sistematizim të vendeve të punës në drejtorinë doganore numër 02-14736/1 nga data 06.10.2015 me numër 01-065421/15-0007 të datës 25.02.2016 dhe me numrin 01-065421/15-0013 nga data 21.06.2016, ndryshimi i rregullores për sistematizim të vendeve të punës në drejtorinë doganore numër 01-065421/15-0035 të datës 03.07.2018 dhe të njohimit nga Ministria e financave numër 18-7560/2 të datës 11.07.2018, Drejtoria doganore shpall:

SHPALLJE PUBLIKE numër 2/2018

Për punësimin e 2 (personave) kryerës të punëve me afat të caktuar, për shkak të punës së shtuar të përkohshme, deri në fund të vitit rrethës fiskal (2018). Drejtoria doganore shpall shpallje (konkurs) për punësimin e 2 (personave) kryerës të punëve me kohë të caktuar deri në fund të vitit rrethës fiskal (2018) dhe atë:

1. UDHËHEQËS I NDRRRIMIT NË IMPIANTIN (PAJISJE) DOGANOR BILATO, VENDI I PUNËS NGA NIVELI B4 NGA KATEGORIA E NËPUNËSVE UDHËHEQËS DOGANOR – 1 KRYERËS TË PUNËVE

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta përdor gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësinë e mirë shëndetësore për vendin e punës dhe
- me dokument fuqiptorë nga gjykata të mos i jetë shqiptuar ndalesë ndëshkuese në kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushte të veçanta:

- shkencë ekonomike, shkencë juridike, elektroteknikë, makineri, shkencave organizative dhe udhëheqjes (menaxhment), rregullimin dhe udhëheqjen me procese teknologjike, teknologji të prodhimeve ushqimore dhe të teknologjisë së tekstilit me nivelin e kualifikimit VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kreditë të fituara sipas EKTS ose të ketë mbaruar shkallën VII/1,
- njohjen e së paku 3 gjuhëve që përdoren më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuhës angleze, franceze, gjermane),
- njohja aktive të programeve të kompjuterit për punë në zyrë,
- Përvojë pune së paku 2 vjet në punë doganore ose në profesion.

Kandidatët duhet t'i paraqesin dokumentet e nevojshme në vijim:

- Dëshmi për shtetësinë;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë e ndalesës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- Dëshmi certifikatë – diplomën për shkallën e mbaruar të arsimimit;
- Dëshmi për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohjen e njërës nga tri gjuhës që përdoren më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuhës angleze, franceze, gjermane);
- Dëshmi për përvojën e punës (pasqyrë e të dhënave të regjistruara në evidencën amë të dhënë nga fondi për sigurimin pensional dhe invalidor të Maqedonisë).
- Fletëparaqitje dhe biografi e shkurtër me paraqitjen e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të kandidatit, email adresën dhe telefonin për kontakt.

Kandidatët janë të detyrur të paraqesin fletëparaqitje, biografi të shkurtër dhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në dokumente origjinale ose kopje të vërtetuara te noteri.

Të drejtë të paraqitjes kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për të konkurruar. Kushtet e paraqitura në shpalljen, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Orari i kohës së punës: Orët e punës gjatë javës: 40 orë,

Orari i punës: nga e hëna deri të premten prej orës 08.30 deri në ora 16.30

Shuma e parave në bazë të neto pagës: 33.432,00 denar.

Me kandidatët e zgjedhur do të kontraktohet marrëveshje (kontratë) për punësim me kohë të caktuar deri më 31.12.2018.

2. KËSHILLTAR PËR PROJEKTE NË SHËRBI NË SEKTORIN PËR BASHKËPUNIM NDRËKOMBËTAR VENDI I PUNËS NGA NIVELI V3 NGA KATEGORIA E NËPUNËSVE PROFESIONAL DOGANOR – 1 KRYERËS I PUNËVE

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta përdor gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të jetë i aftë për kryerjen e punëve për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushte të veçanta:

- shkencë ekonomike, shkencë juridike, elektroteknikë, makineri, shkencave organizative dhe udhëheqjes (menaxhment), rregullimin dhe udhëheqjen me procese teknologjike, teknologji të prodhimeve ushqimore dhe të teknologjisë së tekstilit, shkencën për letërsi dhe të shkencës për gjuhën (linguistikën) me nivelin e kualifikimit VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kreditë të fituara sipas EKTS ose të shkallës të VII/1 të mbaruar,
- Dëshmi për njohjen e njërës nga tri gjuhës që përdoren më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuhës angleze, franceze, gjermane);
- njohja aktive të programeve të kompjuterit për punë në zyrë,
- Përvojë pune së paku 1 vjet në punë doganore ose në profesion.

Kandidatët duhet t'i paraqesin dokumentet e nevojshme në vijim:

- Dëshmi për shtetësinë;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë e ndalesës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- Dëshmi certifikatë – diplomën për shkallën e mbaruar të arsimimit;
- Dëshmi për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohjen e njërës nga tri gjuhës që përdoren më së shpeshti në Bashkimin Evropian (gjuhës angleze, franceze, gjermane);
- Dëshmi për përvojën e punës (pasqyrë e të dhënave të regjistruara në evidencën amë të dhënë nga fondi për sigurimin pensional dhe invalidor të Maqedonisë).
- Fletëparaqitje dhe biografi e shkurtër me paraqitjen e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të kandidatit, email adresën dhe telefonin për kontakt.

Kandidatët janë të detyrur të paraqesin fletëparaqitje dhe biografi të shkurtër dhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në origjinal apo kopje të vërtetuara te noteri.

Të drejtë të paraqitjes kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për të konkurruar. Kushtet e paraqitura në konkurs (shpallje), kandidatët duhet t'i plotësojnë (përmbushin) në momentin e paraqitjes.

Orari i punës: Orët e punës gjatë javës: 40 orë,

Shuma e pagesës në bazë të neto pagës: 30.724,00 denar.

Me kandidatët e zgjedhur do të kontraktohet marrëveshje (kontratë) për punësim me afat të caktuar deri më 31.12.2018.

Afati i paraqitjes të fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme zgjat 3 (tri) ditë pune të llogaritur nga dita e ardhshme nga dita e shpalljes të konkursit (shpalljes) (duke mos e llogaritur ditën e shpalljes), përkatësisht më së voni deri më 30. 07. 2018 (e hëna). Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afatin e paraparë në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 nga Ligji për marrëdhënie pune.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohet në arkivin e drejtorisë doganore ose me anë të postës në adresën në vijim: Rr. Llazar Liçenovski" numër 13, 1000 Shkup. Arkivi i drejtorisë doganore (me shenjën "për shpalljen për punësim numër 2/2018").

Numri për kontakt 02 3166 188 Sektori për udhëheqje me resurse njerëzore pranë Drejtorisë doganore të RM.

Fletëparaqitjet e dorëzuara jo me kohë dhe të pa kompletuara nuk do të merren parasysh.

Nr. 04-054910/18-0003

Shkup, 19.07.2018

Drejtor

Mr. Gjoko Tanasoski

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit për marrëdhënie të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

Shpallje

për

punësim me kohë të caktuar deri më 31.12.2018

1. Për nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Referent i lartë të shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror- një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku tri vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);

- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 15.660 denarë

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/ diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/ dëshminë për përvojën e punës;
- Vërtetimin/ dëshminë për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Vërtetimin/ dëshminë për njohje aktive të gjuhëve
- Dëshminë se nuk i është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë;

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune – 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten; ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

IV. Shpallja do të jetë e hapur pesë ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditor.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë – shërbimi qendror, ruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup



Republika e Maqedonisë
Komuna e Tearcës

Nr. 09-445/3
24.07.2018

SEKSIONI PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT JETËSOR

Në bazë të nenit 35 të Ligjit për planifikim hapësinorë dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16) dhe Vendimit me nr.09-445/2 me dt. 23.07.2018, Kryetari i komunës së Tearcës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

Për organizimin e Prezentimit Publik dhe Anketës Publike për miratimin e Dokumentacionit planorë lokal urbanistik për kompleksin ekonomik– për parcelën ndërtimore PN_D.1. për PK nr.2925 KK Dobroshtë jashtë rajonit ndërtimor, B3- njësi të mëdhaja hotelierike dhe D3- sport dhe rekreacion- Komuna e Tearcës, i përpiluar nga Shoqata për plane hapësinore dhe urbanistike URBANPLAN SHPK Tetovë, me nr. teknik 4-6/16 me dt. 06.2018, ka kërkesë me nr. 09-183 me dt. 18.04.2016.

Kufijtë e gjithëpërfshirjes janë paraqitur grafikiisht dukshëm në hapësirat e Komunës së Tearcës .

Anketa publike dhe prezentimi publik për :

Dokumentacionin planorë lokal urbanistik për kompleksin ekonomik – për parcelën ndërtimore PN_D.1. për PK nr.2925 KK Dobroshtë jashtë rajonit ndërtimor, B3- njësi të mëdhaja hotelierike dhe D3- sport dhe rekreacion.- Komuna e Tearcës., do të kryhet me paraqitjen në vend të dukshëm në hapësirat e Komunës së Tearcës.

Anketa publike do të zgjat 5 (pesë) ditë pune edhe atë prej **01.08.2018** deri **08.08.2018**, ndërsa Prezentimi publik do të mbahet në ditën **01.08.2018 (e mërkurë) në ora 12:00** në hapësirat e Komunës së Tearcës (salla në përdhese).

Qytetarët e interesuar dhe personat juridik në afatin e paraparë, në fletat anketuese të përgatitura nga Komuna e Tearcës, do të mund t'i japin vërejtjet e tyre dhe në kohë ti dorëzojnë në komunë.

Kryetar
ISEN ASANI

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+ Pr+1+Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Tel: 02 3179 - 904. Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

"GOAL" PARALAJMËRON SHKËMBIMIN SHOKUES



Drejtori teknik i Milanit, Leonardo, dhe ai i Juventusit, Beppe Marotta, ishin në bisedë për marrëveshjen e pabesueshme të shkëmbimit të hënën, edhe pse diskutimet janë ende në një fazë të hershme

BONUÇI TE JUVENTUSI, HIGUAIN TE MILANI?

Juventusi dhe Milani kanë hapur diskutimet paraprake për një marrëveshje të mundshme shkëmbimi, që përfshin Leonardo Bonučin dhe Gonzalo Higuain. "Goal.com" kupton se Juve po konsideron seriozisht rikthimin e mbrojtësit 31-vjeçar, pasi Bonuçi i ka lënë kampionët e Seria A vetëm një vit më parë. Higuain, i cili ka gjasa të lëvizë, pas blerjes mahnitëse të Juventusit, të yllit të Real Madridit, Cristiano Ronaldo, mund të kryesojë në drejtimin tjetër. Për këtë shkëmbim, bisedimet fillestare mes të dy klubeve kanë ndodhur. Drejtori teknik i Milanit, Leonardo, dhe ai i Juventusit, Beppe Marot-

ta, ishin në bisedë për marrëveshjen e pabesueshme të shkëmbimit të hënën, edhe pse diskutimet janë ende në një fazë të hershme. Megjithatë, Juve ka biseduar me agjentin e Bonuçit, Alessandro Lucci, i cili ka dhënë reagime pozitive mbi gjasat që qendërmbrojtësi të jetë i interesuar për një kthim në Torino. Raportet kanë sugjeruar se PSZH dhe Manchester Junajted janë, gjithashtu, të interesuar për Bonuçin, i cili bëri 51 paraqitje në të gjitha garat për Milanin në sezonin 2017-2018. Ndërkohë, trajneri i Milanit, Xhennaro Gattuso, shpreson që klubi të jetë në gjendje ta mbajë Bonuçin,

megjithëse pranon që, nëse lojtari kërkon të largohet, do të jetë e vështirë ta bindë atë të qëndrojë. "E ardhmja e tij nuk dihet. Kam biseduar me të, Bonuçin kishte një sqarim për mua, por unë nuk jam klubi. Ai duhet të flasë me menaxherët. Për sa kohë që vesh fanellën e Milanit, unë dua të shoh Bonuccin e këtyre 12 ditëve të para stërvitjeje. Ai është një profesionist i madh dhe gjithmonë i pari, që udhëheq grupin. Shpresoj se mund të qëndrojë, është një lojtar i vlefshëm, me mentalitet të madh. Kur një lojtar shpreh dëshirën, trajneri dhe ata që punojnë në një grup duhet të bëjnë gjithçka që është e mun-

dur ta bindin atë për të qëndruar. Ne duhet të mendojmë për pro dhe kundër. Nëse lojtari kërkon në mënyrë eksplicite që të largohet, ne duhet ta trajtojmë këtë temë", deklaroi Gattuso. Ndërkohë, e ardhmja e Higuain te Juve është e paqartë, me të gjitha shenjat që tregojnë se argentinasi është duke u larguar. Në sulmin bardhezi nuk ka më vend për të, sepse veç Ronaldos, janë edhe lojtarë të tjerë si Paulo Dybala, Mario Manxhukic, Douglas Costa dhe Federico Bernardeski. Milani është i interesuar për Higuain, që është njeriu i duhur për ta udhëhequr sulmin kuqez i në sezonin e ardhshëm.

PROVERA ÇMEND TIFOZËT E INTERIT

Përgjigja për Ronaldon tek Juventus është Mesi

Tifozët e Interit kanë të drejtë të shpresojnë për sa kohë është sponsori historik i tyre "Pirelli" ai i cili ndez zëra për një transferim të Mesit në Milano. Ka qenë Marko Tronketi Provera ai i cili ka hapur mundësinë e një transferimi duke thënë se asnjëherë nuk mund të thotë "Jo" për Mesin. "Kristiano Ronaldo është i mirë për futbollin italian. CR7 me bardhezijnë është shumë i mirë për futbollin italian: do të krijojë më shumë vëmendje, edhe për ekipet e tjera ka të ardhur-

ra më të mëdha potenciale, rivalët do të lëvizin për të fituar kampionatin. Ishin shumë të mirë, tani ata kanë nënshkruar me një hit shumë profesional", tha fillimisht Tronketi Provera në fjalimin e tij në emisionin "Politics in the ball" nga Gr Parlamento. Mesi? Si të them jo për Mesi-n? Nëse do të kishte një operacion të tillë, tifozët do të ishin entuziastë. Por kjo i takon së ardhmes, nëse diçka do të ndodhë, ende duket shumë larg", përfundoi një nga përfaqësuesit të Pirelit.



Herrera ose Vidal tek Interi



Tani nuk ka më dyshime, goditja e fundit e madhe e tregut të transferimeve do të arrijë në mesfushë tek Interi. Dhe ky është reparti, ku trajneri Luciano Spalletti kërkoi një përforcim të rangut të lartë për një paraqitje më të mirë sezonin e ardhshëm, por sidomos në Ligën e Kampionëve. Së pari, megjithatë, klubi do të duhet të "krasitë trëndafilin" dhe mbi të gjitha të gjejë një vend për Zhoao Marion, për të cilin, pas blerjes së Moutinjos, është mjegulluar hipoteza "Wolverhampton". Sporting Lisbona, sipas "La Gazzetta dello Sport", do të jetë shumë i kënaqur për ta rimarrë mesfushorin portugez, por Interi duhet të paktën të paguajë një pjesë të angazhimit për të lehtësuar operacionin. Pasi të sistemojë Zhoao Marion, Interi do të mendojë t'i bëjë një dhuratë Spallettit, i cili duhet të

jetë njëri nga Hektor Herrera dhe Arturo Vidal. Ish-lojtari i Juventusit, sipas "Corriere dello Sport", është i tepërt te Bajerni Munihi dhe do të largohet me dëshirë për t'u kthyer në Itali, por zikalterve u nevojiten të paktën 30 milionë euro për ta blerë. Të gjitha, pa marrë parasysh se aktualisht, mesfushori nga Kili fiton rreth 8 milionë euro neto për sezon. Ndoshta edhe më e vështirë do të jetë situata për të marrë shërbimet e meksikanit të Portos, Herrera, i cili ka një klauzolë lirim prej 40 milionë eurosh, pavarësisht se kontrata i skadon më 2019. Së fundi, lajmi mirë nuk vjen as nga Vrsaljko. Atletiko Madridi nuk e pranoi hipotezën e huazimit me të drejtën e shpengimit të plotë, të propozuar nga Interi. Alternativat Darmian dhe Zappakosta prandaj qëndrojnë në këmbë.

LAJME SHKURT

Jam i lumtur te Bajerni

Mesfushori i Real Madridit, James Rodriguez thotë se është i lumtur në Bajern Munihi. Kapitani i Kolombisë është në mes të rrugës së huazimit edhe për një sezon te bavarezët, apo rikthimit te klubi që posedon kartonin e tij, Real Madridit. Por, duket se futbollisti dëshiron të mbetet ende te kampioni gjerman së paku edhe për një sezon. "Jam ende në Bajern, kam pasur një sezon spektakolar dhe jam shumë i lumtur", deklaroi Hames. Ndryshe, Bajerni ka të drejtë blerje për 45 milionë euro të lojtarit pas dy vjet huazimi, e cila gjë i kushton dhjetë milionë euro në sezon.

Barça "vjedh" Malkomin

Malkom do të jetë një lojtar i Barcelonas, që ka befasuar Romanon. Italianët kanë arritur marrëveshjen për sulmuesin brazilian, me Roma dhe Bordon që kanë konfirmuar gjithçka në rrjetet sociale, teksa pritej vetëm zbarkimi i lojtarit në Itali dhe vizitat mjekësore për të zyrtarizuar operacionin. Tani, sipas "Mirror", Bordo ka anuluar fluturimin pasi ka marrë një ofertë më të lartë nga katalanasit, të cilët duket se kanë hequr dorë nga Uillian.

Pepe drejt Vulverhemptonin

Pepe mund t'i japë lamtumirën Turqisë vetëm pas një sezoni. Mbrojtësi i Beshiktashit pritet të transferohet te Vulverhemptoni, skuadër, që është ngjitur këtë sezon në Premier Ligë. 35-vjeçari kërkohet me ngulm nga trajneri i skuadrës angleze, Nuno Espirito Santo, i cili ka shumë besim tek aftësitë e portugezit. 44-vjeçari për të siguruar sa më parë shërbimet e mbrojtësit ka nisur menjëherë bisedimet me agjentin e lojtarit, Jorge Mendes.

Valencia kërkon Laksaltin

Valencia nuk ndalet në merkato. Pasi siguroi shërbimet e mbrojtësit Kristiano Piccini, klubi nga "Mestalla" synon të përforcojë edhe mesfushën. Trajneri i spanjollëve Marcelino ka piketuar 25-vjeçarin e Genoas, Diego Laksalt. Për ta lënë të lirë uruguianin, drejtuesit e klubit italian kërkojnë shumën e 20 milionë Eurove. Sipas asaj që raportojnë mediat, spanjollët janë të vendosur për ta blerë lojtarin dhe me shumë mundësi shumë shpejt do të nisin bisedimet me drejtuesit e Xhenoas.

ÇËSHTJA "OZIL" SHNDËRROHET NË LUFTË DIPLOMATIKE GJERMANI-TURQI

ERDOGAN MBËSHTET LAMTUMIRËN E FUTBOLLISTIT

Mbështetjen më të madhe Ozil e ka marrë nga jashtë Gjermanisë, dhe sikurse është e pritshme, me epiqendër në Turqi, ku çështja pati fillimin e vet, pas asaj foto mes futbollistit dhe Erdogan. Referuar raportimeve të "AS", ministri i punëve të jashtme të Turqisë ka kontaktuar futbollistin për t'i shprehur të gjithë mbështetjen e atdheut të tij. Ndërkohë, zëdhënësi i qeverisë ka folur hapur për çështjen

Çështja e tërheqjes së Ozil nga kombëtarja gjermane tashmë është shndërruar në një çështje të diplomacisë ndërkombëtare. Normale, kur konsiderohet fakti që një prej aktorëve kryesorë të çështjes në fjalë që ka tronditur në themele përfaqësuesen e Gjermanisë, aq sa për ta eliminuar në Botëror që në fazën e grupeve, është pikërisht presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Shtrëngimi i duarve mes tij dhe Ozil e Gundogan krijoi shumë polemika, madje me kërkesën e një pjese të



opinionit publik popullor, për të përjashtuar dyshen gjermanoruse nga ekipi i grumbulluar në Rusi. Gjithsesi, në përfundim të dy futbollistët udhëtuan në Rusi, por rezultatet nuk ishin aspak të kënaqshme dhe me kthimin në Gjermani, polemikat vijuan, madje edhe më të forta. Dhe për të hedhur benzinë mbi zjarr ishte vetë Ozil.

Reagimet e tij në "Twitter", që kishin të bënin si me çështjen "Erdogan", ashtu edhe me marrëdhënien me Federatën Gjermane dhe tifozët, kanë shkaktuar një ferr të vërtetë mediatic. Për të mos folur

për zgjedhjen e tij për tu larguar nga kombëtarja gjermane. Mes të paktëve në Gjermani që doli në mbështetje të Ozil ishte kancelaria Angela Merkel, e cila duke pranuar lamtumirën e Ozil nga fanella përfaqësuese, për të respektuar zgjedhjen e futbollistit, ka theksuar edhe kontributin e madh të dhënë nga ana e futbollistit të Arsenalit për Gjermaninë ndër vite. Ndërsa, mbështetjen më të madhe Ozil e ka marrë nga jashtë Gjermanisë, dhe sikurse është e pritshme, me epiqendër në Turqi, ku çështja pati fillimin e vet, pas asaj foto mes futbollistit dhe Erdo-

gan. Referuar raportimeve të "AS", ministri i punëve të jashtme të Turqisë ka kontaktuar futbollistin për t'i shprehur të gjithë mbështetjen e atdheut të tij. Ndërkohë, zëdhënësi i qeverisë ka folur hapur për çështjen. "Në Evropë ekziston një krizë, që ka arritur në një pikë në të cilën hyhet në konflikt me vlera universal. Kjo na bën të mos ndihemi rehat. Fatkeqësisht, shohim se liritë dhe të drejtat humane në Evropë janë zbehur dhe se ka një theksim të racizmit dhe të diskriminimit. Vendimi i Ozil na duket i drejtë", deklaroi zëdhënësi i qeverisë turke.



Tare kandidat për drejtor sportiv te Milani

Të martën ka qënë dita e lamtumirës së Massimiliano Mirabellit nga Milani. Drejtori sportiv kuqez, është larguar pak më shumë se një vit nga emërimi në këtë detyrë. Mirabelli, sipas mediave italiane, konsiderohet një njeri i afërt me administratorin e deleguar tashmë të shkarkuar Marko Fassone, ndaj nuk shihet si një njeri i besuar. Në numrit e djeshëm të "Gazzetta Dello Sport" shkruhej se kandidat për rolin e drejtorit sportiv të Milanit është edhe Iglor Tare, njeriu që ka projektuar merkaton tepër të suksesshme të Lacios. Ish-futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, konkurron për këtë post me Kristiano Giuntolin, që është shumë pranë largimit nga Napoli. Gjithashtu flitet edhe për rikthimin e Ariedo Braidias, aktualisht drejtor i sektorit të marrëdhënive me jashtë te Barcelona. Gjithsesi, do të jetë shumë e vështirë që presidenti i Lacios, Klaudio Lotito, të lejojë largimin e Tares nga bardheklatri.

SHPENZIME NË MERKATON E VERËS SA PREMIER LIGA

Rikthehet Serie A

Italia, vendi që dominonte futbollin evropian në vitet '60 (Interi dhe Milani) dhe '80 (Milani dhe Juventus), është kthyer. Hierarkia e saj në futbollin kontinental pësoi rënie gjatë dekadës së kaluar, por tashmë ka marrë "fluturimin" dhe sot është në krye të ligave të mëdha evropiane, që rivalizon Premier Liga në aspektin e parave të investuara në blerje lojtarësh. Për sezonin 2018-2019, anglezët kanë shpenzuar 935 milionë euro, ndërsa italianët 875 milionë euro. Spanja i shikon ato nga larg, me 527 milionë euro. Këto janë vlerësimet se si po lëviz merkatoja, por jo

shifra definitive. Ne duhet të vlerësojmë që, nëse Premier Liga dhe Seria A janë më në avancë me kohën e nënshkrimeve, ato janë të kushtëzuara, sepse afati i tregjeve të tyre, gjithashtu, mbyllet më parë. Merkatoja në Angli mbyllet më 9 gusht; ndërsa ajo në Itali më 19 gusht. Për klubet e Spanjës, Gjermanisë dhe Francës, ky afat ka limit datën 31 gusht. Në fakt, është Juventus, skuadra që po e tërheq "makinën" e Italisë në merkaton e kësaj vere. Kampionët italianë kanë bërë tri transferimet më të shtrenjta në Seria A: Ronaldo (117 milionë euro), Kancelo (40.4 mi-

lionë) dhe Daglas Kosta (40 milionë). Klubi bardhezi është ai që ka investuar më shumë para në Evropë, 212 milionë euro. Më shumë se çdo klub britanik, lista e të cilëve në këtë merkato udhëhiqet nga Liverpuli, me 182 milionë euro. Italia është vendi i vetëm, ku dy klube kanë tejkaluar shifrën e 100 milionë eurove investim në merkaton e verës së këtij viti: Juventus (212,9 milionë euro) dhe Roma (133.4 milionë). Për ata që mendojnë se në Itali janë çmendur në këtë drejtim, një studim nga firma konsulente "KPMC" thotë se është e mundur që Juven-



tusi, në dy, ose tri vite të ketë shpenzuar 340 milionë euro për KR7 (nënshkrimi dhe pagat).

Interesante është ajo që përndodh në Bundesliga, ku Bajern Munihu ende nuk ka shpenzuar një euro të vetme, ndërsa ka përfutuar 40 milionë nga shitja e Da-

glas Kosta. Franca është, gjithashtu, një tjetër merkato gjumi. Shpenzimi i vjetshëm prej 314 milionë euro është fryrë nga 135 milionë e nënshkrimit të Mbappe, teksa PSZH ka paguar për të anashkaluar pasojat e "fair play financiar" të FIFA-s.

3 GJUHËT QË FËMIJËT DUHET T'I MËSOJNË

Cilën gjuhë do të inkurajoni fëmijën tënd që të mësojë për të përfituar një të ardhme më të mirë?

Historikisht, përgjigjja ka qenë gjuha spanjolle, duke pasur parasysh numrin e vendeve në botë që e flasin. Mirëpo, studimet e fundit, preferojnë frëngjishten, gjermanishten dhe gjuhën mandarine.

Qendra ekonomike për biznes, hulumtime dhe opinion në bashkëpunim me aeroportin Heathrow, ka anketuar 2,001 prindër dhe fëmijë nën moshën 18 vjeçare, krahas një studimi prej më shumë se 500 liderëve të bizneseve përrreth Britanisë së Madhe.

45% e prindërve thanë se fëmijët e tyre nuk flasin një gjuhë të dytë, ndërsa 19% thanë se nuk janë të interesuar që të mësojnë një gjuhë të dytë.

Një në 10 persona tha se fëmijët e tyre e kanë shumë të vështirë të mësojnë gjuhë të reja.

Hulumtuesit gjetën se frëngjishtja, gjermanishtja dhe gjuha mandarine janë tri gjuhët që fëmijët do të duhet të mësojnë për të përfituar jetën e tyre në dhjetë vite.

Aftësitë në gjuhë pritet që të shtojnë deri në 500 miliardë ekonominë deri në vitin 2027.



Profesor i Linguistikës Zhvillimore në Universitetin e Edinburgut dhe Drejtor i Çështjeve Dygjuhësore, Antonella Sorace tha:

Ky hulumtim tregon se sa e rëndësishme është të mësuarit e gjuhës në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar dhe tregon se shumë më tepër detyrë hapen njerëzve që mësojnë një gjuhë të dytë si fëmijë.

"Ne besojmë se mësimi i gjuhës është jashtëzakonisht i dobishëm për zhvillimin e fëmijëve dhe është një inve-

stim real për të ardhmen: fëmijët të cilët janë të ekspozuar ndaj gjuhëve të ndryshme bëhen më të vetëdijshëm për kulturat e ndryshme, njerëzit e tjerë dhe pikëpamjet e tjera."

Ata gjithashtu kanë tendencë që të jenë më mirë se monolingët në 'multitasking' dhe shpesh janë lexues më të avancuar. Dygjuhësia u jep fëmijëve shumë më tepër se vetëm dy gjuhë, prandaj është e mrekullueshme të shohësh se Heathrow po ndihmon për të nxitur fëmijët për të mësuar gjuhët.

Ngjyra "rozë-ari", moda që nuk vdes



Është praktikisht, trendi i modës që nuk largohet kurrë. Nga Londra në Xhakartë, dyqanet e luksit do ta kenë patjetër një produkt në ngjyrë rozë të lehtë, qofte veshje, qofte çantë apo aksesor.

Kjo nuancë e pazakonte e rozës duket se gjendet kudo në ditët tona, por ajo i ka kapërcyer kufijtë e modës dhe bizhuterive. Në panairin e orëdivë, të hapur në Milano prillin e këtij viti, më i madhi i interierëve në botë, "rozë-ari" ishte ngjyra mbizotëruese e kuzhinave të ekspozuara për publikun.

Tashmë gjendet në çdo vend: në dasma, torta, e madje edhe tek vetura. Po përse është kaq e famshme? "Publiku i gjërë, thotë BBC-së – nuk kishte dëgjuar shumë për këtë ngjyrë deri kur Apple hodhi në treg shtatorin e 2015-ës modelin iPhone 6S".

iPhone 6S u bë një prej smartfonëve më i famshëm i kompanisë dhe 40% e porositve rezultuan për modelin rozë-ari.

Apple, praktikisht e rrënjosi këtë ngjyrë në ndërgjegjen e konsumatorit, shkruan tch. Por ajo kishte ekzistuar shumë kohë përpara se të përzgjidhej për smartfonin e famshëm.

Rozë-ari, majat e suksesit i mbërriti fillimisht në 2012-ën, kur gjeti një vend të zgjeruar tek bizhuteritë e pas kësaj, nisi të mbushte pasarelata e dizajnerave të famshëm si Roberto Cavalli apo Jimmy Cho.

Të pathënat e realizimit të filmit Titanic

1. Aktorë si Tom Cruise, Brad Pitt, Christian Bale, Macaulay Culkin dhe Matthee Mçonaughey morën pjesë në audicione për rolin e Jack Dawson. Kate Winslet madje bëri edhe një provë me Matthew Mçonaughey. Por në fund rolin e mori i riu dhe (asokohe jo shumë i njohuri) Leonardo DiCaprio.

2. As Kate Winslet nuk e pati të lehtë. Madonna, Sharon Stone, Nicole Kidman, Gëyneth Paltroë, Wynona Rider dhe Uma Thurman qenë konkurrentet e saj. Për ta fituar rolin me patjetër, Kate gjeti numrin e telefonit të regjisorit dhe e telefonoi menjëherë: "Duhet ta marr unë rolin. Do të ishe i çmendur nëse nuk do të më merrje mua." Kate e ka mohuar këtë, por ka pranuar se i ka dërguar trëndafilat James Cameron-it (regjisorit) me shënimin "Nga Rose- a juaj".

3. Filmi Titanic kushtoi më shumë se vetë anija. Vlera e filmit qe 200 milionë dollarë ndërsa e anijes vetëm 7.5 milionë dollarë.

4. Sipas skenarit, Rose duhej ta gjuante të fejuarin me takë, por Kate mendoi se do të dukej më mirë nëse do ta pështynte në fytyrë. Dhë kështu u bë!

5. Cameron nuk dëshironte të kishte asnjë kolonë zanore në film. Por kompozitori James Horner në mënyrë të fshehtë regjistroi këngën e Celine Dion-

it dhe ia dha kasetën më pas regjisorit. Këngëtarja kishte dyshimet e saj rreth këngës por kur lexoi skenarin ndryshoi mendje. Në fund të regjistrimit, të gjithë u përletën!

6. Ju kujtohet fraza e DiCaprio-s: Unë jam mbreti i botës? Qe i gjithi improvizim nga ana e tij.

7. Filmi ka thyer shumë rekorde. Ndër të tjera, qe filmi që qëndroi për më gjatë në ekrane: 287 ditë.

8. Fustani i Kate Winslet-it u realizua në një mënyrë që të dukej perfekt edhe i lagur.

9. Pjesa e drunjtë që Rose përdori për të shpëtuar është gjetur pas përmbajtjes së vërtetë të anijes. Mementalisht ndodhet në muze në Halifax.

10. Skena ku Jack pikturon portretin e Rose është realizuar që me herën e parë pasi regjisori dëshironte të dilnin në pah emcionet e sinqerta dhe reagimet e natyrshme. Për më tepër, aktorët nuk e njihnin njëri-tjetrin. Por Winslet s'mund ta linte në dorë të fatit. Para se të nisnin xhirimet, duke ditur fare mirë ç'skenë do luhej i tregoi gjoksin Leonardos në mënyrë që ai të mos ndihej në siklet përballë kamerave.

11. Në të njëjtën skenë, Jack bëri një gabim. I tha Rose-it të shkonte në shtrat kur në të vërtetë duhet t'i thoshte të shkonte në kolltuk.



1593 – Henry IV i Francës konvertohet publikisht nga protestantizmi në katolicizëm. Henri ishte monarku i parë francez i Shtëpisë së Bourbonëve. Konsideruar si uzurpator nga katolikët dhe tradhtar nga protestantët, Henry urrehej nga popullata dhe i shpëtoi të paktën 12 tentativave për vrasje.

1788 – Wolfgang Amadeus Mozart përfundon Simfoninë e tij numër 40 në G minor – por nuk arriti ta dëgjojë të interpretuar. Sipas disa biografëve Mozart i shkroi simfonitë 39, 40 dhe 41 për t'u interpretuar pas vdekjes, ose si "apel për përjetësi".

1792 – Kanada – Manifesti i Hakmarrjes; banorët në Brunswick paralajmërojnë banorët e Parisit se do të hakmerren nëse Familja mbretërore franceze pëson gjë.

1946 – Operacioni Udhëkryq: Bomba e parë provë atomike amerikane shpërthen nënujë pranë ishullit Bikini, në Paqësor.

1956 – Fëmija i parë në epruvetë (test-tube) në botë, Louise Joy Brown, lindi në Lancashire, Angli.

2010 – WikiLeaks publikon dokumente sekrete mbi luftën në Afganistan – një nga nxjerrjet më të mëdha të informatave në historinë ushtarake të SHBA-së.

Goja juaj prodhon 1 litër pështymë në ditë.



Zemra e njeriut rreh 101,000 herë në ditë. Gjatë jetës ajo do të rrahë rreth 3 bilion herë dhe do të pompojë rreth 400 milion litra gjak.



Në përgjithësi njerëzit mund ta mbajnë frymën përreth një minutë. Rekord i botëror është 7 minuta e gjysmë



– Mësuesja : Beni ,cili është presidenti i SHBA-së??

– Beni : Nuk e di mësuese.

– Mësuesja : Beni ,duhet të kujdesesh më shumë për mësimet.

– Beni : Po ti mësuese e di cila është Maria ?

– Mësuesja : Jo.

– Beni : Duhet të kujdesesh më shumë për burrin tend.



Rrija mbyllur në dhomën time dhe studioja. Se po nuk studiove shumë, nuk bëhesh dot poet. Dhe poet të bëhesh o i madh, o hiç, se po s'qe i madh, je hiç në art. Arti, siç kemi thënë, ka vetëm një gradë, gradë të parë.

Lasgush Poradeci

KALENDARI HISTORIK 25 KORRIK

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS